Kur do t'i mbledhësh?	I mblodha dje.
Kur do ta hajë?	E hëngri dje.
Kur do ta shohin?	E panë dje.
Kur do të vijnë?	Erdhën dje.
Kur do ta hani?	E hëngrëm dje.
Kur do të vish?	Erdha dje.

ANALYSIS 6: MEDIO-PASSIVE PERFECT ASPECT

(44) SIMPLE CORRELATION

qumështi	Qumështi u mbarua.
frytet	Frytet u mbaruan.
dardhat	Dardhat u mbaruan.
vera	Vera u mbarua.
rrushi	Rrushi u mbarua.
mollët	Mollët u mbaruan.
çaji dhe kafeja	Çaji dhe kafeja u mbaruan.
birra	Birra u mbarua.

DRILLS

UNIT 13

(45) SIMPLE SUBSTITUTION

u rrova	U rrova në mëngjes.
u rrove	U rrove në mëngjes.
u rrua	U rrua në mëngjes.
u rruam	U rruam në mëngjes.
u rruat	U rruat në mëngjes.
u rruan	U rruan në mëngjes.
u rrova	U rrova në mëngjes.
u rrua	U rrua në mëngjes.

(46) SIMPLE CORRELATION

dielli	Dielli u zhduk.
retë	Retë u zhdukën.
hëna	Hëna u zhduk.
ti dhe ajo	Ti dhe ajo u zhdukët.
ti	Ti u zhduke.
vajzat	Vajzat u zhdukën.
kuajt	Kuajt u zhdukën.
lopa	Lopa u zhduk.

DRILLS

UNIT 13

(47) SIMPLE CORRELATION

kur e dëgjova	Kur e dëgjova, u gëzova shumë.
kur e dëgjoi	Kur e dëgjoi, u gëzua shumë.
kur e dëgjuat	Kur e dëgjuat, u gëzuat shumë.
kur e dëgjove	Kur e dëgjove, u gëzove shumë.
kur e dëgjuam	Kur e dëgjuam, u gëzuam shumë.
kur e dëgjuan	Kur e dëgjuan, u gëzuan shumë.
kur e dëgjoi	Kur e dëgjoi, u gëzua shumë.
kur e dëgjuam	Kur e dëgjuam, u gëzuam shumë.

(48) SIMPLE CORRELATION

unë	U afrova edhe unë.
ti	U afrove edhe ti.
ai	U afrua edhe ai.
ne	U afruam edhe ne.
ju	U afruat edhe ju.
ato	U afruan edhe ato.
ne	U afruam edhe ne.
djali	U afrua edhe djali.

DRILLS

UNIT 13

(49) SIMPLE CORRELATION

t'i shkruaj	S'u mbajta t'i shkruaj.
t'i shkruash	S'u mbajte t'i shkruash.
t'i shkruajë	S'u mbajti t'i shkruajë.
t'i shkruajmë	S'u mbajtëm t'i shkruajmë.
t'i shkruani	S'u mbajtët t'i shkruani.
t'i shkruajnë	S'u mbajtën t'i shkruajnë.
t'i shkruaj	S'u mbajta t'i shkruaj.
t'i shkruajmë	S'u mbajtëm t'i shkruajmë.

(50) RESPONSE

Kur do të martohet?	Tani? U martua muajin e shkuar.
Kur do të martohesh?	Tani? U martova muajin e shkuar.
Kur do të martoheni?	Tani? U martuam muajin e shkuar.
Kur do të martohen?	Tani? U martuan muajin e shkuar.
Kur do të martohesh?	Tani? U martova muajin e shkuar.
Kur do të martohet?	Tani? U martua muajin e shkuar.
Kur do të martohen?	Tani? U martuan muajin e shkuar.
Kur do të martoheni?	Tani? U martuam muajin e shkuar.

DRILLS

UNIT 13

(51) SIMPLE SUBSTITUTION

u ktheva	U ktheva javën e shkuar.
u ktheve	U ktheve javën e shkuar.
u kthye	U kthye javën e shkuar.
u kthyem	U kthyem javën e shkuar.
u kthyet	U kthyet javën e shkuar.
u kthyen	U kthyen javën e shkuar.
u ktheve	U ktheve javën e shkuar.
u ktheu	U ktheu javën e shkuar.

(52) RESPONSE

Kur u ktheu?	U ktheu të enjten.
Kur u kthyen?	U kthyen të enjten.
Kur u kthyet?	U kthyem të enjten.
Kur u ktheu?	U ktheu të enjten.
Kur u ktheve?	U ktheva të enjten.
Kur u kthyet?	U kthyem të enjten.
Kur u kthyen?	U kthyen të enjten.
Kur u ktheve?	U ktheva të enjten.

DRILLS

UNIT 13

(53) RESPONSE

Më ç'orë do të mbyllen dyqanet?	U mbyllën më shtatë.
Më ç'orë do të mbyllet dyqani?	U mbyll më shtatë.
Më ç'orë do të hapet furra?	U hap më shtatë.
Më ç'orë do të hapet duhanxhiu?	U hap më shtatë.
Më ç'orë do të hapen dyqanet?	U hapën më shtatë.
Më ç'orë do të takohen djemtë?	U takuan më shtatë.
Më ç'orë do të niset Agimi?	U nis më shtatë.
Më ç'orë do të kthehen?	U kthyen më shtatë.

(54) RESPONSE

A u zemërove, kur e dëgjove?	Jo, pse të zemërohem?
A u zemëruan, kur e dëgjuan?	Jo, pse të zemërohen?
A u zemërua, kur e dëgjoi?	Jo, pse të zemërohet?
A u zemëruat, kur e dëgjuat?	Jo, pse të zemërohemi?
A u gëzua, kur e dëgjoi?	Jo, pse të gëzohet?
A u gëzuat, kur e dëgjuat?	Jo, pse të gëzohemi?
A u gëzove, kur e dëgjove?	Jo, pse të gëzohem?
A u gëzuan, kur e dëgjuan?	Jo, pse të gëzohen?

DRILLS

UNIT 13

ANALYSIS 8: OBJECTIVE CASE WITH UNITS OF TIME

(55) Kur do të martohet, vitin që vjen? — Jo, u martua vitin e shkuar.

Kur do të martohen, javën që vjen? — Jo, u martuan javën e shkuar.

Kur do të martohesh, muajin që vjen? — Jo, u martova muajin e shkuar.

Kur do të martoheni, nesër? — Jo, u martuam dje.

Kur do të martohet, javën që vjen? — Jo, u martua javën e shkuar.

Kur do të martohesh, vitin që vjen? — Jo, u martova vitin e shkuar.

Kur do të martohen, muajin që vjen? — Jo, u martuan muajin e shkuar.

Kur do të martoheni, javën që vjen? — Jo, u martuam javën e shkuar.

Kur do të martohet, muajin që vjen? — Jo, u martua muajin e shkuar.

Kur do të martohen, vitin që vjen? — Jo, u martuan vitin e shkuar.

SPOKEN ALBANIAN

DRILLS

UNIT 13

ANALYSIS 9: NOUNS ENDING IN UNSTRESSED -o

(56) SIMPLE CORRELATION

ej, Lumo!	Ej, Lumo! Baba, a është këtu Lumua?
ej, Sulo!	Ej, Sulo! Baba, a është këtu Sulua?
ej, Vasil!	Ej, Vasil! Baba, a është këtu Vasili?
ej, Lumo!	Ej, Lumo! Baba, a është këtu Lumua?
ej, Dritë!	Ej, Dritë! Baba, a është këtu Drita?
ej, Fatime!	Ej, Fatime! Baba, a është këtu Fatime-ja?
ej, Sulo!	Ej, Sulo! Baba, a është këtu Sulua?
ej, Lumo!	Ej, Lumo! Baba, a është këtu Lumua?

(57) VARIATION

Lumua ka një pallto.	Ku është palltoja e Lumos?
Liria ka një pallto.	Ku është palltoja e Lirisë?
Sulua ka një pallto.	Ku është palltoja e Sulos?
Beqiri ka një pallto.	Ku është palltoja e Beqirit?
Vasili ka një pallto.	Ku është palltoja e Vasilit?
Fatimeja ka një pallto.	Ku është palltoja e Fatimesë?
Drita ka një pallto.	Ku është palltoja e Dritës?
Lumua ka një pallto.	Ku është palltoja e Lumos?

DRILLS

UNIT 13

(58) SIMPLE CORRELATION

Sulua	Ku është Sulua? A e patë Sulon?
Lumua	Ku është Lumua? A e patë Lumon?
palltoja	Ku është palltoja? A e patë pallton?
Lluka	Ku është Lluka? A e patë Llukën?
Lumua	Ku është Lumua? A e patë Lumon?
Sulua	Ku është Sulua? A e patë Sulon?
palltoja	Ku është palltoja? A e patë pallton?
Lumua	Ku është Lumua? A e patë Lumon?

(59) DIRECTED DIALOGUE

Pyeteni X-in a vajti në Vlorë për festën kombëtare.

Thuajini Z-it se s'vajtët këtë vit, pse s'deshi gruaja juaj.

Thuajini X-it se as ju s'vajtët, por vitin që vjen do të veni me doemos.

Pyeteni Z-in a shkoi i vjehri.

Thuajini X-it se të vjehrët shkuan me një mik të tyre.

DRILLS

UNIT 13

(60) DIRECTED DIALOGUE

Pyeteni X-in a është i martuar.

Thuajini Z-it se u martuat muajin e shkuar.

Pyeteni X-in a u martua me atë vajzë të bukur nga Gjirokastra.

Thuajini Z-it se po, gruaja juaj është nga Gjirokastra dhe pyeteni ku e di ai.

Thuajini X-it se i kishit parë sëbashku kur ishin të fejuar.

Thuajini Z-it se kini mysafirë në shtëpi: vjehrën dhe dy nga motrat e gruas.

Pyeteni X-in a janë motrat e gruas së tij aq të bukura si ajo.

Thuajini Z-it se njera, më e vogla, është shumë e bukur, por të tjerat jo shumë.

Pyeteni X-in sa motra ka gruaja.

Thuajini Z-it se ka tri motra: dy më të mëdha, dhe një më të vogël.

DRILLS

UNIT 13

(61) DIRECTED DIALOGUE

Thuajini X-it se u gëzuat shumë, kur dëgjuat se i ati është më mirë.

Thuajini Z-it falemnderit dhe pyeteni ku e dëgjoi.

Thuajini X-it se takuat zotin Frashëri dhe ai ju tha se babai i tij (d.m.th. i X-it) s'është më në spital.

Thuajini Z-it se besoni se doktori do ta dërgojë prapë në spital.

Pyeteni X-in pse.

Thuajini Z-it se doktori i tha babait të hajë shumë, por nuk i hahet dot.

Thuajini X-it se ju vjen keq.

Thuajini Z-it se babai juaj s'është më dhe aq i ri dhe kini frikë për jetën e tij.

(62) DIRECTED DIALOGUE

Thuajini Z-it se ju pëlqejnë shumë vallet shqiptare.

Thuajini Z-it se juve ju pëlqejnë më shumë vallet frenge dhe amerikane.

Pyeteni Z-it a di t'i këcejë mirë vallet shqiptare.

Thuajini X-it se nuk i këceni aq mirë sa vallet frenge.

Pyeteni Z-in a mund t'ju mësojë disa valle kombëtare.

Thuajini X-it: me gjithë qejf, po të dojë.

DRILLS

UNIT 13

(63) DIRECTED DIALOGUE

Pyeteni X-in a i pëlqen shkolla.

Thuajini Z-it se s'kini pse të ankoheni.

Pyeteni X-in a është Rus apo Shqiptar mësuesi i tyre i rusishtes.

Thuajini Z-it se mësuesi juaj është Shqiptar, por është i martuar me një Ruse.

Thuajini X-it se atëherë duhet ta dijë mirë gjuhën.

Thuajini Z-it se ju duket se e flet dhe e shkruan si një Rus.

Thuajini X-it se është e mirë të kesh mësues të tillë.

END OF DRILLS FOR UNIT 13

DRILLS

UNIT 14

(1) MULTIPLE CORRELATION (omit cue from response)

unë	Si mund të vij pa qenë i ftuar?
ju	Si mund të vini pa qenë të ftuar?
ti	Si mund të vish pa qenë i ftuar?
ne	Si mund të vijmë pa qenë të ftuar?
ajo	Si mund të vijë pa qenë e ftuar?
ai	Si mund të vijë pa qenë i ftuar?
ata	Si mund të vijnë pa qenë të ftuar?
ne	Si mund të vijmë pa qenë të ftuar?
ato	Si mund të vijnë pa qenë të ftuar?

(2) MULTIPLE CORRELATION

ç'ke ti?	Ç'ke ti? Ti je i ftuari im.
ç'kini ju?	Ç'kini ju? Ju jini të ftuarit e mi..
ç'ka ajo?	Ç'ka ajo? Ajo është e ftuara ime.
ç'kanë ata?	Ç'kanë ata? Ata janë të ftuarit e mi.
ç'ke ti?	Ç'ke ti? Ti je i ftuari im.
ç'ka ai?	Ç'ka ai? Ai është i ftuari im.
ç'kanë ato?	Ç'kanë ato? Ato janë të ftuarat e mia.
ç'kini ju?	Ç'kini ju? Ju jini të ftuarit e mi.

DRILLS

UNIT 14

(3) MULTIPLE CORRELATION (omit cue from response)

unë	S'jam i veshur mirë.
vajzat	S'janë të veshura mirë.
ajo	S'është e veshur mirë.
djemtë	S'janë të veshur mirë.
ne	S'jemi të veshur mirë.
i ati	S'është i veshur mirë.
ju	S'jini të veshur mirë.
e ëma	S'është e veshur mirë.

(4) SIMPLE CORRELATION

kam pak turp	Të them të drejtën, kam pak turp.
s'kam mjaft të holla	Të them të drejtën, s'kam mjaft të holla.
s'kemi për të ngrënë	Të themi të drejtën, s'kemi për të ngrënë.
s'kam për të ngrënë	Të them të drejtën, s'kam për të ngrënë.
s'kemi mjaft të holla	Të themi të drejtën, s'kemi mjaft të holla.
kemi pak turp	Të themi të drejtën, kemi pak turp.
s'kemi për të shkuar në kinema	Të themi të drejtën, s'kemi për të shkuar në kinema.
s'kam për të shkuar në kinema	Të them të drejtën, s'kam për të shkuar në kinema.

DRILLS

UNIT 14

(5) SUBSTITUTION IN VARIABLE SLOT

Hajde prapa meje.

hajdeni	Hajdeni prapa meje.
para	Hajdeni para meje.
nesh	Hajdeni para nesh.
eja	Eja para nesh.
prapa	Eja prapa nesh.
meje	Eja prapa meje.
ejani	Ejani prapa meje.
para	Ejani para meje.
nesh	Ejani para nesh.

(6) SIMPLE CORRELATION (omit cue from response)

ti	Është e para herë që vjen në dasma shqiptare?
ju	Është e para herë që vini në dasma shqiptare?
ai	Është e para herë që vjen në dasma shqiptare?
ajo	Është e para herë që vjen në dasma shqiptare?
ju	Është e para herë që vini në dasma shqiptare?
ato	Është e para herë që vijnë në dasma shqiptare?
ti	Është e para herë që vjen në dasma shqiptare?
ata	Është e para herë që vijnë në dasma shqiptare?

DRILLS

UNIT 14

(7) SIMPLE SUBSTITUTION

do të jetë	E dyta do të jetë jotja*.
është	E dyta është jotja.
ishte	E dyta ishte jotja.
qe	E dyta qe jotja.
ka qenë	E dyta ka qenë jotja.
ishte,	E dyta ishte jotja.
do të ishte	E dyta do të ishte jotja.
është	E dyta është jotja.

(8) SIMPLE CORRELATION (with nominative cues)

martesa jote	E treta në martesën tënde.
martesa ime	E treta në martesën time.
martesa juaj	E treta në martesën tuaj.
martesa e tij	E treta në martesën e tij.
martesa e saj	E treta në martesën e saj.
martesa e tyre	E treta në martesën e tyre.
martesa jonë	E treta në martesën tonë.
martesa jote	E treta në martesën tënde.

* Also <u>e jotja</u>.

DRILLS

UNIT 14

(9) RESPONSE

A mund ta shohim nusen?	S'ka ardhur akoma.
A mund t'i shohim djemtë?	S'kanë ardhur akoma.
A mund ta shohim dhëndrin?	S'ka ardhur akoma.
A mund ta shohim vjehrën?	S'ka ardhur akoma.
A mund t'i shohim vajzat?	S'kanë ardhur akoma.
A mund t'i shohim gratë?	S'kanë ardhur akoma.
A mund t'i shohim vjehrit?	S'kanë ardhur akoma.
A mund ta shohim vjehrin?	S'ka ardhur akoma.

(10) SIMPLE CORRELATION (omit cue from response)

nusen	Atë jemi duke pritur.
vjehrit	Ata jemi duke pritur.
dhëndrin	Atë jemi duke pritur.
vjehrën	Atë jemi duke pritur.
dhëndurët	Ata jemi duke pritur.
motrat	Ato jemi duke pritur.
vjehrin	Atë jemi duke pritur.
vëllezërit	Ata jemi duke pritur.

DRILLS

UNIT 14

(11) SIMPLE SUBSTITUTION

ç'thua	Tani ç'thua të bëjmë? A këcejmë?
ç'do	Tani ç'do të bëjmë? A këcejmë?
ç'thoni	Tani ç'thoni të bëjmë? A këcejmë?
ç'doni	Tani ç'doni të bëjmë? A këcejmë?
ç'thua	Tani ç'thua të bëjmë? A këcejmë?
ç'thoni	Tani ç'thoni të bëjmë? A këcejmë?
ç'doni	Tani ç'doni të bëjmë? A këcejmë?
ç'do	Tani ç'do të bëjmë? A këcejmë?

(12) MULTIPLE CORRELATION

Tom	Ki mendjen, Tom, mos bëj shaka.
zotërinj	Kini mendjen, zotërinj, mos bëni shaka.
vajza	Kini mendjen, vajza, mos bëni shaka.
mor'djalë	Ki mendjen, mor'djalë, mos bëj shaka.
moj vajzë	Ki mendjen, moj vajzë, mos bëj shaka.
zotërinj	Kini mendjen, zotërinj, mos bëni shaka.
mor'djem	Kini mendjen, mor'djem, mos bëni shaka.
mor'vëlla	Ki mendjen, mor'vëlla, mos bëj shaka.

DRILLS

UNIT 14

(13) DOUBLE SUBSTITUTION

burrat, gratë	Këtu këcehet ndryshe.	Burrat veç e gratë veç.
djemtë, vajzat	Këtu këcehet ndryshe.	Djemtë veç e vajzat veç.
çunat, çupat	Këtu këcehet ndryshe.	Çunat veç e çupat veç.
burrat, gratë	Këtu këcehet ndryshe.	Burrat veç e gratë veç.
të mëdhenjt, të vegjëlit	Këtu këcehet ndryshe.	Të mëdhenjt veç e të vegjëlit veç.
djemtë, vajzat	Këtu këcehet ndryshe.	Djemtë veç e vajzat veç.
burrat, gratë	Këtu këcehet ndryshe.	Burrat veç e gratë veç.
të mëdhenjt, të vegjëlit	Këtu këcehet ndryshe.	Të mëdhenjt veç e të vegjëlit veç.

(14) SIMPLE SUBSTITUTION

pimë	Prandaj, s'na mbetet tjetër, veçse të pimë.
këcejmë	Prandaj, s'na mbetet tjetër, veçse të këcejmë.
këndojmë	Prandaj, s'na mbetet tjetër, veçse të këndojmë.
hamë	Prandaj, s'na mbetet tjetër, veçse të hamë.
ikim	Prandaj, s'na mbetet tjetër, veçse të ikim.
vijmë	Prandaj, s'na mbetet tjetër, veçse të vijmë.
vemi	Prandaj, s'na mbetet tjetër, veçse të vemi.
shkojmë	Prandaj, s'na mbetet tjetër, veçse të shkojmë.

DRILLS

UNIT 14

(15) CUED RESPONSE (with nominative cues)

TEACHER: Ti, ne. Çudi e madhe.
STUDENT: Çudi për ty, por jo për ne.
TEACHER: Çudi për ty, por jo për ne.
STUDENT: Çudi për ty, por jo për ne.

TEACHER: Ju, ai. Çudi e madhe.
STUDENT: Çudi për ju, por jo për atë.
TEACHER: Çudi për ju, por jo për atë.
STUDENT: Çudi për ju, por jo për atë.

(ti, ne)	Çudi e madhe.	Çudi për ty, por jo për ne.
(ti, ata)	Çudi e madhe.	Çudi për ty, por jo për ata.
(ata, unë)	Çudi e madhe.	Çudi për ata, por jo për mua.
(ai, unë)	Çudi e madhe.	Çudi për atë, por jo për mua.
(ju, unë)	Çudi e madhe.	Çudi për ju, por jo për mua.
(ju, ne)	Çudi e madhe.	Çudi për ju, por jo për ne.
(ju, ajo)	Çudi e madhe.	Çudi për ju, por jo për atë.
(ato, ajo)	Çudi e madhe.	Çudi për ato, por jo për atë.
(ato, ti)	Çudi e madhe.	Çudi për ato, por jo për ty.
(ai, ju)	Çudi e madhe.	Çudi për atë, por jo për ju.

DRILLS

UNIT 14

(16) SIMPLE CORRELATION (omit cue from response)

ti	Me një fjalë, duhet ta mbyllësh gojën.
unë	Me një fjalë, duhet ta mbyll gojën.
ajo	Me një fjalë, duhet ta byllë gojën.
ne	Me një fjalë, duhet ta mbyllim gojën.
ata	Me një fjalë, duhet ta mbyllin gojën.
ju	Me një fjalë, duhet ta mbyllni gojën.
ai	Me një fjalë, duhet ta mbyllë gojën.
ti	Me një fjalë, duhet ta mbyllësh gojën.

(17) SIMPLE CORRELATION (with nominative cues)

ne	Dhëndri rri karshi nesh.
ju	Dhëndri rri karshi jush.
ti	Dhëndri rri karshi teje.
unë	Dhëndri rri karshi meje.
ju	Dhëndri rri karshi jush.
ti	Dhëndri rri karshi teje.
ne	Dhëndri rri karshi nesh.
unë	Dhëndri rri karshi meje.

DRILLS

UNIT 14

ANALYSIS 1: MORE ABOUT THE MEDIO-PASSIVE

(18) VARIATION

Ai po marton vajzën.	Vajza e tij po martohet.
Ai po marton vajzat.	Vajzat e tija po martohen.
Ai po marton motrat.	Motrat e tija po martohen.
Ai po marton mbesën.	Mbesa e tij po martohet.
Ai po marton motrën.	Motra e tij po martohet.
Ai po marton kushërirën.	Kushërira e tij po martohet.
Ai po marton mbesat.	Mbesat e tija po martohen.
Ai po marton bijat.	Bijat e tija po martohen.

(19) VARIATION

Kam uri.	Më hahet.
Kam etje.	Më pihet.
Ke etje?	Të pihet?
S'kam etje.	S'më pihet.
S'kemi uri.	S'na hahet.
S'ka etje.	S'i pihet.
S'kanë uri.	S'u hahet.
S'kini uri?	S'ju hahet?

DRILLS

UNIT 14

(20) VARIATION

Më ç'orë e mbyllin dyqanin?	Më ç'orë mbyllet dyqani?
Më ç'orë i mbyllin dyqanet?	Më ç'orë mbyllen dyqanet?
Më ç'orë e mbyllën dyqanin?	Më ç'orë u mbyll dyqani?
Më ç'orë i mbyllën dyqanet?	Më ç'orë u mbyllën dyqanet?
Më ç'orë do t'i mbyllin dyqanet?	Më ç'orë do të mbyllen dyqanet?
Më ç'orë do ta mbyllin dyqanin?	Më ç'orë do të mbyllet dyqani?
Më ç'orë e mbyllte dyqanin?	Më ç'orë mbyllej dyqani?
Më ç'orë i mbyllin dyqanet?	Më ç'orë mbyllen dyqanet?

(21) VARIATION

Shpresoj ta takoj.	Shpresojmë të takohemi.
Shpresojmë ta takojmë.	Shpresojmë të takohemi.
Shpresojnë ta takojnë.	Shpresojnë të takohen.
Shpreson ta takojë.	Shpresojnë të takohen.
Shpresojmë ta takojmë.	Shpresojmë të takohemi.
Shpreson ta takosh?	Shpresoni të takoheni?
Shpresoni ta takoni?	Shpresoni të takoheni?
Shpresoni t'i takoni?	Shpresoni të takoheni?
Shpresoj t'i takoj.	Shpresojmë të takohemi.

DRILLS

UNIT 14

(22) RESPONSE

Kush të lan, nëna?	Jo, lahem vetë.
Kush e lan, nëna?	Jo, lahet vetë.
Kush i lan, nëna?	Jo, lahen vetë.
Kush ju lan, nëna?	Jo, lahemi vetë.
Kush të lan, nëna?	Jo, lahem vetë.
Kush i lan, nëna?	Jo, lahen vetë.
Kush e lan, nëna?	Jo, lahet vetë.
Kush ju lan, nëna?	Jo, lahemi vetë.

(23) RESPONSE

Kush e rruan, berberi?	Jo, rruhet vetë.
Kush ju rruan, berberi?	Jo, rruhemi vetë.
Kush të rruan, berberi?	Jo, rruhem vetë.
Kush i rruan, berberi?	Jo, rruhen vetë.
Kush ju rruan, berberi?	Jo, rruhemi vetë.
Kush e rruan, berberi?	Jo, rruhet vetë.
Kush i rruan, berberi?	Jo, rruhemi vetë.
Kush të rruan, berberi?	Jo, rruhem vetë.

DRILLS

UNIT 14

ANALYSIS 2: VERB-STEM ALTERNATIONS

A. STEM-VOWEL ALTERNATIONS

(24) RESPONSE

A mund të flemë?	Kur doni të flini?
A mund ta shpiem ne?	Kur doni ta shpini?
A mund të vijmë edhe ne?	Kur doni të vini?
A mund ta presim?	Kur doni ta pritni?
A mund ta pjekim?	Kur doni ta piqni?
A mund t'i shpiem ne?	Kur doni t'i shpini?
A mund të flasim edhe ne?	Kur doni të flitni?
A mund të flemë këtu?	Kur doni të flini?

(25) RESPONSE

Kështu e gatuajnë këtë gjellë?	Jo, s'gatuhet ashtu.
Kështu e shkruajnë këtë fjalë?	Jo, nuk shkruhet ashtu.
Kështu i shkruajnë këto fjalë?	Jo, nuk shkruhen ashtu.
Kështu i gatuajnë këto gjellë?	Jo, s'gatuhen ashtu.
Kështu i gatuani këto gjellë?	Jo, s'gatuhen ashtu.
Kështu i shkruani këto fjalë?	Jo, nuk shkruhen ashtu.
Kështu e gatuani këtë gjellë?	Jo, s'gatuhet ashtu.
Kështu e shkruani këtë fjalë?	Jo, nuk shkruhet ashtu.

DRILLS

UNIT 14

(26) RESPONSE

Kur do ta pjekësh?	Do të piqemi më shtatë e gjysmë.
Kur do ta pjekim?	Do të piqemi më shtatë e gjysmë.
Kur do ta pjekë?	Do të piqen më shtatë e gjysmë.
Kur do ta pjekin?	Do të piqen më shtatë e gjysmë.
Kur do ta piqni?	Do të piqemi më shtatë e gjysmë.
Kur do ta pjek?	Do të piqeni më shtatë e gjysmë.
Kur do ta pjekim?	Do të piqemi më shtatë e gjysmë.
Kur do ta pjekë?	Do të piqen më shtatë e gjysmë.

(27) RESPONSE

Çelësin e marr unë.	Jo, s'mund ta marrësh ti.
Çelësin e merr ajo.	Jo, s'mund ta marrë ajo.
I flas unë babait.	Jo, s'mund t'i flasësh ti.
I flet ai babait.	Jo, s'mund t'i flasë ai.
Sonte dal edhe unë.	Jo, s'mund të dalësh edhe ti.
Sonte del edhe ai.	Jo, s'mund të dalë edhe ai.
U flet ajo atyre.	Jo, s'mund t'u flasë ajo.
Na jep ai të holla.	Jo, s'mund të na japë ai.
I jap unë të holla.	Jo, s'mund t'i japësh ti.

DRILLS

UNIT 14

(28) RESPONSE

Unë s'e njoh atë vajzë.	A do ta njohësh?
Ai s'e njeh atë vajzë.	A do ta njohë?
Ai s'e sheh kurrë Dritën.	A do ta shohë?
Unë s'e shoh kurrë Dritën.	A do ta shohësh?
Unë s'i shoh kurrë ato.	A do t'i shohësh?
Ai s'i njeh ato.	A do t'i njohë?
Unë s'të shoh kurrë.	A do të më shohësh?
Ai s'ju sheh kurrë.	A do të na shohë?

B. STEM-CONSONANT ALTERNATIONS

(29) RESPONSE

Po pres burrin.	Sa kohë do ta presësh?
Po pret burrin.	Sa kohë do ta presë?
Po pret fëmijët.	Sa kohë do t'i presë?
Po pres fëmijët.	Sa kohë do t'i presësh?
Po na pret Agimi.	Sa kohë do të na presë?
Po të pret Agimi.	Sa kohë do të më presë?
Po na priste Agimi.	Sa kohë do të na priste?
Po të priste Agimi.	Sa kohë do të më priste?

DRILLS

UNIT 14

ANALYSIS 3: THE FIRST AND THIRD PERSON PRONOUNS

(30) VARIATION

I dhashë një mollë.	Më dha një mollë.
Të dhashë një mollë.	Më dhe një mollë.
Të dha një mollë.	I dhe një mollë.
Më dhanë një mollë.	U dhashë një mollë.
I dhanë një mollë.	U dha një mollë.
Na dhe një mollë.	Të dhamë një mollë.
Ju dha një mollë.	I dhatë një mollë.
U dhatë një mollë.	Ju dhanë një mollë.

(31) VARIATION

Ne i pamë ata.	Ata na panë ne.
Unë e pashe atë.	Ai më pa mua.
Unë të pashë ty.	Ti më pe mua.
Ne ju pamë ju.	Ju na patë ne.
Ajo më pa mua.	Unë e pashë atë.
Ato na panë ne.	Ne i pamë ato.
Ju më patë mua.	Unë ju pashë ju.
Ti e pe atë.	Ai të pa ty.

DRILLS

UNIT 14

(32) RESPONSE :

Ai pse rri gjithnjë afër teje?	Pse i pëlqej.
Ata pse rrinë gjithnjë afër nesh?	Pse u pëlqeni.
Ajo pse rri gjithnjë afër meje?	Pse i pëlqen.
Ata pse rrinë gjithnjë afër jush?	Pse u pëlqejmë.
Ato pse rrinë gjithnjë afër meje?	Pse u pëlqen.
Ajo pse rri gjithnjë afër nesh?	Pse i pëlqejmë.
Ata pse rrinë gjithnjë afër teje?	Pse u pëlqej.
Ai pse rri gjithnjë afër jush?	Pse i pëlqejmë.

(33) RESPONSE

Ata ku banojnë, karshi nesh?	Jo karshi, por pranë nesh.
Ata ku banojnë, karshi teje?	Jo karshi, por pranë meje.
Ata ku banojnë, karshi meje?	Jo karshi, por pranë teje.
Ata ku banojnë, karshi jush?	Jo karshi, por pranë nesh.
Ata ku banojnë, karshi teje?	Jo karshi, por pranë meje.
Ata ku banojnë, karshi nesh?	Jo karshi, por pranë nesh.
Ata ku banojnë, karshi jush?	Jo karshi, por pranë nesh.
Ata ku banojnë, karshi meje?	Jo karshi, por pranë teje.

DRILLS

UNIT 14

ANALYSIS 4: MEDIO-PASSIVE COMMANDS AFTER mos

(34) VARIATION

Largohu tani.	Mos u largo akoma.
Afrohu tani.	Mos u afro akoma.
Martohu tani.	Mos u marto akoma.
Nisu tani.	Mos u nis akoma.
Kthehu tani.	Mos u ktheh akoma.
Rruhu tani	Mos u rru akoma.
Ndahu tani.	Mos u ndaj akoma.
Bëhu tani.	Mos u bëj akoma.

(35) RESPONSE

Duhet të nxitohemi.	Jo, mos u nxitoni.
Duhet të martohemi.	Jo, mos u martoni.
Duhet të largohemi.	Jo, mos u largoni.
Duhet të nisemi.	Jo, mos u nisni.
Duhet të ndahemi.	Jo, mos u ndani.
Duhet të afrohemi.	Jo, mos u afroni.
Duhet të qethemi.	Jo, mos u qethni.
Duhet të vishemi.	Jo, mos u veshni.

DRILLS

UNIT 14

(36) RESPONSE

Do të ulem këtu.	Mos u ul atje.
Do të takohemi nesër.	Mos u takoni nesër.
Do të bëhem doktor.	Mos u bëj doktor.
Do të martohemi të martën.	Mos u martoni të martën.
Do të zemërohemi me ty.	Mos u zemëroni me mua.
Do të qethen tek Aliu.	Mos u qeth tek Aliu.
Do të rruhemi vetë.	Mos u rruani vetë.
Do të largohem sot.	Mos u largo sot.

ANALYSIS 5: THE PARTICLE duke

(37) VARIATION

Flasin dhe punojnë.	Flasin duke punuar.
Flet dhe punon.	Flet duke punuar.
Këndojmë dhe punojmë.	Këndojmë duke punuar.
Këndojnë dhe këcejnë.	Këndojnë duke këcyer.
Fjalosemi dhe hamë.	Fjalosemi duke ngrënë.
Mëson dhe punon.	Mëson duke punuar.
Pimë dhe hamë.	Pimë duke ngrënë.
Fjaloseni dhe shetitni.	Fjaloseni duke shetitur.

DRILLS

UNIT 14

(38) RESPONSE

Kur e pe?	Kur isha duke shkuar në shkollë.
Kur e pa?	Kur ishte duke shkuar në shkollë.
Kur e panë?	Kur ishin duke shkuar në shkollë.
Kur e patë?	Kur ishim duke shkuar në shkollë.
Kur e pa?	Kur ishte duke shkuar në shkollë.
Kur e pe?	Kur isha duke shkuar në shkollë.
Kur e patë?	Kur ishim duke shkuar në shkollë.
Kur e panë?	Kur ishin duke shkuar në shkollë.

(39) DIRECTED DIALOGUE

Thuajini X-it se ju pëlqen shumë ajo vajzë.

Thuajini Z-it se është me të vërtetë e bukur. Pyeteni po të dojë ta rekomandoni me atë.

Thuajini X-it të mos bëjë shaka, pse i ati rri pranë jush.

Thuajini Z-it të mos ketë frikë. Babai i vajzës nuk do të zemërohet. Shqiptarët sot nuk janë si para luftës.

Thuajini X-it se gëzoheni që është kështu.

DRILLS

UNIT 14

(40) DIRECTED DIALOGUE

Thuajini X-it se të hënën që vjen do të martoheni. Thuajini se është i ftuar në dasmë.

Falënderojeni Z-in dhe pyeteni kush është e fejuara.

Thuajini X-it se është Liri Buda, vajza e doktorit.

Thuajini Z-it se e njihni fort mirë babanë e saj. Ishit bashkë ushtarë.

Thuajini X-it se muajin që vjen do të martohet edhe vëllai juaj Mihali.

Pyeteni Z-in kush është Mihali, i madhi apo i vogli.

Thuajini X-it se Mihal është i vogli. Më të madhin e quajnë Vasil. Thoni se ai u martua vitin e shkuar.

(41) Pyeteni X-in ku ishte mbrëmë.

Thuajini Z-it se ishit i ftuar në një dasmë.

Pyeteni X-in a ishte në martesën e Skënderit.

Thuajini Z-it po, dhe pyeteni ai nse s'erdhi.

Thuajini X-it se ishit në Durrës dhe kur erdhët në shtëpi ishte shumë vonë.

Pyeteni Z-in më ç'orë erdhi nga Durrësi.

Thuajini X-it se ishte pothuaj mesnatë.

Thuajini Z-it se mund të kishte ardhur. Të ftuarit ndenjën të paktën gjer m'ora tre.

DRILLS

UNIT 14

(42) DIRECTED DIALOGUE

Pyeteni X-in ku e ka mësuar shqipen.

Thuajini Z-it se e kini mësuar nga gjyshja juaj, që ishte nga Vlora.

Pyeteni X-in kur erdhi n'Amerikë gjyshja e tij.

Thuajini Z-it se erdhi kur ishte akoma e re.

Pyeteni X-in a erdhi vetë apo me burrin.

Thuajini Z-it se erdhi me gjyshin tuaj, por ai nuk ishte Shqiptar, ishte Grek.

Pyeteni X-in ç'gjuhë fliste gjyshja me gjyshin.

Thuajini Z-it se i fliste greqisht, pse ai s'dinte shqip.

(43) DIRECTED DIALOGUE

Thuajini X-it të mos flasë duke ngrënë.

Pyeteni Z-in po ai nuk flet kurrë në tryezë.

Thuajini X-it se mishi do të ftohet.

Thuajini Z-it se e pyetët diçka.

Thuajini X-it se ngandonjëherë flitni kur hani, por jo tërë kohën si ai.

Thuajini Z-it se nuk flitni gjithnjë, vetëm kur kini diçka për të thënë.

Pyeteni X-in ç'ka për të thënë tani.

Thuajini Z-it se mishi juaj u ftoh dhe s'mund ta hani.

END OF DRILLS FOR UNIT 14

SPOKEN ALBANIAN

DRILLS

UNIT 15

(1) VARIATION

Kemi edhe stofë italiane.	Kemi edhe stofë Italie.
Kemi edhe stofë frenge.	Kemi edhe stofë France.
Kemi edhe stofë angleze.	Kemi edhe stofë Anglie.
Kemi edhe stofë amerikane.	Kemi edhe stofë Amerike.
Kemi edhe stofë italiane.	Kemi edhe stofë Italie.
Kemi edhe stofë angleze.	Kemi edhe stofë Anglie.
Kemi edhe stofë frenge.	Kemi edhe stofë France.
Kemi edhe stofë amerikane.	Kemi edhe stofë Amerike.

(2) SIMPLE SUBSTITUTION

të verdha	Dua një palë këpucë të verdha.
të zeza	Dua një palë këpucë të zeza.
të kuqe	Dua një palë këpucë të kuqe.
të bardha	Dua një palë këpucë të bardha.
blu	Dua një palë këpucë blu.
ngjyrë kafe	Dua një palë këpucë ngjyrë kafe.
ngjyrë deti	Dua një palë këpucë ngjyrë deti.
jeshile	Dua një palë këpucë jeshile.

DRILLS

UNIT 15

(3) SIMPLE CORRELATION

na vjen keq	Na vjen keq, shesim vetëm për foshnje.
më vjen keq	Më vjen keq, shes vetëm për foshnje.
thotë se i vjen keq	Thotë se i vjen keq, shet vetëm për foshnje.
thuaj se të vjen keq	Thuaj se të vjen keq, shet vetëm për foshnje.
thoni se ju vjen keq	Thoni se ju vjen keq, shitni vetëm për foshnje.
thonë se u vjen keq	Thonë se u vjen keq, shesin vetëm për foshnje.
më vjen keq	Më vjen keq, shes vetëm për foshnje.
na vjen keq	Na vjen keq, shesim vetëm për foshnje.

(4) RESPONSE

Po të mbathura kini?	Kemi.
Po Alinë e pe?	E pashë.
Po foshnjet i patë?	I pamë.
Po të mbathura kanë?	Kanë.
Po mua më pa?	Të pa.
Po shami kishin?	Kishin.
Po Lulja u nis?	U nis?
Po vajzat u nisën?	U nisën.

(5) SIMPLE CORRELATION (omit cue from response)

unë	Bjerë disa ngjyra që të zgjedh.
ne	Bjerë disa ngjyra që të zgjedhim.
ai	Bjerë disa ngjyra që të zgjedhë.
ajo	Bjerë disa ngjyra që të zgjedhë.
unë	Bjerë disa ngjyra që të zgjedh.
ata	Bjerë disa ngjyra që të zgjedhin.
ne	Bjerë disa ngjyra që të zgjedhim.
ato	Bjerë disa ngjyra që të zgjedhin.

(6) SIMPLE CORRELATION

të gjata	Kanë të çdo lloj: të gjata e të shkurtra.
të mira	Kanë të çdo lloj: të mira e të këqija.
të bardha	Kanë të çdo lloj: të bardha e të zeza.
të mëdha	Kanë të çdo lloj: të mëdha e të vogla.
të shkurtra	Kanë të çdo lloj: të shkurtra e të gjata.
të këqija	Kanë të çdo lloj: të këqija e të mira.
të zeza	Kanë të çdo lloj: të zeza e të bardha.
të vogla	Kanë të çdo lloj: të vogla e të mëdha.

DRILLS

UNIT 15

(7) SIMPLE CORRELATION

të trasha	Janë të mira, por tepër të trasha. I doja më të holla.
të gjata	Janë të mira, por tepër të gjata. I doja më të shkurtra.
të vogla	Janë të mira, por tepër të vogla. I doja më të mëdha.
të shtrenjta	Janë të mira, por tepër të shtrenjta. I doja më të lira.
të shkurtra	Janë të mira, por tepër të shkurtra. I doja më të gjata.
të holla	Janë të mira, por tepër të holla. I doja më të trasha.
të mëdha	Janë të mira, por tepër të mëdha. I doja më të vogla.
të trasha	Janë të mira, por tepër të trasha. I doja më të holla.

(8) SIMPLE SUBSTITUTION

do?	Do një këmishë pambuku?
doja	Doja një këmishë pambuku.
donte	Donte një këmishë pambuku.
do	Do një këmishë pambuku.
dua	Dua një këmishë pambuku.
duan	Duan një këmishë pambuku.
duam	Duam një këmishë pambuku.
doni?	Doni një këmishë pambuku?

DRILLS

UNIT 15

(9) SIMPLE CORRELATION

dy këmishë	Bleva dy këmishë të mëndafshta.
një këmishë	Bleva një këmishë të mëndafshtë.
një shami	Bleva një shami të mëndafshtë.
disa shami	Bleva disa shami të mëndafshta.
një palë çorape	Bleva një palë çorape të mëndafshta.
çorape	Bleva çorape të mëndafshta.
disa këmishë	Bleva disa këmishë të mëndafshta.
dy palë çorape	Bleva dy palë çorape të mëndafshta.

(10) RESPONSE

Si e doni këmishën?	Të jetë verore.
Si i doni rrobat?	Të jenë verore.
Si e doni xhaketën?	Të jetë verore.
Si i doni këpucët?	Të jenë verore.
Si i doni çorapet?	Të jenë verore.
Si e doni shaminë?	Të jetë verore.
Si e doni këmishën?	Të jetë verore.
Si i doni të mbathurat?	Të jenë verore.

DRILLS

UNIT 15

(11) RESPONSE

Sa çorape doni?	Një duzinë nga këto dhe gjysmë nga ato.
Sa kafe doni?	Një kilo nga kjo dhe gjysmë nga ajo.
Sa çaj doni?	Një kilo nga ky dhe gjysmë nga ai.
Sa oriz doni?	Një kilo nga ky dhe gjysmë nga ai.
Sa shami doni?	Një duzinë nga këto dhe gjysmë nga ato.
Sa pjepra doni?	Një duzinë nga këto dhe gjysmë nga ato.
Sa fasule doni?	Një kilo nga këto dhe gjysmë nga ato.
Sa rrush doni?	Një kilo nga këto dhe djysmë nga ato.

or

Një kilo nga ky dhe gjysmë nga ai.

(12) SIMPLE CORRELATION (omit cue from response)

ti	Mund ta thyesh këtë çek?
ai	Mund ta thyejë këtë çek?
ju	Mund ta thyeni këtë çek?
ne	Mund ta thyejmë këtë çek?
ata	Mund ta thyejnë këtë çek?
ajo	Mund ta thyejë këtë çek?
ti	Mund ta thyesh këtë çek?
ju	Mund ta thyeni këtë çek?

DRILLS

UNIT 15

(13) MULTIPLE CORRELATION

çeqe*	Ç'janë këto çeqe, të huaja?
çek	Ç'është ky çek, i huaj?
oficer	Ç'është ky oficer, i huaj?
ushtarë	Ç'janë këta ushtarë, të huaj?
vajzë	Ç'është kjo vajzë, e huaj?
djem	Ç'janë këta djem, të huaj?
gra	Ç'janë këto gra, të huaja?
këpucë	Ç'janë këto këpucë, të huaja?

(14) RESPONSE

S'është dhe aq i madh.	Sado i madh, ne e bëjmë.
S'janë dhe aq të mëdha.	Sado të mëdha, ne i bëjmë.
S'është dhe aq e rëndë.	Sado e rëndë, ne e bëjmë.
S'janë dhe aq të vogla.	Sado të vogla, ne i bëjmë.
S'janë dhe aq të rënda.	Sado të rënda, ne i bëjmë.
S'është dhe aq e vogël.	Sado e vogël, ne e bëjmë.
S'është dhe aq e madhe.	Sado e madhe, ne e bëjmë.
S'është dhe aq i vogël.	Sado i vogël, ne e bëjmë.

* Also <u>çeka</u>.

DRILLS

UNIT 15

(15) SIMPLE SUBSTITUTION

javë	Ka javë që s'kam marrë asnjë letër.
vjet	Ka vjet që s'kam marrë asnjë letër.
dit	Ka dit që s'kam marrë asnjë letër.
muaj	Ka muaj që s'kam marrë asnjë letër.
vjet	Ka vjet që s'kam marrë asnjë letër.
javë	Ka javë që s'kam marrë asnjë letër.
dit	Ka dit që s'kam marrë asnjë letër.
muaj	Ka muaj që s'kam marrë asnjë letër.

(16) SIMPLE CORRELATION (omit cue from response)

ti	Nga kush pret lajme?
ajo	Nga kush pret lajme?
ju	Nga kush pritni lajme?
ne	Nga kush presim lajme?
ti	Nga kush pret lajme?
ato	Nga kush presin lajme?
ai	Nga kush pret lajme?
ju	Nga kush pritni lajme?

DRILLS

UNIT 15

(17) SIMPLE CORRELATION

e lashë	E lashë pak si pa qejf kur u nisa.
e le	E le pak si pa qejf kur u nise.
e la	E la pak si pa qejf kur u nis.
e lamë	E lamë pak si pa qejf kur u nisëm.
e latë	E latë pak si pa qejf kur u nisët.
e lanë	E lanë pak si pa qejf kur u nisën.
e lamë	E lamë pak si pa qejf kur u nisëm.
e lashë	E lashë pak si pa qejf kur u nisa.

(18) MULTIPLE CORRELATION

vonesa	Sidoqoftë vonesa është e madhe.
spitali	Sidoqoftë spitali është i madh.
dhoma	Sidoqoftë dhoma është e madhe.
djemtë	Sidoqoftë djemtë janë të mëdhenj.
çupat	Sidoqoftë çupat janë të mëdha.
këpucët	Sidoqoftë këpucët janë të mëdha.
palltoja	Sidoqoftë palltoja është e madhe.
kisha	Sidoqoftë kisha është e madhe.

DRILLS

UNIT 15

(19) SIMPLE SUBSTITUTION

e dytë	Ishte lart në katin e dytë.
e tretë	Ishte lart në katin e tretë.
e katërt	Ishte lart në katin e katërt.
e dytë	Ishte lart në katin e dytë.
e pestë	Ishte lart në katin e pestë.
e gjashtë	Ishte lart në katin e gjashtë.
e tretë	Ishte lart në katin e tretë.
e katërt	Ishte lart në katin e katërt.

(20) RESPONSE

Si i thonë shqip stamp?	Në mos gabohem, i thonë pullë.
Si i thonë shqip sheep?	Në mos gabohem, i thonë dele.
Si i thonë shqip meat?	Në mos gabohem, i thonë mish.
Si i thonë shqip sea, ocean?	Në mos gabohem, i thonë det.
Si i thonë shqip merchant?	Në mos gabohem, i thonë tregëtar.
Si i thonë shqip to jump?	Në mos gabohem, i thonë këcej.
Si i thonë shqip dance?	Në mos gabohem, i thonë valle.
Si i thonë shqip office?	Në mos gabohem, i thonë zyrë.

DRILLS

UNIT 15

(21) SIMPLE CORRELATION

bëj	Bëj ç'ke për të bërë.
shih	Shih ç'ke për të parë.
shiko	Shiko ç'ke për të shikuar.
thuaj	Thuaj ç'ke për të thënë.
merr	Merr ç'ke për të marrë.
jep	Jep ç'ke për të dhënë.
gatuaj	Gatuaj ç'ke për të gatuar.
bëj	Bëj ç'ke për të bërë.

(22) RESPONSE

Pse nxitohemi?	Sepse kam frikë mos mbyllet.
Pse nxitohet?	Sepse ka frikë mos mbyllet.
Pse nxitohesh?	Sepse kam frikë mos mbyllet.
Pse nxitoheni?	Sepse kemi frikë mos mbyllet.
Pse nxitohen?	Sepse kanë frikë mos mbyllet.
Pse nxitohet?	Sepse ka frikë mos mbyllet.
Pse nxitoheni?	Sepse kemi frikë mos mbyllet.
Pse nxitohesh?	Sepse kam frikë mos mbyllet.

DRILLS

UNIT 15

ANALYSIS 2: MORE ON THE MARGINAL INDEFINITE CASE

(23) VARIATION

Kjo stofë ka ngjyrën e detit.	Kjo stofë është ngjyrë deti.
Kjo stofë ka ngjyrën e kafesë.	Kjo stofë është ngjyrë kafe*.
Kjo stofë ka ngjyrën e zjarrit.	Kjo stofë është ngjyrë zjarri.
Kjo stofë ka ngjyrën e limonit.	Kjo stofë është ngjyrë limoni.
Kjo stofë ka ngjyrën e qumështit.	Kjo stofë është ngjyrë qumështi.
Kjo stofë ka ngjyrën e borës.	Kjo stofë është ngjyrë bore.
Kjo stofë ka ngjyrën e kafesë.	Kjo stofë është ngjyrë kafe.
Kjo stofë ka ngjyrën e detit.	Kjo stofë është ngjyrë deti.

(24) VARIATION

Kjo stofë vjen nga Italia.	Kjo është stofë Italie.
Këto çorape janë prej pambuku.	Këto janë çorape pambuku.
Kjo shami është prej pambuku.	Kjo është shami pambuku.
Ky pambuk është nga Amerika.	Ky është pambuk Amerike.
Këto këpucë janë nga Anglia.	Këto janë këpucë Anglie.
Këto verëra janë nga Franca.	Këto janë verëra France.
Kjo stofë vjen nga Franca.	Kjo është stofë France.
Kjo verë është nga Italia.	Kjo është verë Italie.

* Also ngjyrë kafeje.

DRILLS

UNIT 15

ANALYSIS 3: THE PAST TENSE FIRST PERSON SINGULAR

(25) SIMPLE SUBSTITUTION

shkojmë në kinema	Ajo donte të shkojmë në kinema, por unë s'doja.
flasim anglisht	Ajo donte të flasim anglisht, por unë s'doja.
banojmë afër shkollës	Ajo donte të banojmë afër shkollës, por unë s'doja.
blejmë një automobil	Ajo donte të blejmë një automobil, por unë s'doja.
shesim disa gjëra	Ajo donte të shesim disa gjëra, por unë s'doja.
hamë bukë në gjelltore	Ajo donte të hamë bukë në gjelltore, por unë s'doja.
porositim këpucë Anglie	Ajo donte të porositim këpucë Anglie, por unë s'doja.
pimë birrë	Ajo donte të pimë birrë, por unë s'doja.
rrimë në shtëpi	Ajo donte të rrimë në shtëpi, por unë s'doja.
presim tërë ditën	Ajo donte të presim tërë ditën, por unë s'doja.

DRILLS

UNIT 15

(26) SIMPLE SUBSTITUTION

anglisht	Ajo më fliste anglisht dhe unë i flisja shqip.
italisht	Ajo më fliste anglisht dhe unë i flisja shqip.
greqisht	Ajo më fliste greqisht dhe unë i flisja shqip.
frengjisht	Ajo më fliste frengjisht dhe unë i flisja shqip.
anglisht	Ajo më fliste anglisht dhe unë i flisja shqip.
greqisht	Ajo më fliste greqisht dhe unë i flisja shqip.
frengjisht	Ajo më fliste frengjisht dhe unë i flisja shqip.
italisht	Ajo më fliste italisht dhe unë i flisja shqip.

(27) EXPANSION

Ai ecte shpejt.	Ai ecte shpejt, por unë ecja ngadale.
Ai fliste shpejt.	Ai fliste shpejt, por unë flisja ngadale.
Ai shkonte shpejt.	Ai shkonte shpejt, por unë shkoja ngadale.
Ai hante shpejt.	Ai hante shpejt, por unë haja ngadale.
Ai punonte shpejt.	Ai punonte shpejt, por unë punoja ngadale.
Ai pinte shpejt.	Ai pinte shpejt, por unë pija ngadale.
Ai këndonte shpejt.	Ai këndonte shpejt, por unë këndoja ngadale.
Ai qepte shpejt.	Ai qepte shpejt, por unë qepja ngadale.

DRILLS

UNIT 15

(28) SIMPLE CORRELATION

tani banoj këtu	Tani banoj këtu, kurse para luftës banoja në Tiranë.
tani punoj këtu	Tani punoj këtu, kurse para luftës punoja në Tiranë.
tani mësoj këtu	Tani mësoj këtu, kurse para luftës mësoja në Tiranë.
tani ha këtu	Tani ha këtu, kurse para luftës haja në Tiranë.
tani i blej këtu	Tani i blej këtu, kurse para luftës i blija në Tiranë.
tani i shes këtu	Tani i shes këtu, kurse para luftës i shisja në Tiranë.
tani i marr këtu	Tani i marr këtu, kurse para luftës i mirrja në Tiranë.
tani i jap këtu	Tani i jap këtu, kurse para luftës i jepja* në Tiranë.

* Also <u>jipja</u>.

DRILLS

UNIT 15

(29) STRUCTURE REPLACEMENT

Vesh xhaketën e re.	Veshja xhaketën e re.
E shpie gjithnjë unë.	E shpija gjithnjë unë.
U flas gjithnjë shqip.	U flisja gjithnjë shqip.
E dua shumë atë çupë.	E doja shumë atë çupë.
Qëndroj në hotel "Shkodra".	Qëndroja në hotel "Shkodra".
Ngandonjëherë këcej tërë natën.	Ngandonjëherë këceja tërë natën.
Frytet i zgjedh unë.	Frytet i zgjidhja unë.
Unë hedh të holla nga dritarja.	Unë hidhja të holla nga dritarja.
Bëj ëmbëlsira të mira.	Bëja ëmbëlsira të mira.

SPOKEN ALBANIAN

DRILLS

UNIT 15

ANALYSIS 4: <u>nëmë</u>, <u>hajde</u>, ETC.

(30) VARIATION

Jepmë një portokall.	Nëmë një portokall.
Jepma portokallin.	Nëma portokallin.
Jepmi portokajt.	Nëmi portokajt.
Jepmëni disa dardha.	Nëmëni disa dardha.
Jepmini dardhat.	Nëmini dardhat.
Jepmëni numrin e saj.	Nëmëni numrin e saj.
Jepmë një shkrepës.	Nëmë një shkrepës.
Jepmëni një cigare.	Nëmëni një cigare.

(31) RESPONSE

Të vij dhe unë me ju?	Hajde!
Të vijmë dhe ne me ju?	Hajdeni!
Të të jap një cigare?	Nëmë!
Të të japim ca raki?	Nëmëni!
Të vijmë dhe ne?	Hajdeni!
Të të jap një kafe?	Nëmë!
Të vij dhe unë me ty?	Hajde!
Të vijmë dhe ne me ty?	Hajdeni!

DRILLS

UNIT 15

ANALYSIS 5: DEVOICING OF dh

(32) STRUCTURE REPLACEMENT

Unë zgjedh gjithnjë fryte të njoma.	Ne zgjedhim gjithnjë fryte të njoma.
Do t'i mbledh të gjithë miqtë.	Do t'i mbledhim të gjithë miqtë.
Kam frikë se do ta lodh kalin.	Kemi frikë se do ta lodhim kalin.
Nuk i hedh të hollat nga dritarja.	Nuk i hedhim të hollat nga dritarja.
Ai zgjedh më të mirat.	Ata zgjedhin më të mirat.
Na mbledh të gjithë çdo mëngjes.	Na mbledhin të gjithë çdo mëngjes.
Na lodh tepër oficeri ynë.	Na lodhin tepër oficerët tonë.
I hedh në zjarr ushtarët.	I hedhin në zjarr ushtarët.

(33)

Unë zgjidhja më të lira.	Ai zgjidhte më të lira.
Mblidhja të gjithë djemtë.	Mblidhte të gjithë djemtë.
Nuk i hidhja të hollat.	Nuk i hidhte të hollat.
S'i lodhja shumë kuajt.	S'i lodhte shumë kuajt.
Mblidhja tërë familjen.	Mblidhte tërë familjen.
Zgjidhja gjithnjë rrush të freskët.	Zgjidhte gjithnjë rrush të freskët.
S'i lodhja shumë nxënësit.	S'i lodhte shumë nxënësit.
Zgjidhja gjithnjë pjeprat më të mëdha.	Zgjidhte gjithnjë pjaprat më të mëdha.

DRILLS

UNIT 15

ANALYSIS 6: VERBS IN -edh

(34) RESPONSE

Kush i zgjodhi peshqit*, ti?	Po, unë i zgjodha.
Kush i zgjodhi peshqit, ata?	Po, ata i zgjodhën.
Kush i zgjodhi peshqit, ai?	Po, ai i zgjodhi.
Kush i zgjodhi peshqit, ju?	Po, ne i zgjodhëm.
Kush i zgjodhi peshqit, ajo?	Po, ajo i zgjodhi.
Kush i zgjodhi peshqit, ti?	Po, unë i zgjodha.
Kush i zgjodhi peshqit, ju?	Po, ne i zgjodhëm.
Kush i zgjodhi peshqit, ato?	Po, ato i zgjodhën.

* Also pishqit.

DRILLS

UNIT 15

(35) RESPONSE

Lodhesh shumë në këtë punë?	Jo dhe aq shumë, por sot u lodha.
Lodhen shumë në këtë punë?	Jo dhe aq shumë, por sot u lodhën.
Lodheni shumë në këtë punë?	Jo dhe aq shumë, por sot u lodhëm.
Lodhet shumë në këtë punë?	Jo dhe aq shumë, por sot u lodh.
Lodhen shumë në këtë punë?	Jo dhe aq shumë, por sot u lodhën.
Lodheni shumë në këtë punë?	Jo dhe aq shumë, por sot u lodhëm.
Lodhesh shumë në këtë punë?	Jo dhe aq shumë, por sot u lodha.
Lodhet shumë në këtë punë?	Jo dhe aq shumë, por sot u lodh.

(36) RESPONSE

Kur do t'i mbledhësh?	I mblodha dje.
Kur do ta qethësh?	E qetha dje.
Kur do t'i mblidhni?	I mblodhëm dje.
Kur do t'i mbledhin?	I mblodhën dje.
Kur do ta qethë?	E qethi dje.
Kur do ta qethni?	E qethëm dje.
Kur do t'i mbledhë?	I mblodhi dje.
Kur do ta qethin?	E qethën dje.

(37) VARIATION

Kur ishte e re lodhej shumë.	Dje u lodh shumë.
Kur ishte i ri i zgjidhte frytet.	Dje i zgjodhi frytet.
Kur isha e re e hidhja mirë vallen.	Dje e hodha mirë vallen.
Kur ishte i ri s'lodhej fare.	Dje s'u lodh fare.
Kur isha i ri i zgjidhja unë frytet.	Dje i zgjodha unë frytet.
Kur ishte e re e hidhte mirë vallen.	Dje e hodhi mirë vallen.
Kur ishte i ri ai i zgjidhte kuajt.	Dje ai i zgjodhi kuajt.
Kur ishte i ri na mblidhte përjashta shtëpisë.	Dje na mblodhi përjashta shtëpisë.

DRILLS

UNIT 15

(38) RESPONSE

Kush ju ka mbledhur këtu?	Na mblodhi zoti Buda.
Kush i ka mbledhur këtu?	I mblodhi zoti Buda.
Kush ju ka zgjedhur?	Na zgjodhi zoti Buda.
Kush e ka zgjedhur?	E zgjodhi zoti Buda.
Kush e ka hedhur këtu?	E hodhi zoti Buda.
Kush i ka zgjedhur?	I zgjodhi zoti Buda.
Kush i ka qepur këto rroba?	I qepi zoti Buda.
Kush i ka hedhur këtu?	I hodhi zoti Buda.

ANALYSIS 7: <u>që</u> AND <u>se</u>

(39) SUBSTITUTION IN VARIABLE SLOT

Ka javë që s'kam marrë asnjë letër.

ka muaj	Ka muaj që s'kam marrë asnjë letër.
ke marrë	Ka muaj që s'ke marrë asnjë letër.
asnjë lajm	Ka muaj që s'ke marrë asnjë lajm.
ka vjet	Ka vjet që s'ke marrë asnjë lajm.
keni marrë	Ka vjet që s'kemi marrë asnjë lajm.
lajme	Ka vjet që s'kemi marrë lajme.
ka javë	Ka javë që s'kemi marrë lajme.
kanë marrë	Ka javë që s'kanë marrë lajme.
asnjë lajm	Ka javë që s'kanë marrë asnjë lajm.

SPOKEN ALBANIAN

DRILLS

UNIT 15

(40) COMBINATION

Një burrë ishte këtu dje. E pashë burrin.	E pashë burrin që ishte këtu dje.
Një grua ishte këtu dje. E pamë gruan.	E pamë gruan që ishtë këtu dje.
Disa gra ishin këtu dje. I pamë gratë.	I pamë gratë që ishin këtu dje.
Disa burra ishin këtu dje. I patë burrat?	I patë burrat që ishin këtu dje?
Disa djem ishin këtu dje. I patë djemtë?	I patë djemtë që ishin këtu dje?
Një vajzë ishte këtu dje. E patë vajzën?	E patë vajzën që ishte këtu dje.
Një djalë ishte këtu dje. E pe djalin?	E pe djalin që ishte këtu dje?
Një çupë ishte këtu dje. E pa çupën.	E pa çupën që ishte këtu dje.

DRILLS

UNIT 15

(41) VARIATION

Erdha për të parë babanë.	Erdha që të shoh babanë.
Erdhi për të parë babanë.	Erdhi që të shohë babanë.
Erdhëm për të parë babanë.	Erdhëm që të shohim babanë.
Erdhët për të parë babanë.	Erdhët që të shihni babanë.
Erdhën për të parë babanë.	Erdhën që të shohin babanë.
Erdhe për të parë babanë.	Erdhe që të shohësh babanë.
Erdhi për të parë babanë.	Erdhi që të shohë babanë.
Erdhën për të parë babanë.	Erdhën që të shohin babanë.

(42) EXPANSION

Nëmini t'i mat.	Nëmini që t'i mat.
Nëmini t'i shikoj.	Nëmini që t'i shikoj.
Nëmi t'i mat.	Nëmi që t'i mat.
Nëma ta provoj.	Nëma që ta provoj.
Nëmani ta mat.	Nëmani që ta mat.
Nëmani ta shikoj.	Nëmani që ta shikoj.
Nëma ta mat.	Nëma që ta mat.
Nëmëni një ta provoj.	Nëmëni një që ta provoj.

DRILLS

UNIT 15

(43) VARIATION

S'erdha, sepse s'kisha kohë.	S'erdha, pse s'kisha kohë.
Di shqip, sepse jam Shqiptar.	Di shqip, pse jam Shqiptar.
S'flet, sepse është tepër e vogël akoma.	S'flet, pse është tepër e vogël akoma.
Erdha, sepse doja të të flisja.	Erdha, pse doja të të flisja.
S'më flet, sepse u zemërua me mua.	S'më flet, pse u zemërua me mua.
S'ka kurrë para, sepse i pi.	S'ka kurrë para, pse i pi.
Vajta në Berat, sepse ime shoqe ishte e sëmurë.	Vajta në Berat, pse ime shoqe ishte e sëmurë.
Erdhëm, sepse na thanë se ishe i sëmurë.	Erdhëm, pse na thanë se ishe i sëmurë.

(44) RESPONSE

Pse nuk shkove?	Se s'mund të shkoja.
Pse nuk këceve?	Se s'mund të këceja.
Pse nuk punove?	Se s'mund të punoja.
Pse nuk ndenje?	Se s'mund të rrija.
Pse nuk shkoi?	Se s'mund të shkonte.
Pse nuk ndenji?	Se s'mund të rrinte.
Pse nuk punoi?	Se s'mund të punonte.
Pse nuk hëngri?	Se s'mund të hante.

DRILLS

UNIT 15

(45) VARIATION

Mirë që të takova.	Mirë se të takova.
Kam frikë që do të lodhesh.	Kam frikë se do të lodhesh.
Më duket që janë tepër të shkurtra.	Më duket se janë tepër të shkurtra.
Besoj që mbyllen më nëntë.	Besoj se mbyllen më nëntë.
Më tha që ishte i sëmurë.	Më tha se ishte i sëmurë.
Na thanë që do të ikin pasnesër.	Na thanë se do të ikin pasnesër.
Më thotë që s'është e martuar.	Më thotë se s'është e martuar.
I the që s'jam mirë?	I the se s'jam mirë?

(46) VARIATION

I thashë se ishe e sëmurë.	I thashë që ishe e sëmurë.
Besoj se kemi akoma disa pjepra.	Besoj që kemi akoma disa pjepra.
I duket se ajo nuk e do.	I duket që ajo nuk e do.
Më thatë se ishit të martuar.	Më thatë që ishit të martuar.
Thuaj se s'jam këtu.	Thuaj që s'jam këtu.
Na thanë se u bë avokat.	Na thanë që u bë avokat.
Nuk e besojnë se jam vetëm njëzet vjeç.	Nuk e besojnë që jam vetëm njëzet vjeç.

DRILLS

UNIT 15

(47) DIRECTED DIALOGUE

Pyeteni X-in ku ishte tërë mëngjesin.

Thuajini Z-it se ishit në treg.

Pyeteni X-in ç'bleu.

Thuajini Z-it se s'bletë asgjë.

Pyeteni X-in pse.

Thuajini Z-it se s'kishit asnjë lek.

Thuajini X-it se edhe ju ishit në treg.

Pyeteni Z-in a bleu diçka.

Thuajini X-it se bletë lloj lloj gjëra.

Pyeteni Z-in për kë i bleu, për familjen?

Thuajini X-it se sigurisht i bletë për familjen. Thoni se ka muaj që s'kini blerë gjë për veten tuaj.

DRILLS

UNIT 15

(48) DIRECTED DIALOGUE

Thuajini X-ës se ju pëlqejnë çorapet e saja.

Thuajini Z-ës se s'janë të këqija, por janë pak të trasha.

Thuajini X-ës më mirë të jenë tepër të trasha se tepër të holla.

Pyeteni Z-ën pse e thotë këtë.

Thuajini X-ës se e thoni, sepse dimrat e Tiranës janë mjaft të ftohëta.

Thuajini Z-ës se është e para herë që vini në Shqipëri dhe nuk e dini akoma klimën e vendit.

Pyeteni X-in si janë dimrat n'Amerikë.

Thuajini Z-ës se janë si ato që kanë këtu.

Pyeteni X-ën ajo si e di.

Thuajini Z-ës se kështu ju thotë burri.

DRILLS

UNIT 15

(49) DIRECTED DIALOGUE

Pyeteni X-in a banon këtu në qytet.

Thuajini Z-it se kini një shtëpi jashtë qytetit, afër detit.

Thuajini X-it se edhe ju kini n'Amerikë një shtëpi jashtë qytetit.

Pyeteni Z-in a është afër detit shtëpia e tij.

Thuajini X-it se vendi ku banoni është larg detit.

Thuajini Z-it se ju pëlqen shumë të veni për peshk.

Thuajini X-it se edhe ju shkoni për peshk pothuaj çdo javë.

Pyeteni Z-in si mund të vejë për peshk, kur deti është aq larg shtëpisë ku banon.

Thuajini X-it se veni për peshk në një lumë që është shumë afër shtëpisë.

DRILLS

UNIT 15

(50) DIRECTED DIALOGUE

Pyeteni X-ën ç'ngjyra i pëlqejnë më tepër.

Thuajini Z-ës se për rrobat ju pëlqen ngjyrë deti dhe kafe.

Thuajini X-ës se kafeja s'ju vete mirë.

Pyeteni Z-ën pse jo. Flokët e saj janë të zeza.

Thuajini X-ës se ju s'dini shumë nga ngjyrat, por kështu ju thotë gjithnjë nëna.

Thuajini Z-ës të mos dëgjojë ç'i thotë e ëma. Jini e sigurt se kafeja i vete shumë mirë.

Thuajini X-ës se do ta provoni një herë.

(51) DIRECTED DIALOGUE

Pyeteni X-in a mund të veni dhe ju për gjah.

Thuajini Z-it me gjithë qejf, vetëm se të tjerët thonë se është akoma foshnje.

Thuajini X-it se ai e di mirë se s'jini foshnje. Jini pesëmbëdhjetë vjeç.

Thuajini Z-it se e dini, por të tjerët janë të paktën tetëmbëdhjetë.

Thuajini X-it se s'është e vërtetë. Vasili është vetëm gjashtëmbëdhjetë e gjysmë.

Thuajini Z-it se nuk e besoni. Vëllezërit e tij ju thanë se është tetëmbëdhjetë.

Thuajini X-it se i thanë kështu, për ta marrë edhe Vasilin për gjah.

DRILLS

UNIT 15

(51) DIRECTED DIALOGUE

Thuajini X-it se kini një muaj në Shqipëri, por s'njihni pothuaj asnjë Shqiptar.

Pyeteni Z-in pse s'njihet me disa Shqiptarë.

Thuajini X-it sepse gruaja juaj s'di mirë shqip dhe s'doni ta lëni vetë.

Pyeteni Z-in pse erdhi në Shqipëri.

Thuajini X-it se erdhët për të mësuar shqip.

Thuajini Z-it se atëherë nuk duhej ta kish marrë gruan.

Thuajini X-it se gruaja juaj do shumë të mësojë shqip, por me ju flet gjithnjë anglisht.

Thuajini Z-it se ju njihni disa vajza që mund t'i tregojnë qytetin gruas.

END OF DRILLS FOR UNIT 15

DRILLS

UNIT 16

(1) SIMPLE SUBSTITUTION

dëgjova	Dëgjova se ka një lojë sot.
dëgjove	Dëgjove se ka një lojë sot.
dëgjuat	Dëgjuat se ka një lojë sot.
dëgjuam	Dëgjuam se ka një lojë sot.
më thanë	Më thanë se ka një lojë sot.
na thanë	Na thanë se ka një lojë sot.
kush ju tha?	Kush ju tha se ka një lojë sot?
kush të tha?	Kush të tha se ka një lojë sot?

(2) SIMPLE SUBSTITUTION

Tirana	Loz Tirana me Korçën.
Durrësi	Loz Durrësi me Korçën.
Berati	Loz Berati me Korçën.
Shkodra	Loz Shkodra me Korçën.
Elbasani	Loz Elbasani me Korçën.
Vlora	Loz Vlora me Korçën.
Tepelena	Loz Tepelena me Korçën.
Gjirokastra	Loz Gjirokastra me Korçën.

DRILLS

UNIT 16

(3) SIMPLE SUBSTITUTION

fillon	Loja fillon më dy e një çerek.
filloi	Loja filloi më dy e një çerek.
fillonte	Loja fillonte më dy e një çerek.
do të fillojë	Loja do të fillojë më dy e një çerek.
filloi	Loja filloi më dy e një çerek.
fillon	Loja fillon më dy e një çerek.
fillonte	Loja fillonte më dy e një çerek.
do të fillojë	Loja do të fillojë më dy e një çerek.

(4) SIMPLE SUBSTITUTION

futboll	Unë loz mendsh për futboll.
gjah	Unë loz mendsh për gjah.
tenis	Unë loz mendsh për tenis.
basketboll	Unë loz mendsh për basketboll.
atë vajzë	Unë loz mendsh për atë vajzë.
atë çupë	Unë loz mendsh për atë çupë.
atë grua	Unë loz mendsh për atë grua.
atë	Unë loz mendsh për atë.

DRILLS

UNIT 16

(5) RESPONSE

Vallë a do të gjejmë vend?	Mos u bëj merak.	Ka vend sa të duash.
Vallë a do të gjejmë bileta?	Mos u bëj merak.	Ka bileta sa të duash.
Vallë a do të gjejmë akullore?	Mos u bëj merak.	Ka akullore sa të duash.
Vallë a do të gjejmë pjepra?	Mos u bëj merak.	Ka pjepra sa të duash.
Vallë a do të gjejmë birrë?	Mos u bëj merak.	Ka birrë sa të duash.
Vallë a do të gjejmë oriz?	Mos u bëj merak.	Ka oriz sa të duash.
Vallë a do të gjejmë shishqebap?	Mos u bëj merak.	Ka shishqebap sa të duash.
Vallë a do të gjejmë peshk?	Mos u bëj merak.	Ka peshk sa të duash.

DRILLS

UNIT 16

(6) SIMPLE SUBSTITUTION

e lozin	Thuamë si e lozin këtu.
e këcejnë	Thuamë si e këcejnë këtu.
e këndojnë	Thuamë si e këndojnë këtu.
e bëjnë	Thuamë si e bëjnë këtu.
bëhet	Thuamë si bëhet këtu.
këcehet	Thuamë si këcehet këtu.
këndohet	Thuamë si këndohet këtu.
e gatuajnë	Thuamë si e gatuajnë këtu.

(7) RESPONSE

A ka ndryshim nga futbolli ynë?	S'kam dijeni fare si e lozni ju.
A ka ndryshim nga vallja jonë?	S'kam dijeni fare si e këceni ju.
A ka ndryshim nga shqipja jonë?	S'kam dijeni fare si e flitni ju.
A ka ndryshim nga shishqeba-pi ynë?	S'kam dijeni fare si e bëni ju.
A ka ndryshim nga kafeja jonë?	S'kam dijeni fare si e bëni ju.
A ka ndryshim nga basket-bolli ynë?	S'kam dijeni fare si e lozni ju.
A ka ndryshim nga tenisi ynë?	S'kam dijeni fare si e lozni ju.
A ka ndryshim nga pilafi ynë?	S'kam dijeni fare si e bëni ju.

DRILLS

UNIT 16

(8) MULTIPLE CORRELATION

lojtarët	Ja, tani zënë të dalin lojtarët.
dielli	Ja, tani zë të dalë dielli.
hëna	Ja, tani zë të dalë hëna.
kuajt	Ja, tani zënë të dalin kuajt.
ushtarët	Ja, tani zënë të dalin ushtarët.
nxënësit	Ja, tani zënë të dalin nxënësit.
hëna	Ja, tani zë të dalë hëna.
dielli	Ja, tani zë të dalë dielli.

(9) SUBSTITUTION IN VARIABLE SLOT

Pse është i rrumbullaktë topi?

ishte	Pse ishte i rrumbullaktë topi?
topat	Pse ishin të rrumbullaktë topat?
janë	Pse janë të rrumbullaktë topat?
hëna	Pse është e rrumbullaktë hëna?
ishte	Pse ishte e rrumbullaktë hëna?
topi	Pse ishte i rrumbullaktë topi?
është	Pse është i rrumbullaktë topi?

DRILLS

UNIT 16

(10) RESPONSE

Pse është i rrumbullaktë topi? Mos do të jetë si bostan?

Pse janë të rrumbullaktë portokajt? Mos do të jenë si bostane?

Pse është e rrumbullaktë hëna? Mos do të jetë si bostan?

Pse është i rrumbullaktë diallli? Mos do të jetë si bostan?

Pse janë të rrumbullaktë topat? Mos do të jenë si bostane?

Pse janë të rrumbullakta qepët? Mos do të jenë si bostane?

Pse është i rrumbullaktë portokalli? Mos do të jetë si bostan?

Pse është e rrumbullaktë qepa? Mos do të jetë si bostan?

(11) SIMPLE CORRELATION

ai — Ej, ai po bredh me top ndër këmbë.

ti — Ej, ti po bredh me top ndër këmbë.

ju — Ej, ju po bridhni me top ndër këmbë.

ata — Ej, ata po bredhin me top ndër këmbë.

ti — Ej, ti po bredh me top ndër këmbë.

ai — Ej, ai po bredh me top ndër këmbë.

ju — Ej, ju po bridhni me top ndër këmbë.

ata — Ej, ata po bredhin me top ndër këmbë.

DRILLS

UNIT 16

(12) SIMPLE SUBSTITUTION

soccer	Kësaj i thonë soccer n'Amerikë.
cross-country	Kësaj i thonë cross-country n'Amerikë.
basket-ball	Kësaj i thonë basket-ball n'Amerikë.
volley-ball	Kësaj i thonë volley-ball n'Amerikë.
baseball	Kësaj i thonë baseball n'Amerikë.
football	Kësaj i thonë football n'Amerikë.
golf	Kësaj i thonë golf n'Amerikë.
tennis	Kësaj i thonë tennis n'Amerikë.

(13) SIMPLE CORRELATION

ta dija kështu	Ta dija kështu, s'kisha ardhur fare.
ta dinte kështu	Ta dinte kështu, s'kishte ardhur fare.
ta dinte këtë	Ta dinte këtë, s'kishte ardhur fare.
t'i dinte këto	T'i dinte këto, s'kishte ardhur fare.
t'i dija këto gjëra	T'i dija këto gjëra, s'kisha ardhur fare.
ta dija këtë	Ta dija këtë, s'kisha ardhur fare.
t'i dinte këto gjëra	T'i dinte këto gjëra, s'kishte ardhur fare.
t'i dija këto	T'i dija këto, s'kisha ardhur fare.

DRILLS

UNIT 16

(14) SIMPLE CORRELATION (omit cue from response)

ti	Ki durim.
ju	Kini durim.
ai	Të ketë durim.
ata	Të kenë durim.
ju	Kini durim.
ato	Të kenë durim.
ajo	Të ketë durim.
ti	Ki durim.

(15) SIMPLE CORRELATION (omit cue from response)

ti	Do të zbavitesh pa tjetër.
ne	Do të zbavitemi pa tjetër.
unë	Do të zbavitem pa tjetër.
ata	Do të zbaviten pa tjetër.
ju	Do të zbaviteni pa tjetër.
ai	Do të zbavitet pa tjetër.
ti	Do të zbavitesh pa tjetër.
ajo	Do të zbavitet pa tjetër.

DRILLS

UNIT 16

(16) SIMPLE CORRELATION (with nominative indefinite cues)

mot	Është ndeshja më me rëndësi e motit.
javë	Është ndeshja më me rëndësi e javës.
vit	Është ndeshja më me rëndësi e vitit.
muaj	Është ndeshja më me rëndësi e muajit.
javë	Është ndeshja më me rëndësi e javës.
mot	Është ndeshja më me rëndësi e motit.
muaj	Është ndeshja më me rëndësi e muajit.
ditë	Është ndeshja më me rëndësi e ditës.

(17) SIMPLE CORRELATION

erdha	Tani që erdha, do të rri me doemos.
erdhe	Tani që erdhe, do të rrish me doemos.
erdhëm	Tani që erdhëm, do të rrimë me doemos.
erdhi	Tani që erdhi, do të rrijë me doemos.
erdhën	Tani që erdhën, do të rrinë me doemos.
erdhët	Tani që erdhët, do të rrini me doemos.
erdha	Tani që erdha, do të rri me doemos.
erdhëm	Tani që erdhëm, do të rrimë me doemos.

DRILLS

UNIT 16

(18) SIMPLE CORRELATION (omit cue from response)

unë	Të ve mend për tjetër herë.
ai	Të verë mend për tjetër herë.
ju	Të vini mend për tjetër herë.
ata	Të venë mend për tjetër herë.
ne	Të vemë mend për tjetër herë.
ti	Të vesh mend për tjetër herë.
ju	Të vini mend për tjetër herë.
ajo	Të verë mend për tjetër herë.

(19) SIMPLE CORRELATION

loja	Si t'u duk loja?
vajzat	Si t'u dukën vajzat?
e motra	Si t'u duk e motra?
hoteli	Si t'u duk hoteli?
lojtarët tonë	Si t'u dukën lojtarët tonë?
kuajt e tyre	Si t'u dukën kuajt e tyre?
filmi	Si t'u duk filmi?
filmat*	Si t'u dukën filmat?

* Also <u>filmet</u>.

DRILLS

UNIT 16

(20) SIMPLE CORRELATION (omit cue from response)

ne	Ç'e do që humbëm.
ju	Ç'e do që humbët.
unë	Ç'e do që humba.
ata	Ç'e do që humbën.
ti	Ç'e do që humbe.
ai	Ç'e do që humbi.
unë	Ç'e do që humba.
ne	Ç'e do që humbëm.

(21) SIMPLE CORRELATION (with free forms of pronouns as cues)

na	S'na dihmoi fati këtë radhë.
mua	S'më ndihmoi fati këtë radhë.
ty	S'të ndihmoi fati këtë radhë.
ata	S'i ndihmoi fati këtë radhë.
mua	S'më ndihmoi fati këtë radhë.
ju	S'ju ndihmoi fati këtë radhë.
ne	S'na ndihmoi fati këtë radhë.
atë	S'e ndihmoi fati këtë radhë.

DRILLS

UNIT 16

(22) SIMPLE SUBSTITUTION

në Tiranë	Asnjëherë s'ka fituar Korça në Tiranë.
këtu	Asnjëherë s'ka fituar Korça këtu.
atje	Asnjëherë s'ka fituar Korça atje.
në Durrës	Asnjëherë s'ka fituar Korça në Durrës.
në Vlorë	Asnjëherë s'ka fituar Korça në Vlorë.
në Shkodër	Asnjëherë s'ka fituar Korça në Shkodër.
në Gjirokastër	Asnjëherë s'ka fituar Korça në Gjirokastër.
n'Elbasan	Asnjëherë s'ka fituar Korça n'Elbasan.

(23) SIMPLE SUBSTITUTION

sot	Çuditem si ngjau sot.
mbrëmë	Çuditem si ngjau mbrëmë.
dje	Çuditem si ngjau dje.
pardje	Çuditem si ngjau pardje.
atëherë	Çuditem si ngjau atëherë.
javën e shkuar	Çuditem si ngjau javën e shkuar.
të dielën	Çuditem si ngjau të dielën.
të shtunën	Çuditem si ngjau të shtunën.

DRILLS

UNIT 16

(24) SIMPLE SUBSTITUTION

të dielën	Nejse, të dielën që vjen i mundim në Korçë.
të shtunën	Nejse, të shtunën që vjen i mundim në Korçë.
javën	Nejse, javën që vjen i mundim në Korçë.
vitin	Nejse, vitin që vjen i mundim në Korçë.
muajin	Nejse, muajin që vjen i mundim në Korçë.
motin	Nejse, motin që vjen i mundim në Korçë.
të premten	Nejse, të premten që vjen i mundim në Korçë.
të enjten	Nejse, të enjten që vjen i mundim në Korçë.

(25) SIMPLE SUBSTITUTION

m'u dogj	M'u dogj fyti nga etja.
na u dogj	Na u dogj fyti nga etja.
i u dogj	I u dogj fyti nga etja.
s'ju u dogj?	S'ju u dogj fyti nga etja?
s't'u dogj?	S't'u dogj fyti nga etja?
na u dogj	Na u dogj fyti nga etja.
m'u dogj	M'u dogj fyti nga etja.
i u dogj	I u dogj fyti nga etja.

DRILLS

UNIT 16

(26) MULTIPLE CORRELATION

ulemi	Ulemi dhe marrim nga një akullore.
ulu	Ulu dhe merr një akullore.
uluni	Uluni dhe merrni nga një akullore.
rri poshtë	Rri poshtë dhe merr një akullore.
rrini poshtë	Rrini posthë dhe merrni nga një akullore.
çlodhemi	Çlodhemi dhe marrim nga një akullore.
çlodhuni	Çlodhuni dhe merrni nga një akullore.
çlodhu	Çlodhu dhe merr një akullore.

(27) DOUBLE SUBSTITUTION

mua, ma	Mua vetëm një shishe birrë ma shuan etjen.
ty, ta	Ty vetëm një shishe birrë ta shuan etjen.
atij, ja	Atij vetëm një shishe birrë ja shuan etjen.
atyre, ua	Atyre vetëm një shishe birrë ua shuan etjen.
asaj, ja	Asaj vetëm një shishe birrë ja shuan etjen.
ty, ta	Ty vetëm një shishe birrë ta shuan etjen.
mua, ma	Mua vetëm një shishe birrë ma shuan etjen.
atyre, ua	Atyre vetëm një shishe birrë ua shuan etjen.

DRILLS

UNIT 16

(28) SIMPLE CORRELATION

kuletën	Uh, s'e paskam kuletën!
çelësit	Uh, s'i paskam çelësit!
çelësin	Uh, s'e paskam çelësin!
biletat	Uh, s'i paskam biletat!
paratë	Uh, s'i paskam paratë!
thesin	Uh, s'e paskam thesin!
pallton	Uh, s'e paskam pallton!
thasët	Uh, s'i paskam thasët!

(29) SIMPLE CORRELATION (omit cue from response)

kuletën	Do ta ketë vjedhur ndonjë.
paratë	Do t'i ketë vjedhur ndonjë.
pallton	Do ta ketë vjedhur ndonjë.
rrobat	Do t'i ketë vjedhur ndonjë.
çelësin	Do ta ketë vjedhur ndonjë.
këpucët	Do t'i ketë vjedhur ndonjë.
frytet	Do t'i ketë vjedhur ndonjë.
topin	Do ta ketë vjedhur ndonjë.

DRILLS

UNIT 16

(30) SIMPLE CORRELATION (omit cue from response)

ti	Mund të më japësh disa të holla borxh?
ai	Mund të më japë disa të holla borxh?
ata	Mund të më japin disa të holla borxh?
ju	Mund të më jepni disa të holla borxh?
ajo	Mund të më japë disa të holla borxh?
ti	Mund të më japësh disa të holla borxh?
ato	Mund të më japin disa të holla borxh?
ju	Mund të më jepni disa të holla borxh?

(31) SIMPLE SUBSTITUTION

më nevojiten	Më nevojiten dyzet e pesë lekë.
i nevojiten	I nevojiten dyzet e pesë lekë.
ju nevojiten	Ju nevojiten dyzet e pesë lekë.
na nevojiten	Na nevojiten dyzet e pesë lekë.
të nevojiten	Të nevojiten dyzet e pesë lekë.
u nevojiten	U nevojiten dyzet e pesë lekë.
më nevojiten	Më nevojiten dyzet e pesë lekë.
na nevojiten	Na nevojiten dyzet e pesë lekë.

DRILLS

UNIT 16

(32) SIMPLE SUBSTITUTION

për të paguar hotelin	Më lypsen sa për të paguar hotelin.
për të blerë një kostum	Më lypsen sa për të blerë një kostum.
për t'i dhënë bakshish djalit	Më lypsen sa për t'i dhënë bakshish djalit.
për të dërguar një letër	Më lypsen sa për të dërguar një letër.
për të vajtur në kinema	Më lypsen sa për të vajtur në kinema.
për të vajtur në Berat	Më lypsen sa për të vajtur në Berat.
për të ngrënë bukë	Më lypsen sa për të ngrënë bukë.
për të marrë një akullore	Më lypsen sa për të marrë një akullore.

(33) SIMPLE CORRELATION (omit cue from response)

ne	Këtu duhet gjithnjë të japim bakshish.
ai	Këtu duhet gjithnjë të japë bakshish.
ti	Këtu duhet gjithnjë të japësh bakshish.
ju	Këtu duhet gjithnjë të jepni bakshish.
ata	Këtu duhet gjithnjë të japin bakshish.
ne	Këtu duhet gjithnjë të japim bakshish.
ti	Këtu duhet gjithnjë të japësh bakshish.
ajo	Këtu duhet gjithnjë të japë bakshish.

DRILLS

UNIT 16

ANALYSIS 1: <u>lë</u> AND <u>ve</u>

(34) RESPONSE

Ku e lini automobilin?	E lë afër postës.
Ku e vini automobilin?	E vemë afër postës.
Ku e lini automobilin, zotërinj?	E lëmë afër postës.
Ku e vini automobilin, zotërinj?	E vemë afër postës.
Ku e lini djalin?	E lë afër postës.
Ku e lini djalin, zotërinj?	E lëmë afër postës.
Ku e lini automobilin?	E lëmë afër postës.
Ku e vini automobilin?	E vemë afër postës.

DRILLS

UNIT 16

ANALYSIS 2: THE WORD <u>vallë</u>

(35) EXPANSION

A do të gjejmë vend?	Vallë a do të gjejmë vend?
Kur do të martohen?	Vallë kur do të martohen?
Pse nuk u martua akoma?	Vallë pse nuk u martua akoma?
Kush të jetë ai?	Vallë kush të jetë ai?
Ku të jenë djemtë?	Vallë ku të jenë djemtë?
Të jetë e vërtetë?	Vallë të jetë e vërtetë?
Të jetë akoma i hapur këpucari?	Vallë të jetë akoma i hapur këpucari?
A do të gjejnë bileta?	Vallë a do të gjejnë bileta?

DRILLS

UNIT 16

ANALYSIS 3: THE WORD mos

(36) STRUCTURE REPLACEMENT

Bëhu oficer.	Mos u bëj oficer.
Shko tani.	Mos shko tani.
Flitni anglisht.	Mos flitni anglisht.
Folë shpejt.	Mos folë shpejt.
Hyni brenda.	Mos hyni brenda.
Bëhu avokat.	Mos u bëj avokat.
Hyp lart.	Mos hyp lart.
Zbrit poshtë.	Mos zbrit poshtë.

(37) VARIATION

Më duket se është mbaruar.	Kam frikë mos është mbaruar.
Më duket se janë të mbyllur.	Kam frikë mos janë të mbyllur.
Më duket se është e sëmurë.	Kam frikë mos është e sëmurë.
Më duket se ka filluar filmi.	Kam frikë mos ka filluar filmi.
Më duket se erdhëm pak si vonë.	Kam frikë mos erdhëm pak si vonë.
Më duket se janë të sëmurë.	Kam frikë mos janë të sëmurë.
Më duket se do të bjerë shi.	Kam frikë mos bjerë shi.
Më duket se do të bëjë ftohët nesër.	Kam frikë mos bëjë ftohët nesër.
Më duket se do të bjerë borë.	Kam frikë mos bjerë borë.

DRILLS

UNIT 16

(38) VARIATION

Mos bjerë.	Ki mendjen mos të biesh.
Mos u ktheh vonë.	Ki mendjen mos të kthehesh vonë.
Mos bini.	Kini mendjen mos të bini.
Mos ik përpara nesh.	Ki mendjen mos të ikësh përpara nesh.
Mos u nisni përpara meje.	Kini mendjen mos të niseni përpara meje.
Mos u ktheni vonë.	Kini mendjen mos të ktheheni vonë.
Mos ikni tepër vonë.	Kini mendjen mos të ikni tepër vonë.
Mos u nis tepër heret.	Ki mendjen mos të nisesh tepër heret.

(39) VARIATION

S'është si bostan.	Mos do të jetë si bostan?
S'flet si ne.	Mos do të flasë si ne?
S'janë si portokaj.	Mos do të jenë si portokaj?
S'është si Bostoni.	Mos do të jetë si Bostoni?
S'është si ty.	Mos do të jetë si ty?
S'flasin si ju.	Mos do të flasin si ju?
S'janë si Amerikanë.	Mos do të jenë si Amerikanë?
S'flasin si Shqiptarë.	Mos do të flasin si Shqiptarë?

DRILLS

UNIT 16

(40) VARIATION

Nuk e ke parë?	Mos e ke parë?
Nuk e kini ngrënë?	Mos e kini ngrënë?
Nuk të ka thënë gjë?	Mos të ka thënë gjë?
Nuk i kanë parë?	Mos i kanë parë?
Nuk e dëgjoi ajo?	Mos e dëgjoi ajo?
Nuk e dëgjuat ju?	Mos e dëgjuat ju?
Nuk i patë vajzat?	Mos i patë vajzat?
Nuk e takove Mihalin?	Mos e takove Mihalin?

DRILLS

UNIT 16

ANALYSIS 4: THE CONJUNCTIVE PARTICLE <u>të</u>

(41) STRUCTURE REPLACEMENT

Mund të shkoj unë.	Mund të shkoja unë.
Mund të shkojë ajo.	Mund të shkonte ajo.
Mund të këcej unë.	Mund të këceja unë.
Mund të këcejë ai.	Mund të këcente ai.
Mund ta bëjë ajo.	Mund ta bënte ajo.
Mund të ma mësojë nëna.	Mund të ma mësonte nëna.
Mund të mësoj edhe unë frengjisht.	Mund të mësoja edhe unë frengjisht.
S'mund ta besoj.	S'mund ta besoja.

(42) STRUCTURE REPLACEMENT

Unë do të punoj sot.	Unë do të punoja sot.
Do të niset sot.	Do të nisej sot.
Ai do të fillojë sot.	Ai do të fillonte sot.
Ajo do të mbarojë sot.	Ajo do të mbaronte sot.
Unë do t'i flas sot.	Unë do t'i flisja sot.
Do ta ha sot.	Do ta haja sot.
Aliu do të shkojë sot.	Aliu do të shkonte sot.
Unë do t'i zgjedh sot.	Unë do t'i zgjidhja sot.
Ai do të na mbledhë sot.	Ai do të na mblidhte sot.

DRILLS

UNIT 16

(43) VARIATION

Unë duhet të shkoj.	Unë duhej të shkoja.
Duhet t'u flas unë.	Duhej t'u flisja unë.
Duhet ta ha unë.	Duhej ta haja unë.
Duhet ta pijë ai.	Duhej ta pinte ai.
Duhet t'i zgjedhë ai.	Duhej t'i zgjidhte ai.
Duhet të këcejë dhe ajo.	Duhej të këcente dhe ajo.
Duhet të më dëgjojë.	Duhej të më dëgjonte.
Duhet ta dëgjoj.	Duhej ta dëgjoja.

(44) COMBINATION

Vjen ai. Do të zemërohem.	Po të vijë ai, do të zemërohem.
Rri këtu ti. Do të zemërohem.	Po të rrish këtu ti, do të zemërohem.
Rri këtu ajo. Do të zemërohemi.	Po të rrijë këtu ajo, do të zemërohemi.
Vjen ajo. Do të zemërohemi.	Po të vijë ajo, do të zemërohemi.
Këcen ai. Unë s'këcej.	Po të këcejë ai, unë s'këcej.
Vjen Aliu. Unë s'vij.	Po të vijë Aliu, unë s'vij.
Ikën Aliu. Do të iki edhe unë.	Po të ikë Aliu, do të iki edhe unë.
Ikën ti. Do të ikim edhe ne.	Po të ikësh ti, do të ikim edhe ne.

DRITJS

UNIT 16

(45) REDUCTION

Po ta dija, s'kisha ardhur.	Ta dija, s'kisha ardhur.
Po ta dinte, s'kishte folur.	Ta dinte, s'kishte folur.
Po ta kisha, do ta haja.	Ta kisha, do ta haja.
Po të kisha para, do të paguaja.	Të kisha para, do të paguaja.
Po të kishte para, do të na paguante.	Të kishte para, do të na paguante.
Po të ishte i sëmurë, do të ishte në spital.	Të ishte i sëmurë do të ishte në spital.
Po të isha Shqiptar, do të flisja mirë shqip.	Të isha Shqiptar, do të flisja mirë shqip.
Po të isha burrë, do t'i tregoja unë.*	Të isha burrë, do t'i tregoja unë.

* Or: Po të isha burrë, ja tregoja unë qejfin.

DRILLS

UNIT 16

(46) RESPONSE

Është vonë të shkojmë tani.	Më mirë të shkojmë nesër.
Është vonë të fillojmë tani.	Më mirë të fillojmë nesër.
Është vonë të shkosh tani.	Më mirë të shkoj nesër.
Është vonë të nisemi tani.	Më mirë të nisemi nesër.
Është vonë të fillojë tani.	Më mirë të fillojë nesër.
Është vonë të niseni tani.	Më mirë të nisemi nesër.
Është vonë t'i shkruash tani.	Më mirë t'i shkruaj nesër.
Është vonë të ikni tani.	Më mirë të ikim nesër.

(47) RESPONSE

Të hamë tani.	Të hanë dhe ata me ne?
Të fillojmë tani.	Të fillojnë dhe ata me ne?
Të mbarojmë tani.	Të mbarojnë dhe ata me ne?
Të këndojmë tani.	Të këndojnë dhe ata me ne?
Të këcejmë tani.	Të këcejnë dhe ata me ne?
Të ikim tani.	Të ikin dhe ata me ne?
Të pimë tani.	Të pinë dhe ata me ne?
Të shkojmë tani.	Të shkojnë dhe ata me ne?

DRILLS

UNIT 16

(48) VARIATION

Shkruaji Llazarit.	T'i shkruash Llazarit.
Mbylle derën.	Ta mbyllësh derën.
Hape dritaren.	Ta hapësh dritaren.
Shko tani.	Të shkosh tani.
Thuaj të vërtetën.	Të thuash të vërtetën.
Jepi ca qumësht.	T'i japësh ca qumësht.
Jepini ca para.	T'i jepni ca para.
Merrini të gjitha dhentë.	T'i merrni të gjitha dhentë.
Merre çelësin.	Ta marrësh çelësin.

DRILLS

UNIT 16

ANALYSIS 5: THE THIRD PERSON PRONOUN MARGINAL FORMS

(49) SIMPLE CORRELATION

atij	Atij s'i kemi dhënë gjë.
asaj	Asaj s'i kemi dhënë gjë.
atyre	Atyre s'u kemi dhënë gjë.
asaj	Asaj s'i kemi dhënë gjë.
atyre	Atyre s'u kemi dhënë gjë.
atij	Atij s'i kemi dhënë gjë.
asaj	Asaj s'i kemi dhënë gjë.
atyre	Atyre s'u kemi dhënë gjë.

(50) MULTIPLE CORRELATION (omit, of course, nominative indef. cues)

burrë	T'i jap një mollë atij?
grua	T'i jap një mollë asaj?
gra	T'u jap një mollë atyre?
vajza	T'u jap një mollë atyre?
burra	T'u jap një mollë atyre?
djalë	T'i jap një mollë atij?
çun	T'i jap një mollë atij?
çupë	T'i jap një mollë asaj?

DRILLS

UNIT 16

(51) SIMPLE CORRELATION (with nominative cues)

djalë	Ç'i dhe këtij djali?
çupë	Ç'i dhe kësaj çupe?
çun	Ç'i dhe këtij çuni?
burrë	Ç'i dhe këtij burri?
grua	Ç'i dhe kësaj gruaje?
Amerikane	Ç'i dhe kësaj Amerikaneje?
vajzë	Ç'i dhe kësaj vajze?
Shqiptar	Ç'i dhe këtij Shqiptari?

(52) TRANSLATION DRILL

TEACHER: Man.
STUDENT: Këtij shqip i thonë burrë.
TEACHER: Këtij shqip i thonë burrë.
STUDENT: Këtij shqip i thonë burrë.

man	Këtij shqip i thonë burrë.
women	Këtyre shqip u thonë gra.
horse	Këtij shqip i thonë kalë.
girl	Kësaj shqip i thonë vajzë.
horses	Këtyre shqip u thonë kuaj.
mountain	Këtij shqip i thonë mal.
children	Këtyre shqip u thonë fëmijë.
house	Kësaj shqip i thonë shtëpi.

DRILLS

UNIT 16

(53) DIRECTED DIALOGUE

Thuajini X-it se dëgjuat që u kthye i vëllai nga Shkodra.

Pyeteni Z-in ku e dëgjoi.

Thuajini X-it se jua tha Sotir Butka.

Pyeteni Z-in nga i mëson vallë Sotiri të gjitha.

Thuajini X-it se ai ka kohë për këto gjëra, sepse s'punon më.

Thuajini Z-it se ashtu është. Do t'ju pëlqente dhe juve të rrini tërë ditën në kafene pa bërë gjë.

Thuajini X-it të ketë akoma durim edhe disa vjet, dhe do të çlodhet edhe ai.

(54) DIRECTED DIALOGUE

Pyeteni X-in a ka këpucë të kuqe.

Pyeteni Z-ën a i do për veten e saj.

Thuajini X-it po.

Thuajini Z-ës se kini këpucë të kuqe vetëm për foshnje, por jo për gra.

Pyeteni X-in a ka jeshile.

Thuajini Z-ës se ju vjen keq, por për gra kini vetëm këpucë të zeza ose kafe.

Thuajini X-it se s'kini fat sot. Ky është i treti dyqan që pyetni.

Thuajini Z-ës se ju vjen shumë keq.

DRILLS

UNIT 16

(55) DIRECTED DIALOGUE

Thuajini X-it se s'e ndjeni veten mirë sonte.

Thuajini Z-it se natyrisht, sepse hëngri shumë për drekë.

Thuajini X-it se me të vërtetë u ngopët sot.

Pyeteni Z-in pse ha kaq shumë.

Thuajini X-it se restorantet këtu janë aq të shtrenjta, sa që hani gjithnjë çdo gjë që ju venë përpara.

Pyeteni Z-in mos ha ndryshe në shtëpi.

Thuajini X-it se në shtëpi hani shumë pak, pse gruaja juaj s'di të gatuajë mirë.

(56) DIRECTED DIALOGUE

Thuajini X-it se çuditeni si s'kan ardhur akoma fëmijët nga shkolla.

Thuajini Z-ës se jini i sigurt se lozin me top në rrugë.

Thuajini X-it se u thatë të vijnë drejt në shtëpi.

Thuajini Z-ës se ashtu janë djemtë. Nuk dëgjojnë as nënën as njeri.

Thuajini X-it se ashtu është. Po të ishin vajza, do të ishte ndryshe.

Thuajini Z-ës se ju do të donit të bënit një vajzë.

Thuajini X-it se del prapë djalë. Provuat tri herë dhe s'u bë gjë.

(continued)

DRILLS

UNIT 16

(56) (continued)

Thuajini Z-ës se mirë thotë. Thoni se edhe djemtë s'janë të këqij.

Thuajini X-it se e thotë këtë, pse ai nuk rri tërë ditën në shtëpi me tre djaj që bredhin lart e poshtë dhe s'rrinë as një minutë në vend.

Thuajini Z-ës se e dini, por ç'mund të bëni ju. Pyeteni po të dojë ajo të vejë në zyrë çdo mëngjes dhe të rrini ju në shtëpi.

END OF DRILLS FOR UNIT 16

DRILLS

UNIT 17

(1) SIMPLE SUBSTITUTION

zakonet tuaja	Desha të më spiegosh zakonet tuaja mbi gjakun.
zakonet e tyre	Desha të më spiegosh zakonet e tyre mbi gjakun.
zakonet shqiptare	Desha të më spiegosh zakonet shqiptare mbi gjakun.
zakonet që kini	Desha të më spiegosh zakonet që kini mbi gjakun.
zakonet që kanë	Desha të më spiegosh zakonet që kanë mbi gjakun.
zakonet e Sqiptarëvet	Desha të më spiegosh zakonet e Shqiptarëvet mbi gjakun.
zakonet tuaja	Desha të më spiegosh zakonet tuaja mbi gjakun.
zakonet e tyre	Desha të më spiegosh zakonet e tyre mbi gjakun.

DRILLS

UNIT 17

(2) SIMPLE SUBSTITUTION

do të na flasësh	Kur do të na flasësh përmbi hakmarrjen?
do të na flitni	Kur do të na flitni përmbi hakmarrjen?
do të na flasë	Kur do të na flasë përmbi hakmarrjen?
do të na flasin	Kur do të na flasin përmbi hakmarrjen?
do t'ju flasë	Kur do t'ju flasë përmbi hakmarrjen?
do t'ju flasin	Kur do t'ju flasin përmbi hakmarrjen?
do t'u flasin	Kur do t'u flasin përmbi hakmarrjen?
do t'u flasësh	Kur do t'u flasësh përmbi hakmarrjen?

(3) SIMPLE CORRELATION

dy vjet	Sot mbushen tamam dy vjet.
një vit	Sot mbushet tamam një vit.
tre muaj	Sot mbushen tamam tre muaj.
tre vjet	Sot mbushen tamam tre vjet.
një muaj	Sot mbushet tamam një muaj.
katër vjet	Sot mbushen tamam katër vjet.
një vit	Sot mbushet tamam një vit.
pesë vjet	Sot mbushen tamam pesë vjet.

DRILLS

UNIT 17

(4) STRUCTURE REPLACEMENT

E dëgjova shpeshherë.	E kam dëgjuar shpeshherë.
E takova shpeshherë.	E kam takuar shpeshherë.
E pashë shpeshherë.	E kam parë shpeshherë.
E shikova shpeshherë.	E kam shikuar shpeshherë.
E këndova shpeshherë.	E kam kënduar shpeshherë.
E piva shpeshherë.	E kam pirë shpeshherë.
E provova shpeshherë.	E kam provuar shpeshherë.
E hëngra shpeshherë.	E kam ngrënë shpeshherë.

(5) SIMPLE SUBSTITUTION

e vendit	Na mësuan të respektojmë ligjët* e vendit.
e Shqipërisë	Na mësuan të respektojmë ligjët e Shqipërisë.
e Anglisë	Na mësuan të respektojmë ligjët e Anglisë.
e Francës	Na mësuan të respektojmë ligjët e Francës.
e Amerikës	Na mësuan të respektojmë ligjët e Amerikës.
e Turqisë	Na mësuan të respektojmë ligjët e Turqisë.
e Italisë	Na mësuan të respektojmë ligjët e Italisë.
e vendit	Na mësuan të respektojmë ligjët e vendit.

* Also <u>ligjet</u>.

DRILLS

UNIT 17

(6) SIMPLE SUBSTITUTION

gjaku	Gjaku ka qenë një ligjë nderi e trashëguar* prej shumë vjetve më parë.
hakmarrja	Hakmarrja ka qenë një ligjë nderi e trashëguar prej shumë vjetve më parë.
kjo	Kjo ka qenë një ligjë nderi e trashëguar prej shumë vjetve më parë.
ky zakon	Ky zakon ka qenë një ligjë nderi e trashëguar prej shumë vjetve më parë.
ky zakon shqiptar	Ky zakon shqiptar ka qenë një ligjë nderi e trashëguar prej shumë vjetve më parë.
gjaku në Shqipëri	Gjaku në Shqipëri ka qenë një ligjë nderi e trashëguar prej shumë vjetve më parë.
hakmarrja në Shqipëri	Hakmarrja në Shqipëri ka qenë një ligjë nderi e trashëguar prej shumë vjetve më parë.
ky zakon i Shqiptarëvet	Ky zakon i Shqiptarëvet ka qenë një ligjë nderi e trashëguar prej shumë vjetve më parë.

* Also <u>një ligj nderi i trashëguar</u>.

DRILLS

UNIT 17

(7) SIMPLE SUBSTITUTION

gjak	Dua të pyes, ç'është shkaku që quhet gjak?
hakmarrje	Dua të pyes, ç'është shkaku që quhet hakmarrje?
rrobaqepës	Dua të pyes, ç'është shka ku që quhet rrobaqepës?
këpucar	Dua të pyes, ç'është shkaku që quhet këpucar?
mësuese	Dua të pyes, ç'është shkaku që quhet mësuese?
shkollë e mesme	Dua të pyes, ç'është shkaku që quhet shkollë e mesme?
shkollë fillore	Dua të pyes, ç'është shkaku që quhet shkollë fillore?
shishqebap	Dua të pyes, ç'është shkaku që quhet shishqebap?

DRILLS

UNIT 17

(8) SIMPLE CORRELATION (with personal pronouns as cues)

ne	Fisi ynë njihet në tërë Shqipërinë.
ti	Fisi yt njihet në tërë Shqipërinë.
unë	Fisi im njihet në tërë Shqipërinë.
ai	Fisi i tij njihet në tërë Shqipërinë.
ata	Fisi i tyre njihet në tërë Shqipërinë.
ju	Fisi juaj njihet në tërë Shqipërinë.
ajo	Fisi i saj njihet në tërë Shqipërinë.
ne	Fisi ynë njihet në tërë Shqipërinë.

(9) SIMPLE CORRELATION

vit	Çdo vit vritet një pjesëtar i familjes sonë.
javë	Çdo javë vritet një pjesëtar i familjes sonë.
ditë	Çdo ditë vritet një pjesëtar i familjes sonë.
natë	Çdo natë vritet një pjesëtar i familjes sonë.
muaj	Çdo muaj vritet një pjesëtar i familjes sonë.
vit	Çdo vit vritet një pjesëtar i familjes sonë.
muaj	Çdo muaj vritet një pjesëtar i familjes sonë.
javë	Çdo javë vritet një pjesëtar i familjes sonë.

DRILLS

UNIT 17

(10) SIMPLE CORRELATION

ky njeri	Ky njeri s'ka armiq.
ju	Ju s'kini armiq.
ti	Ti s'ke armiq.
unë	Unë s'kam armiq.
këta njerëz	Këta njerëz s'kanë armiq.
ne	Ne s'kemi armiq.
kjo grua	Kjo grua s'ka armiq.
ti	Ti s'ke armiq.

(11) SIMPLE CORRELATION

unë	Unë s'kam fyer asnjeri.
ata	Ata s'kanë fyer asnjeri.
Xhevati	Xhevati s'ka fyer asnjeri.
ti	Ti s'ke fyer asnjeri.
ne	Ne s'kemi fyer asnjeri.
Lluka dhe Franku	Lluka dhe Franku s'kanë fyer asnjeri.
ju	Ju s'kini fyer asnjeri.
ti	Ti s'ke fyer asnjeri.

DRILLS

UNIT 17

(12) SIMPLE SUBSTITUTION

armiqtë	Burrin e saj e kanë vrarë armiqtë.
Shqiptarët	Burrin e saj e kanë vrarë Shqiptarët.
Amerikanët	Burrin e saj e kanë vrarë Amerikanët.
Anglezët	Burrin e saj e kanë vrarë Anglezët.
Frengët	Burrin e saj e kanë vrarë Frengët.
Italianët	Burrin e saj e kanë vrarë Italianët.
Rusët	Burrin e saj e kanë vrarë Rusët.
Gjermanët	Burrin e saj e kanë vrarë Gjermanët.

(13) SIMPLE SUBSTITUTION

marr hakën	Do të rri këtu derisa* të marr hakën.
dalin jashtë	Do të rri këtu derisa të dalin jashtë.
hapin dyqanin	Do të rri këtu derisa të hapin dyqanin.
mbyllin kafenenë	Do të rri këtu derisa të mbyllin kafenenë.
më thotë të vërtetën	Do të rri këtu derisa të më thotë të vërtetën.
më thoni pse e bëtë këtë	Do të rri këtu derisa të më thoni pse e bëtë këtë.
hapet posta	Do të rri këtu derisa të hapet posta.
mbarohet festa	Do të rri këtu derisa të mbarohet festa.

* Also <u>gjersa</u>.

DRILLS

UNIT 17

(14) SIMPLE SUBSTITUTION

oficer	Këtë oficer s'mund ta zëvendësojë ndonjë tjetër.
mësues	Këtë mësues s'mund ta zëvendësojë ndonjë tjetër.
sheqerxhi	Këtë sheqerxhi s'mund ta zëvendësojë ndonjë tjetër.
mësuese	Këte mësuese s'mund ta zëvendësojë ndonjë tjetër.
doktor	Këtë doktor s'mund ta zëvendësojë ndonjë tjetër.
punëtor	Këtë punëtor s'mund ta zëvendësojë ndonjë tjetër.
këpucar	Këtë këpucar s'mund ta zëvendësojë ndonjë tjetër.
avokat	Këtë avokat s'mund ta zëvendësojë ndonjë tjetër.

(15) SIMPLE SUBSTITUTION

vriten	Vriten me njeri tjetrin.
lozin	Lozin me njeri tjetrin.
hahen	Hahen me njeri tjetrin.
këcejnë	Këcejnë me njeri tjetrin.
flasin	Flasin me njeri tjetrin.
fjalosen	Fjalosen me njeri tjetrin.
llafosen	Llafosen me njeri tjetrin.
vriten	Vriten me njeri tjetrin.
duhen	Duhen me njeri tjetrin.

DRILLS

UNIT 17

(16) DOUBLE SUBSTITUTION

i forti të dobëtin	I forti e ka shtypur gjithnjë të dobëtin.
i madhi të voglin	I madhi e ka shtypur gjithnjë të voglin.
Sllavi Shqiptarin	Sllavi e ka shtypur gjithnjë Shqiptarin.
Greku Shqiptarin	Greku e ka shtypur gjithnjë Shqiptarin.
Italiani Shqiptarin	Italiani e ka shtypur gjithnjë Shqiptarin.
Turku Shqiptarin	Turku e ka shtypur gjithnjë Shqiptarin.
i huaji Shqiptarin	I huaji e ka shtypur gjithnjë Shqiptarin.
Jugosllavi Shqiptarin	Jugosllavi e ka shtypur gjithnjë Shqiptarin.

DRILLS

UNIT 17

(17) SIMPLE SUBSTITUTION

zakonet tona	Respektojmë brez pas brezi zakonet tona.
kodin tonë	Respektojmë brez pas brezi kodin tonë.
ligjët tona	Respektojmë brez pas brezi ligjët tona.
njeri tjetrin	Respektojmë brez pas brezi njeri tjetrin.
zakonet shqiptare	Respektojmë brez pas brezi zakonet shqiptare.
kodin e gjakut	Respektojmë brez pas brezi kodin e gjakut.
fjalën e dhënë	Respektojmë brez pas brezi fjalën e dhënë.
burrin	Respektojmë brez pas brezi burrin.

(18) SIMPLE SUBSTITUTION

e Aliut	S'më tha gjë doemos nga frika e Aliut.
e babait	S'më tha gjë doemos nga frika e babait.
e gjyshes	S'më tha gjë doemos nga frika e gjyshes.
e nënës	S'më tha gjë doemos nga frika e nënës.
e xhaxhait	S'më tha gjë doemos nga frika e xhaxhait.
e gjyshit	S'më tha gjë doemos nga frika e gjyshit.
e oficerit	S'më tha gjë doemos nga frika e oficerit.
e mësuesit	S'më tha gjë doemos nga frika e mësuesit.

DRILLS

UNIT 17

(19) SIMPLE SUBSTITUTION

turke	Dëgjova se ra qeveria turke.
greke	Dëgjova se ra qeveria greke.
jugosllave	Dëgjova se ra qeveria jugosllave.
frenge	Dëgjova se ra qeveria frenge.
gjermane	Dëgjova se ra qeveria gjermane.
angleze	Dëgjova se ra qeveria angleze.
italiane	Dëgjova se ra qeveria italiane.
shqiptare	Dëgjova se ra qeveria shqiptare.

(20) SIMPLE SUBSTITUTION

kur ishim	Kjo ndodhte kur ishim nën Turqinë.
kur ishin	Kjo ndodhte kur ishin nën Turqinë.
kur ishit	Kjo ndodhte kur ishit nën Turqinë.
kur Shqipëria ishte	Kjo ndodhte kur Shqipëria ishte nën Turqinë.
kur vendi ishte	Kjo ndodhte kur vendi ishte nën Turqinë.
kur vendi ynë ishte	Kjo ndodhte kur vendi ynë ishte nën Turqinë.
kur Shqiptarët ishin	Kjo ndodhte kur Shqiptarët ishin nën Turqinë.
kur Shqipëria ishte	Kjo ndodhte kur Shqipëria ishte nën Turqinë.

DRILLS

UNIT 17

(21) SIMPLE SUBSTITUTION

kohët	Në kohët e fundit. s'është aq shumë.
vjetët	Në vjetët e fundit s'është aq shumë.
muajt	Në muajt e fundit s'është aq shumë.
javët	Në javët e fundit s'është aq shumë.
ditët	Në ditët e fundit s'është aq shumë.
kohët	Në kohët e fundit s'është aq shumë.
kohën	Në kohën e fundit s'është aq shumë.
vjetët	Në vjetët e fundit s'është aq shumë.

(22) SIMPLE SUBSTITUTION

e shtetasvet	Shteti mbron të drejtat e shtetasvet.
e shtetasit	Shteti mbron të drejtat e shtetasit.
e popullit	Shteti mbron të drejtat e popullit.
e njerëzvet	Shteti mbron të drejtat e njerëzvet.
e punëtorëvet	Shteti mbron të drejtat e punëtorëvet.
e nxënësvet	Shteti mbron të drejtat e nxënësvet.
e gravet	Shteti mbron të drejtat e gravet.
e punëtorit	Shteti mbron të drejtat e punëtorit.

DRILLS

UNIT 17

(23) SIMPLE CORRELATION

ai	Ai e ka fajin.
ju	Ju e kini fajin.
ne	Ne e kemi fajin.
unë	Unë e kam fajin.
ti	Ti e ke fajin.
ajo	Ajo e ka fajin.
ju	Ju e kini fajin.
ata	Ata e kanë fajin.

(24) SIMPLE CORRELATION (with free forms of pronouns as cues)

mua	Mund të më përgjigjesh për një pyetje tjetër?
atyre	Mund t'u përgjigjesh për një pyetje tjetër?
atij	Mund t'i përgjigjesh për një pyetje tjetër?
atyre	Mund t'u përgjigjesh për një pyetje tjetër?
asaj	Mund t'i përgjigjesh për një pyetje tjetër?
ne	Mund të na përgjigjesh për një pyetje tjetër?
atyre	Mund t'u përgjigjesh për një pyetje tjetër?
atij	Mund t'i përgjigjesh për një pyetje tjetër?

DRILLS

UNIT 17

(25) SIMPLE CORRELATION

do të punoj	Do të punoj sa më mundet.
do të punojmë	Do të punojmë sa na mundet.
do të punojë	Do të punojë sa i mundet.
do të punojnë	Do të punojnë sa u mundet.
punojmë	Punojmë sa na mundet.
ai punon	Ai punon sa i mundet.
punoj	Punoj sa më mundet.
punoni	Punoni sa ju mundet.
ti punon	Ti punon sa të mundet.

(26) SIMPLE CORRELATION (with free forms of pronouns as cues)

ata	Do t'i ndihmojmë me gjithë zemër.
ty	Do të të ndihmojmë me gjithë zemër.
ju	Do t'ju ndihmojmë me gjithë zemër.
atë	Do ta ndihmojmë me gjithë zemër.
ty	Do të të ndihmojmë me gjithë zemër.
ata	Do t'i ndihmojmë me gjithë zemër.
atë	Do ta ndihmojmë me gjithë zemër.
ju	Do t'ju ndihmojmë me gjithë zemër.

DRILLS

UNIT 17

(27) SIMPLE SUBSTITUTION

ky zakon	Ky zakon është një trashëgim i lënë nga të parët tonë.
ky kod	Ky kod është një trashëgim i lënë nga të parët tonë.
hakmarrja	Hakmarrja është një trashëgim i lënë nga të parët tonë.
gjaku	Gjaku është një trashëgim i lënë nga të parët tonë.
besa	Besa është një trashëgim i lënë nga të parët tonë.
kjo ligjë	Kjo ligjë është një trashëgim i lënë nga të parët tonë.
gjaku	Gjaku është një trashëgim i lënë nga të parët tonë.
ky ligj	Ky ligj është një trashëgim i lënë nga të parët tonë.

DRILLS

UNIT 17

(28) SIMPLE SUBSTITUTION

ata nderojnë hasmin	Ata nderojnë hasmin po të paraqitet nevoja.
ata ndërrojnë anë	Ata ndërrojnë anë po të paraqitet nevoja.
ata vrasin edhe vëllanë e tyre	Ata vrasin edhe vëllanë e tyre po të paraqitet nevoja.
ata shesin edhe nënën e tyre	Ata shesin edhe nënën e tyre po të paraqitet nevoja.
ata shesin edhe nderin e tyre	Ata shesin edhe nderin e tyre po të paraqitet nevoja.
ata ndihmojnë edhe armikun	Ata ndihmojnë edhe armikun po të paraqitet nevoja.
ata shesin edhe motrën	Ata shesin edhe motrën po të paraqitet nevoja.
ata ndihmojnë edhe hasmin	Ata ndihmojnë edhe hasmin po të paraqitet nevoja.

DRILLS

UNIT 17

(29) MULTIPLE CORRELATION

çdo njeri	Çdo njeri duhet ta mbajë fjalën që ka dhënë.
ti	Ti duhet ta mbash fjalën që ke dhënë.
unë	Unë duhet ta mbaj fjalën që kam dhënë.
ne	Ne duhet ta mbajmë fjalën që kemi dhënë.
ju	Ju duket ta mbani fjalën që kini dhënë.
burri i vërtetë	Burri i vërtetë duhet ta mbajë fjalën që ka dhënë.
burrat e vërtetë	Burrat e vërtetë duhet ta mbajnë fjalën që kanë dhënë.
ti	Ti duhet ta mbash fjalën që ke dhënë.

(30) SIMPLE CORRELATION (omit cue from response)

ai	S'na jep kurrë shembëlla.
ti	S'na jep kurrë shembëlla.
ata	S'na japin kurrë shembëlla.
ju	S'na jepni kurrë shembëlla.
ajo	S'na jep kurrë shembëlla.
ato	S'na japin kurrë shembëlla.
ti	S'na jep kurrë shembëlla.
ju	S'na jepni kurrë shembëlla.

DRILLS

UNIT 17

(31) **MULTIPLE CORRELATION**

vëllezër	Kam dy vëllezër: njeri* është mësues dhe tjetri punon në bankë.
motra	Kam dy motra: njera** është mësuese dhe tjetra punon në bankë.
kushërinj	Kam dy kushërinj: njeri është mësues dhe tjetri punon në bankë.
nipër	Kam dy nipër: njeri është mësues dhe tjetri punon në bankë.
mbesa	Kam dy mbesa: njera është mësuese dhe tjetra punon në bankë.
vajza	Kam dy vajza: njera është mësuese dhe tjetra punon në bankë.
miq	Kam dy miq: njeri është mësues dhe tjetri punon në bankë.
kushërira	Kam dy kushërira: njera është mësuese dhe tjetra punon në bankë.

* Also njëri.
** Also njëra.

DRILLS

UNIT 17

ANALYSIS 4: ADJECTIVES USED AS NOUNS

(32) RESPONSE

Pashë kushërirën tënde.	Cilën, të madhen apo të voglën?
Pashë motrën tënde.	Cilën, të madhen apo të voglën?
Pashë vëllanë tënd.	Cilin, të madhin apo të voglin?
Pashë kushëririn tënd.	Cilin, të madhin apo të voglin?
Pashë birin tënd.	Cilin, të madhin apo të voglin?
Pashë vajzën tënde.	Cilën, të madhen apo të voglën?
Pashë nipin tënd.	Cilin, të madhin apo të voglin?
Pashë mbesën tënde.	Cilën, të madhen apo të voglën?

(33) RESPONSE

Ky djalë është i birit tim.	Cilit, të voglit apo të madhit?
Ky djalë është i bijës sime.	Cilës, së voglës apo së madhes?
Ky djalë është i kushërirës sime.	Cilës, së voglës apo së madhes?
Ky djalë është i nipit tim.	Cilit, të voglit apo të madhit?
Ky djalë është i vëllait tim.	Cilit, të voglit apo të madhit?
Ky djalë është i kushëririt tim.	Cilit, të voglit apo të madhit?
Ky djalë është i mbesës sime.	Cilës, së voglës apo së madhes?
Ky djalë është i motrës sime.	Cilës, së voglës apo së madhes?

DRILLS

UNIT 17

ANALYSIS 5: HOW TO SAY <u>ONE</u> <u>ANOTHER</u> IN ALBANIAN

(34) VARIATION

Duhuni.	Doni njeri tjetrin.
Ndihmohuni.	Ndihmoni njeri tjetrin.
Nderohuni.	Nderoni njeri tjetrin.
Shikohuni.	Shikoni njeri tjetrin.
Takohuni.	Takoni njeri tjetrin.
Piquni.	Piqni njeri tjetrin.
Lahuni.	Lani njeri tjetrin.
Ndihmohuni.	Ndihmoni njeri tjetrin.

(35) SIMPLE SUBSTITUTION

gratë	Respektoni gratë e njeri tjetrit.
nderin	Respektoni nderin e njeri tjetrit.
vajzat	Respektoni vajzat e njeri tjetrit.
shtëpinë	Respektoni shtëpinë e njeri tjetrit.
të drejtat	Respektoni të drejtat e njeri tjetrit.
motrat	Respektoni motrat e njeri tjetrit.
vajzat	Respektoni vajzat e njeri tjetrit.
të drejtat	Respektoni të drejtat e njeri tjetrit.

DRILLS

UNIT 17

ANALYSIS 6: THE MARGINAL PLURAL SUFFIX -ve

(36) SIMPLE SUBSTITUTION

shtëpive	Këto karriga janë prej dy shtëpive të tjera.
kishave	Këto karriga janë prej dy kishave të tjera.
restoran-teve	Këto karriga janë prej dy restoranteve të tjera.
hoteleve	Këto karriga janë prej dy hoteleve të tjera.
dhomave	Këto karriga janë prej dy dhomave të tjera.
shkollave	Këto karriga janë prej dy shkollave të tjera.
xhamive	Këto karriga janë prej dy xhamive të tjera.
dyqaneve	Këto karriga janë prej dy dyqaneve të tjera.

(37) SIMPLE SUBSTITUTION

të parëvet	T'i mbajmë mend fjalët e të parëvet.
të mëdhenjvet	T'i mbajmë mend fjalët e të mëdhenjvet.
etërvet tonë	T'i mbajmë mend fjalët e etërvet tonë.
të parëvet	T'i mbajmë mend fjalët e të parëvet.
nënavet tona	T'i mbajmë mend fjalët e nënavet tona.
gjyshavet tonë	T'i mbajmë mend fjalët e gjyshavet tonë.
gjyshevet tona	T'i mbajmë mend fjalët e gjyshevet tona.
baballarëvet tonë	T'i mbajmë mend fjalët e baballarëvet to-në.

DRILLS

UNIT 17

(38) STRUCTURE REPLACEMENT

Shteti mbron të drejtat e punëtorit.	Shteti mbron të drejtat e punëtorëvet.
Shteti mbron të drejtat e nxënësit.	Shteti mbron të drejtat e nxënësvet.
Shteti mbron të drejtat e mësuesit.	Shteti mbron të drejtat e mësuesvet.
Shteti mbron të drejtat e shtetasit.	Shteti mbron të drejtat e shtetasvet.
Shteti mbron të drejtat e gruas.	Shteti mbron të drejtat e gravet.
Shteti mbron të drejtat e fëmijës.	Shteti mbron të drejtat e fëmijëvet.
Shteti mbron të drejtat e tregëtarit.	Shteti mbron të drejtat e tregëtarëvet.
Shteti mbron të drejtat e njeriut.	Shteti mbron të drejtat e njerëzvet.

DRILLS

UNIT 17

(39) STRUCTURE REPLACEMENT

Ky është shtrati i djalit.	Këta janë shtretërit e djemvet.
Ky është shtrati i vajzës.	Këta janë shtretërit e vajzavet.
Ky është shtrati i nxënësit.	Këta janë shtretërit e nxënësvet.
Ky është shtrati i ushtarit.	Këta janë shtretërit e ushtarëvet.
Ky është shtrati i punërit.	Këta janë shtretërit e punëtorëvet.
Ky është shtrati i çupës.	Këta janë shtretërit e çupavet.
Ky është shtrati i mësuesës.	Këta janë shtretërit e mësuesevet.
Ky është shtrati i gruas.	Këta janë shtretërit e gravet.
Ky është shtrati i burrit.	Këta janë shtretërit e burravet.

DRILLS

UNIT 17

(40) STRUCTURE REPLACEMENT

Kjo dhomë është e bijës sime.	Kjo dhomë është e bijavet të mia.
Kjo dhomë është e birit tim.	Kjo dhomë është e bijvet të mi.
Kjo dhomë është e vëllait tim.	Kjo dhomë është e vëllezërvet të mi.
Kjo dhomë është e mikut tim.	Kjo dhomë është e miqvet të mi.
Kjo dhomë është e motrës sime.	Kjo dhomë është e motravet të mia.
Kjo dhomë është e mbesës sime.	Kjo dhomë është e mbesavet të mia.
Kjo dhomë është e hallës sime.	Kjo dhomë është e hallavet të mia.
Kjo dhomë është e xhaxhait tim.	Kjo dhomë është e xhaxhallarëvet të mi.

DRILLS

UNIT 17

GRAMMAR REVIEW: THE PERFECT ASPECT

(41) RESPONSE

Me kë vajte?	Vajta me nënën.
Me kë erdhe?	Erdha me nënën.
Me kë ndenje?	Ndenja me nënën.
Me kë u nise?	U nisa me nënën.
Me kë u takove?	U takova me nënën.
Me kë i pe?	I pashë me nënën.
Me kë qe gjer tani?	Qeshë me nënën.
Me kë u ktheve?	U ktheva me nënën.

(42) RESPONSE

Nga u nisët?	U nisëm nga Korça.
Ku u mblodhët?	U mblodhëm në Korçë.
Ku vajtët?	Vajtëm në Korçë.
Nga erdhët?	Erdhëm nga Korça.
Ku u takuat?	U takuam në Korçë.
Ku i patë?	I pamë në Korçë.
Nga u kthyet?	U kthyem nga Korça.
Ku u patë?	U pamë në Korçë.
Ku i bletë rrobat?	I blemë në Korçë.

DRILLS

UNIT 17

(43) RESPONSE

Kush u kthye dje?	U kthyen vëllezërit e mi.
Kush u martua dje?	U martuan vëllezërit e mi.
Kush u nis dje?	U nisën vëllezërit e mi.
Kush erdhi dje?	Erdhën vëllezërit e mi.
Kush më kërkoi dje?	Të kërkuan vëllezërit e mi.
Kush u largua dje?	U larguan vëllezërit e mi.
Kush mbajti fjalim dje?	Mbajtën fjalim vëllezërit e mi.
Kush u rrua dje?	U rruan vëllezërit e mi.
Kush vajti dje?	Vajtën vëllezërit e mi.

(44) RESPONSE

Nesër do të fillosh?	Jo, fillova sot.
Nesër do ta mbaroni?	Jo, e mbaruam sot.
Nesër do ta shihni?	Jo, e pamë sot.
Nesër do t'i shkruajnë?	Jo, i shkruan sot.
Nesër do t'i japë para?	Jo, i dha sot.
Nesër do ta mblidhni?	Jo, e mblodhëm sot.
Nesër do ta qethësh djalin?	Jo, e qetha sot.
Nesër do ta qepë xhaketën?	Jo, e qepi sot.

DRILLS

UNIT 17

(45) RESPONSE

Kur mbyllet shkolla këtu?	U mbyll pardje.
Kur nisen djemtë?	U nisën pardje.
Kur do të qethesh?	U qetha pardje.
Kur martoheni?	U martuam pardje.
Kur hapen shkollat këtu?	U hapën pardje.
Kur do të takohesh me Lirinë?	U takuam pardje.
Kur largohet Ismaili?	U largua pardje.
Kur kthehet Sulua?	U kthye pardje.
Kur mblidhet populli?	U mblodh pardje.

(46) DIRECTED DIALOGUE

Pyeteni X-in a e ka parë gruan tuaj.

Thuajini Z-it se e patë pasdreke.

Pyeteni X-in a ishte vetë ajo kur e pa.

Thuajini Z-it se ashtu ju duket.

Pyeteni X-in a është i sigurt. Thuajini se, po të jetë mik i vërtetë, t'ju thotë të vërtetën.

Thuajini Z-it se, meqë jini miq të vjetër, duhet t'ju thotë të vërtetën. E patë me një burrë.

Pyeteni X-in ku ishin.

Thuajini Z-it se i patë pranë lumit, prapa fabrikavet.

Thuajini X-it se po ta gjeni do ta vrisni.

DRILLS

UNIT 17

(47) DIRECTED DIALOGUE

Pyeteni X-ën ku qe gjer tani.

Thuajini Z-it se ishit tek Drita. Thoni se e bija është pak e sëmurë.

Thuajini X-ës se nuk e besoni.

Pyeteni Z-in atëherë t'ju thotë ai ku ishit.

Thuajini X-ës se e panë nga lumi me një burrë. Pyeteni t'ju thotë ku ishte, pse ndryshe e vrisni aty për aty.

Thuajini Z-it të mos zemërohet, pse s'kini të dashur. Ai ishte Luani, i biri i Fatimesë.

Pyeteni X-ën mirëpo ç'bënte Luani me të.

Thuajini Z-it se ai e do shumë Lirinë, vajzën e Dritës.

Pyeteni X-ën a e do edhe ajo Luanin.

Thuajini X-it se ata lozin mendsh për njeri tjetrin. Por i ati i vajzës nuk e do Luanin.

Thuajini X-ës se e dini. I ati do ta martojë me doktor Bimblin. Thoni se edhe doktori është burrë i mirë.

Thuajini Z-it se mund të jetë i mirë, por ç'e do që vajza do tjetrin.

Thuajini X-ës se s'ju ka thënë akoma ç'punë kishte ajo me Luanin.

Thuajini Z-it se ai donte t'ju jepte një letër për Lirinë.

Thuajini X-ës të mos harrojë se i ati i vajzës është kushëriri juaj.

DRILLS

UNIT 17

(48) DIRECTED DIALOGUE

Pyeteni X-in pse s'flasin Franku me Llukën.

Thuajini Z-it sepse familjet e tyre janë në hasmëri.

Pyeteni X-in domethënë vriten me njeri tjetrin.

Thuajini Z-it se ashtu bëhej më përpara, kurse tani jo më, nga frika e qeverisë.

Pyeteni X-in atëherë pse janë hasmë.

Thuajini Z-it se janë hasmë sepse i ka armiqësuar gjaku.

Thuajini X-it se nuk i kuptoni zakonet e tyre.

Thuajini Z-it se nuk i kupton pse është nga jugu, ku s'ka hakmarrje.

DRILLS

UNIT 17

(49) DIRECTED DIALOGUE

Thuajini X-ës se këtë vit biri juaj Skënderi do të mbarojë shkollën e mesme.

Pyeteni Z-ën ç'do të bëjë pastaj.

Thuajini X-ës se do të shkojë në Tiranë të bëhet doktor.

Thuajini Z-ës se me të vërtetë vendi ka nevojë akoma për shumë doktorë.

Pyeteni X-ën ç'bën i biri.

Thuajini Z-ës se është akoma në shkollën fillore, por s' lexon dot. Thuajini se ju ka thirrur mësuesja dhe ju tha se duhet të bëni diçka.

Pyeteni X-ën mos është i sëmurë djali.

Thuajini Z-ës se jo, është vetëm pak përtac.

Thuajini X-ës se nuk mund ta besoni këtë. As i ati as e ëma s'janë përtacë.

Thuajini Z-ës se, të thoni të drejtën, duket se atë e ka trashëguar nga babai, i cili është mjaft dembel.

Thuajini X-ës se çuditeni pak me sa dëgjoni. Thuajini se i shoqi i X-ës duket aq punëtor.

Thuajini Z-ës se mund të duket ç'të dojë, por nuk i pëlqen fare puna.

Pyeteni X-ën a e ndihmojnë djalin në shtëpi.

Thuajini Z-ës se ju e ndihmoni sa ju mundet, por i ati ato gjëra nuk i konsideron me rëndësi.

Thuajini X-ës se do t'i thoni burrit tuaj t'i flasë të shoqit. Ata janë miq të mirë dhe respektojnë njeri tjetrin.

(continued)

DRILLS

UNIT 17

(49) (continued)

Thuajini Z-ës se e falënderoni, por mos t'i thotë i shoqi se e thatë ju, pse ndryshe do t'ju vrasë burri juaj.

Thuajini X-ës të mos bëhet merak, kujdeseni ju.

END OF DRILLS FOR UNIT 17

DRILLS

UNIT 19

(1) SIMPLE CORRELATION

ti?	Ti u zgjove?
ajo	Ajo u zgjua.
ne	Ne u zgjuam.
unë	Unë u zgjova.
ju?	Ju u zgjuat?
ai	Ai u zgjua.
ata	Ata u zgjuan.
unë	Unë u zgjova.

(2) SIMPLE CORRELATION (omit cue from response)

unë	Sapo hapa sytë.
ata	Sapo hapën sytë.
ai	Sapo hapi sytë.
ti	Sapo hape sytë.
ne	Sapo hapëm sytë.
ju	Sapo hapët sytë.
ato	Sapo hapën sytë.
ajo	Sapo hapi sytë.

DRILLS

UNIT 19

(3) SIMPLE CORRELATION (with nominative cues)

fshati	A të pëlqen havaja e fshatit?
Tirana	A të pëlqen havaja e Tiranës?
qyteti ynë	A të pëlqen havaja e qytetit tonë?
Shqipëria	A të pëlqen havaja e Shqipërisë?
fshati ynë	A të pëlqen havaja e fshatit tonë?
male tona	A të pëlqen havaja e malevet tona?
mali	A të pëlqen havaja e malit?
Durrësi	A të pëlqen havaja e Durrësit?

(4) SIMPLE CORRELATION (omit cue from response)

unë	Jam shumë i kënaqur nga klima që kini.
ajo	Është shumë e kënaqur nga klima që kini.
ato	Janë shumë të kënaqura nga klima që kini.
ata	Janë shumë të kënaqur nga klima që kini.
ai	Është shumë i kënaqur nga klima që kini.
ne	Jemi shumë të kënaqur nga klima që kini.
ato	Janë shumë të kënaqura nga klima që kini.
unë	Jam shumë i kënaqur nga klima që kini.

DRILLS

UNIT 19

(5) MULTIPLE CORRELATION (omit cues from response)

ne tani	Me të vërtetë kemi qetësi e pastërti të madhe.
ne përpara	Me të vërtetë kishim qetësi e pastërti të madhe.
ata përpara	Me të vërtetë kishin qetësi e pastërti të madhe.
ju tani	Me të vërtetë kini qetësi e pastërti të madhe.
ata tani	Me të vërtetë kini qetësi e pastërti të madhe.
ne përpara	Me të vërtetë kishim qetësi e pastërti të madhe.
ju përpara	Me të vërtetë kishit qetësi e pastërti të madhe.
ata përpara	Me të vërtetë kishin qetësi e pastërti të madhe.

DRILLS

UNIT 19

(6) SIMPLE CORRELATION (with nominative cues)

qyteti	Klima është e ndryshme nga ajo e qytetit.
mali	Klima është e ndryshme nga ajo e malit.
male	Klima është e ndryshme nga ajo e malevet.
deti	Klima është e ndryshme nga ajo e detit.
fshati	Klima është e ndryshme nga ajo e fshatit.
fusha	Klima është e ndryshme nga ajo e fushës.
Amerika	Klima është e ndryshme nga ajo e Amerikës.
Elbasani	Klima është e ndryshme nga ajo e Elbasanit.

(7) SIMPLE CORRELATION (omit cue from response)

ne	T'i lëmë fjalët mënjanë.
ju	T'i lini fjalët mënjanë.
ata	T'i lënë fjalët mënjanë.
ai	T'i lerë fjalët mënjanë.
ti	T'i lësh fjalët mënjanë.
ju	T'i lini fjalët mënjanë.
ne	T'i lëmë fjalët mënjanë.
ti	T'i lësh fjalët mënjanë.

DRILLS

UNIT 19

Ishim në xhami.	Edhe ne ishim pardje.

(39) RESPONSE

Pse vajte në Tiranë?	Qeshë për festën kombëtare.
Pse vajti në Tiranë?	Qe për festën kombëtare.
Pse vajtët në Tiranë?	Qemë për festën kombëtare.
Pse vajtën në Tiranë?	Qenë për festën kombëtare.
Pse vajte në Tiranë?	Qeshë për festën kombëtare.
Pse vajtën në Tiranë?	Qenë për festën kombëtare.
Pse vajti në Tiranë?	Qe për festën kombëtare.
Pse vajtët në Tiranë?	Qemë për festën kombëtare.

DRILLS

UNIT 20

(40) RESPONSE

Ti pse vete në Pukë?	Vete për pyjet e bukura që ka.
Ju pse veni në Pukë?	Vemi për pyjet e bukura që ka.
Ata pse venë në Pukë?	Venë për pyjet e bukura që ka.
Ajo pse vete në Pukë?	Vete për pyjet e bukura që ka.
Ato pse venë në Pukë?	Venë për pyjet e bukura që ka.
Ti pse vete në Pukë?	Vete për pyjet e bukura që ka.
Ai pse vete në Pukë?	Vete për pyjet e bukura që ka.
Ju pse veni në Pukë?	Vemi për pyjet e bukura që ka.

DRILLS

UNIT 20

ANALYSIS 6: HOW TO SAY "HOW NICE!", ETC. IN ALBANIAN

(41) VARIATION

Uji është i kulluar.	Ç'i kulluar është uji!
Uji është i ndyrë.	Ç'i ndyrë është uji!
Qielli është i pastër.	Ç'i pastër është qielli!
Fusha është jeshile.	Ç'jeshile është fusha!
Këto male janë të larta.	Ç'të larta janë këto male!
Shqipëria është e bukur.	Ç'e bukur është Shqipëria!
Amerika është e madhe.	Ç'e madhe është Amerika!
Kjo Angleze është e bukur.	Ç'e bukur është kjo Angleze!
Gjuha ruse është e rëndë.	Ç'e rëndë është gjuha ruse!

(42) VARIATION

Ç'natë e freskët!	Sa natë e freskët!
Ç'ujë i ftohët!	Sa ujë i ftohët!
Ç'ditë e bukur!	Sa ditë e bukur!
Ç'vajza të bukura!	Sa vajza të bukura!
Ç'rrugë e gjatë!	Sa rrugë e gjatë!
Ç'qiell i pastër!	Sa qiell i pastër!
Ç'peshq të freskët!	Sa peshq të freskët!
Ç'fryte të freskëta!	Sa fryte të freskëta!

DRILLS

UNIT 20

(43) VARIATION

Ç'i kulluar është uji!	Ç'ujë i kulluar!
Ç'e bukur është kjo vajzë!	Ç'vajzë e bukur!
Ç'e lartë është kjo shtëpi!	Ç'shtëpi e lartë!
Ç'i shtrenjtë është ky hotel!	Ç'hotel i shtrenjtë!
Ç'të lirë janë peshqit!	Ç'peshq të lirë!
Ç'të bukura janë ato vende!	Ç'vende të bukura!
Ç'dembele është kjo grua!	Ç'grua dembele!
Ç'e lehtë është kjo çadër!	Ç'çadër e lehtë!
Ç'e keqe është koha sot!	Ç'kohë e keqe!

DRILLS

UNIT 20

ANALYSIS 7: <u>duke</u> + PARTICIPLE, BUT WITHOUT <u>jam</u>

(44) SIMPLE CORRELATION (omit cue from response)

ju	S'duh[illegible]ë flitni duke ngrënë.
unë	S'duhet të flas duke ngrënë.
ajo	S'duhet të flasë duke ngrënë.
ti	S'duhet të flasësh duke ngrënë.
ne	S'duhet të flasim duke ngrënë.
ata	S'duhet të flasin duke ngrënë.
ai	S'duhet të flasë duke ngrënë.
ti dhe ajo	S'duhet të flitni duke ngrënë.

(45) SIMPLE CORRELATION (with 1st person singular present cues)

rri	Mund ta dëgjoj edhe duke ndenjur.
punoj	Mund ta dëgjoj edhe duke punuar.
eci	Mund ta dëgjoj edhe duke ecur.
ha	Mund ta dëgjoj edhe duke ngrënë.
shkruaj	Mund ta dëgjoj edhe duke shkruar.
lexoj	Mund ta dëgjoj edhe duke lexuar.
ngarkoj kalin	Mund ta dëgjoj edhe duke ngarkuar kalin.
pregatit bukën	Mund ta dëgjoj edhe duke pregatitur bukën.

DRILLS

UNIT 20

(46) COMBINATION

Erdha. Ai po hante.	Erdha kur ai po hante.
Ika. Ajo nuk shikonte.	Ika kur ajo nuk shikonte.
E vodhën. Unë isha në kullotë.	E vodhën kur unë isha në kullotë.
E shoh. I ati është në punë.	E shoh kur i ati është në punë.
Zemërohet. Flasim anglisht.	Zemërohet kur flasim anglisht.
U martuan. Ne ishim akoma n'Amerikë.	U martuan kur ne ishim akoma n'Amerikë.
Ai e mbaroi shkollën. Unë isha akoma foshnje.	Ai e mbaroi shkollën kur unë isha akoma foshnje.
Ju lozni. Unë punoj.	Ju lozni kur unë punoj.
Ajo punon. Ne lozim.	Ajo punon kur ne lozim.

DRILLS

UNIT 20

(47) COMBINATION

Unë e dua.
Ajo s'më do.

Unë e dua, kurse ajo s'më do.

Unë e njoh.
Ai s'më njeh.

Unë e njoh, kurse ai s'më njeh.

Ne i ndihmojmë
Ata s'na ndihmojnë kurrë.

Ne i ndihmojmë, kurse ata s'na ndihmojnë kurrë.

Ti flet mirë shqip.
Unë s'flas dot.

Ti flet mirë shqip, kurse unë s'flas dot.

Ju kini para.
Unë s'kam asnjë lek.

Ju kini para, kurse unë s'kam asnjë lek.

Ajo është e martuar.
Ti s'je.

Ajo është e martuar, kurse ti s'je.

Unë jam Amerikan.
Ajo është Shqiptare.

Unë jam Amerikan, kurse ajo është Shqiptare.

Ti je Toskë.
Ai është Gegë.

Ti je Toskë, kurse ai është Gegë.

DRILLS

UNIT 20

ANALYSIS 8: INTRODUCING FINAL CLAUSES WITH (<u>që</u>) <u>të</u>

(48) VARIATION

Do të shkoj të takoj një mik.	Do të shkoj për të takuar një mik.
Do të shkojmë në Shqipëri që të mësojmë shqip.	Do të shkojmë në Shqipëri për të mësuar shqip.
Jemi këtu që të mësojmë anglisht.	Jemi këtu për të mësuar anglisht.
E bëj këtë që të ndihmoj një mik.	E bëj këtë për të ndihmuar një mik.
Shkojnë të takojnë gjyshin.	Shkojnë për të takuar gjyshin.
Jam këtu që të flas me babanë tënd.	Jam këtu për të folur me babanë tënd.
Do të vijnë të flasin me nënën.	Do të vijnë për të folur me nënën.
Iki tani që të pregatit drekën.	Iki tani për të pregatitur drekën.

DRILLS

UNIT 20

ANALYSIS 9: ATTENUATED COMMANDS

(49) VARIATION

Thua se jam i sëmurë.	Të thuash se jam i sëmurë.
Shko shpejt.	Të shkosh shpejt.
Dëgjoni ç'thotë gjyshi.	Të dëgjoni ç'thotë gjyshi.
Mirrni dhe disa portokaj.	Të mirrni dhe disa portokaj.
Hajde dhe ti me ne.	Të vish dhe ti me ne.
Hap derën.	Të hapësh derën.
Hajdeni me mua.	Të vini me mua.
Ngarkojeni karrocën.	Ta ngarkoni karrocën.

(50) VARIATION

Mos më trazo.	Të mos më trazosh.
Mos këndo tani.	Të mos këndosh.
Mos i thuaj asgjë.	Të mos i thuash asgjë.
Mos më jep para.	Të mos më japësh para.
Mos e trazoni.	Të mos e trazoni.
Mos i thoni se jam këtu.	Të mos i thoni se jam këtu.
Mos i mirrni sonte.	Të mos i mirrni sonte.
Mos kini merak.	Të mos kini merak.

DRILLS

UNIT 20

(51) VARIATION

Mos ki merak.	Të mos kesh merak.
Mos kini merak.	Të mos kini merak.
Ki durim.	Të kesh durim.
Ki mendjen.	Të kesh mendjen.
Kini durim.	Të kini durim.
Kini mendjen.	Të kini mendjen.
Mbyll derën.	Të mbyllësh derën.
Hapni dritaret.	Të hapni dritaret.

(52) VARIATION

Kujtomë të blej disa ullinj.	Të më kujtosh të blej disa ullinj.
Mos e trazo.	Të mos e trazosh.*
Jepna çelësin.	Të na japësh çelësin.
Mos e mirrni.	Të mos e mirrni.*
Mos i trazoni.	Të mos i trazoni.*
Merre tani.	Ta marrësh tani.
Këndo edhe ti.	Të këndosh edhe ti.
Harroje këtë vajzë.	Ta harrosh këtë vajzë.

* Also mos ta trazosh, mos ta mirrni, mos t'i trazoni. The command is stronger when mos comes before të.

DRILLS

UNIT 20

(53) RESPONSE

Qëndroni këtu.	Mirë thotë: të qëndrojmë këtu.
Mos bëni fjalë më.	Mirë thotë: të mos bëjmë fjalë më.
Këndoni edhe ju.	Mirë thotë: të këndojmë edhe ne.
Pastrojini rrobat.	Mirë thotë: t'i pastrojmë rrobat.
Lexojeni edhe ju.	Mirë thotë: ta lexojmë edhe ne.
Mos kini merak.	Mirë thotë: të mos kemi merak.
Mos flitni anglisht.	Mirë thotë: të mos flasim anglisht.
Mos i mirrni sot.	Mirë thotë: të mos i marrim sot.

(54) DIRECTED DIALOGUE

Pyeteni X-in ç'do për të pirë.

Pyeteni Z-in a ka limonadë të ftohët.

Thuajini X-it se kini limonadë, por s'është dhe aq e ftohët.

Thuajini Z-it se s'prish punë. Do ta pini dhe të ngrohët.

Pyeteni X-in a i hahet.

Thuajini Z-it se kini pak uri, pse u zgjuat vonë sot dhe s'hëngrët mëngjes.

Pyeteni X-in a do të hajë mish.

Thuajini Z-it po si jo, vetëm të premten s'mund të hani mish.

DRILLS

UNIT 20

(55) DIRECTED DIALOGUE

Thuajini X-it se dëgjuat që do të dalë për gjah.

Thuajini Z-it se do të niseni brenda gjysmë ore.

Pyeteni X-in a do që ta ndihmoni me gjëkafshë.

Thuajini Z-it se, po të ketë kohë, mund t'ju ndihmojë të ngarkoni kuajt.

Thuajini X-it me gjithë qejf dhe pyeteni pse ka nevojë për dy kuaj.

Thuajini Z-it se do të mirrni edhe mikun tuaj Amerikan.

Pyeteni X-in po ku është miku i tij.

Thuajini Z-it se s'është gati akoma.

Thuajini X-it se e patë që lahej në oborr.

DRILLS

UNIT 20

(56) DIRECTED DIALOGUE

Pyeteni X-in pse do të shkojë në Shqipëri.

Thuajini Z-it që të mësoni shqip.

Thuajini X-it se shqipen mund ta mësojë edhe këtu n'Amerikë.

Thuajini Z-it se Shqiptarët e Amerikës dinë të gjithë anglisht dhe s'flasin shqip me ju.

Thuajini X-it se në Shqipëri nuk ka shumë njerëz që flasin anglisht.

Thuajini Z-it se për këtë arësye doni të shkoni atje. Pyeteni a ka Shqiptarë që dinë gjuhë të huaja.

Thuajini X-it se ka shumë Shqiptarë që dinë pak italisht dhe disa që dinë frengjisht.

(57) DIRECTED DIALOGUE

Thuajini X-it se ka dit që s'e kini parë Sotirin.

Pyeteni Z-in s'dëgjoi ai ç'ngjau.

Thuajini X-it se s'kini dëgjuar gjë. Pyeteni ç'ngjau.

Thuajini Z-it se Sotiri iku në Greqi.

Pyeteni X-in si mund të ikte. Thoni se kufiri është i mbyllur dhe ruhet mirë.

Thuajini Z-it se duket se iku natën, që të mos e shohin ushtarët.

Pyeteni X-in a mori edhe familjen me vehte.

Thuajini Z-it se të gjithë pjesëtarët e familjes së tij janë zhdukur dhe duket se i mori që të gjithë bashkë.

SPOKEN ALBANIAN

DRILLS

UNIT 20

(58) DIRECTED DIALOGUE

Thuajini X-it se s'mund të punoni më kështu dhe do të blini një kalë.

Pyeteni Z-in me ç'para do ta blejë.

Thuajini X-it se do të mirrni hua nga banka.

Thuajini Z-it se juve s'ju pëlqejnë këto gjëra. Në kohën tuaj ishte ndryshe.

Thuajini X-it se e dini që në kohën e tij ishte ndryshe, por tani janë kohë të tjera.

Thuajini Z-it "kohë të tjera" nuk do të thotë kohë të mira, por mund të bëjë si të dojë.

Thuajini X-it se ju duhet kali domosdo. Pyeteni a mund t'ju japë ai ca të holla borxh.

Thuajini Z-it se nga ju nuk do të marrë as një lek. Mund të kërkojë para në bankë, po të dojë.

Pyeteni X-in çfarë miku është ai, që s'i ndihmon miqtë.

Thuajini Z-it se i ndihmoni vetëm miqtë që kanë nevojë, jo të tjerët.

Thuajini X-it se ju duket kali pa tjetër dhe s'mund të punoni pa të.

Thuajini Z-it se mund të thuajë ç'të dojë, por ju s'i besoni.

END OF DRILLS FOR UNIT 20

DRILLS

UNIT 21

(1) SIMPLE CORRELATION

pallton	Vere pallton pse u ngrys.
pantallonat	Veri pantallonat pse u ngrys.
xhaketën	Vere xhaketën pse u ngrys.
këmishën	Vere këmishën pse u ngrys.
rrobat	Veri rrobat pse u ngrys.
xhaketën	Vere xhaketën pse u ngrys.
palltcn	Vere pallton pse u ngrys.
pantallonat	Veri pantallonat pse u ngrys.

(2) SIMPLE CORRELATION (omit cue from response)

ti	Ke të drejtë.
unë	Kam të drejtë.
ti dhe ai	Kini të drejtë.
ajo	Ka të drejtë.
ai dhe ajo	Kanë të drejtë.
ai dhe unë	Kemi të drejtë.
ai	Ka të drejtë.
ti	Ke të drejtë.

DRILLS

UNIT 21

(3) SIMPLE SUBSTITUTION

sa më shpejt	Sa më shpejt, aq më mirë.
sa më vonë	Sa më vonë, aq më mirë.
sa më heret	Sa më heret, aq më mirë.
sa më nxehtë	Sa më nxehtë, aq më mirë.
sa më ftohët	Sa më ftohët, aq më mirë.
sa më ngadale	Sa më ngadale, aq më mirë.
sa më shpejt	Sa më shpejt, aq më mirë.
sa më heret	Sa më heret, aq më mirë.

(4) SIMPLE CORRELATION (omit cue from response)

mua	Sikur më zuri veshi diçka.
atij	Sikur i zuri veshi diçka.
neve	Sikur na zuri veshi diçka.
mua	Sikur më zuri veshi diçka.
atyre	Sikur u zuri veshi diçka.
asaj	Sikur i zuri veshi diçka.
atij	Sikur i zuri veshi diçka.
neve	Sikur na zuri veshi diçka.

DRILLS

UNIT 21

(5) SIMPLE CORRELATION

yt atë	Më gjan* si yt atë.
vëllezërit e tu	Më gjajnë* si vëllezërit e tu.
ime shoqe	Më gjan si ime shoqe.
e ëma	Më gjan si e ëma.
motrat e tua	Më gjajnë si motrat e tua.
nipërit e mij	Më gjajnë si nipërit e mij.
i ati	Më gjan si i ati.
mbesat e mija	Më gjajnë si mbesat e mija.

* Also ngjan, ngjajnë.

DRILLS

UNIT 21

(6) SIMPLE SUBSTITUTION

t'i shiste lopët	Kishim lënë fjalën që ai t'i shiste lopët në Korçë.
t'i shiste dhentë	Kishim lënë fjalën që ai t'i shiste dhentë në Korçë.
ta shpinte nënën	Kishim lënë fjalën që ai ta shpinte nënën në Korçë.
të rrinte këtu	Kishim lënë fjalën që ai të rrinte këtu në Korçë.
të na priste	Kishim lënë fjalën që ai të na priste në Korçë.
të gjente një dhomë	Kishim lënë fjalën që ai të gjente një dhomë në Korçë.
të vinte me mua	Kishim lënë fjalën që ai të vinte me mua në Korçë.
të vente me ta	Kishim lënë fjalën që ai të vente me ta në Korçë.

DRILLS

UNIT 21

(7) SIMPLE CORRELATION

ç'ka?	Ç'ka? Ka pësuar gjësendi?
ç'ke?	Ç'ke? Ke pësuar gjësendi?
ç'kini?	Ç'kini? Kini pësuar gjësendi?
ç'kanë?	Ç'kanë? Kanë pësuar gjësendi?
ç'kishe?	Ç'kishe? Kishe pësuar gjësendi?
ç'kishit?	Ç'kishit? Kishit pësuar gjësendi?
ç'kishin?	Ç'kishin? Kishin pësuar gjësendi?
ç'kishte?	Ç'kishte? Kishte pësuar gjësendi?

(8) SIMPLE CORRELATION

baba	Ç'të sjell këtej, baba?
djem	Ç'ju sjell këtej, djem?
zotërinj	Ç'ju sjell këtej, zotërinj?
vajza	Ç'ju sjell këtej, vajza?
mor'djalë	Ç'të sjell këtej, mor'djalë?
xhaxha	Ç'të sjell këtej, xhaxha?
nënë	Ç'të sjell këtej, nënë?
xha Vangjel	Ç'të sjell këtej, xha Vangjel?

DRILLS

UNIT 21

(9) SIMPLE CORRELATION (omit cue from response)

unë	Duhet të marr kalin, se ngordhi gomari.
ti dhe ai	Duhet të mirrni kalin, se ngordhi gomari.
ai	Duhet të marrë kalin, se ngordhi gomari.
ata	Duhet të marrin kalin, se ngordhi gomari.
ti dhe unë	Duhet të marrim kalin, se ngordhi gomari.
ti	Duhet të marrësh kalin, se ngordhi gomari.
ai	Duhet të marrë kalin, se ngordhi gomari.
ti	Duhet të marrësh kalin, se ngordhi gomari.
ai dhe ajo	Duhet të marrin kalin, se ngordhi gomari.
ne	Duhet të marrim kalin, se ngordhi gomari.

DRILLS

UNIT 21

(10) RESPONSE

Ti ku rron?	Unë rroj në fshat.
Ajo ku rron?	Ajo rron në fshat.
Ju ku rroni?	Ne rrojmë në fshat.
Ai ku rron?	Ai rron në fshat.
Ata ku rrojnë?	Ata rrojnë në fshat.
Ti ku rron?	Unë rroj në fshat.
Ti ku do të rrosh?	Unë do të rroj në fshat.
Ai ku rronte?	Ai rronte në fshat.

(11) SIMPLE CORRELATION (omit cue from response)

unë	U tremba mos të ishte vdekje.
ne	U trembëm mos të ishte vdekje.
ju?	U trembët mos të ishte vdekje?
ai	U tremb mos të ishte vdekje.
ti?	U trembe mos të ishte vdekje?
ata	U trembën mos të ishte vdekje.
ne	U trembëm mos të ishte vdekje.
ato	U trembën mos të ishte vdekje.

DRILLS

UNIT 21

(12) SIMPLE SUBSTITUTION

Koço	Udhë e mbarë, xha Koço.
Luan	Udhë e mbarë, xha Luan.
Spiro	Udhë e mbarë, xha Spiro.
Kozma	Udhë e mbarë, xha Kozma.
Ali	Udhë e mbarë, xha Ali.
Sotir	Udhë e mbarë, xha Sotir.
Agim	Udhë e mbarë, xha Agim.
Tomorr	Udhë e mbarë, xha Tomorr.

(13) SIMPLE CORRELATION

zgjidha	E zgjidha kalin dhe u hodha mbi të.
zgjidhe	E zgjidhe kalin dhe u hodhe mbi të.
zgjidhi	E zgjidhi kalin dhe u hodh mbi të.
zgjidhëm	E zgjidhëm kalin dhe u hodhëm mbi të.
zgjidhët	E zgjidhët kalin dhe u hodhët mbi të.
zgjidhën	E zgjidhën kalin dhe u hodhën mbi të.
zgjidh	E zgjidh kalin dhe u hodh mbi të.
zgjidhët	E zgjidhët kalin dhe u hodhët mbi të.

DRILLS

UNIT 21

(14) SIMPLE CORRELATION

e mëson	E mëson të këcejë.
të mëson	Të mëson të këcesh.
më mëson	Më mëson të këcej.
na mëson	Na mëson të këcejmë.
i mëson	I mëson të këcejnë.
ju mëson	Ju mëson të këceni.
të mëson	Të mëson të këcesh.
e mëson	E mëson të këcejë.

(15) SIMPLE REPETITION

I mësoj Aliut si të ngasë automobilin.

E mësoj Alinë si të ngasë automobilin.

I mësoj Aliut shqip.

E mësoj Alinë shqip.

I mësoj Aliut piano.

E mësoj Alinë piano.

E mësoj Alinë.

DRILLS

UNIT 21

(16) SIMPLE SUBSTITUTION

të trashë	Ç'krahë të trashë ka ai!
të fortë	Ç'krahë të fortë ka ai!
të gjatë	Ç'krahë të gjatë ka ai!
të hollë	Ç'krahë të hollë ka ai!
të trashë	Ç'krahë të trashë ka ai!
të fortë	Ç'krahë të fortë ka ai!
të trashë	Ç'krahë të trashë ka ai!
të gjatë	Ç'krahë të gjatë ka ai!

(17) SIMPLE SUBSTITUTION

mos shko	Mos shko pa shkop, se qentë janë të këqij.
mos shkoni	Mos shkoni pa shkop, se qentë janë të këqij.
të mos shkosh	Të mos shkosh pa shkop, se qentë janë të këqij.
të mos shkojmë	Të mos shkojmë pa shkop, se qentë janë të këqij.
të mos shkojë	Të mos shkojë pa shkop, se qentë janë të këqij.
të mos shkojmë	Të mos shkojmë pa shkop, se qentë janë të këqij.
të mos shkojnë	Të mos shkojnë pa shkop, se qentë janë të këqij.
të mos shkoni	Të mos shkoni pa shkop, se qentë janë të këqij.
të mos shkojmë	Të mos shkojmë pa shkop, se qentë janë të këqij.

DRILLS

UNIT 21

(18) SIMPLE SUBSTITUTION

ta bëjë këtë	Ai s'është i zoti ta bëjë këtë.
të këcejë kështu	Ai s'është i zoti të këcejë kështu.
të flasë si ty	Ai s'është i zoti të flasë si ty.
t'ju mundë	Ai s'është i zoti t'ju mundë.
të të ndihmojë	Ai s'është i zoti të të ndihmojë.
të shkruajë pa gabime	Ai s'është i zoti të shkruajë pa gabime.
të hajë një pulë të tërë	Ai s'është i zoti të hajë një pulë të tërë.
të pijë një shishe raki	Ai s'është i zoti të pijë një shishe raki.

(19) SIMPLE CORRELATION (omit cue from response)

ti tani	Pse tallesh me të?
ju tani	Pse talleni me të?
ajo tani	Pse tallet me të?
ata tani	Pse tallen me të?
ti tani	Pse tallesh me të?
ajo përpara	Pse tallej me të?
ato tani	Pse tallen me të?
ju tani	Pse talleni me të?

DRILLS

UNIT 21

(20) SIMPLE CORRELATION (omit cue from response)

unë	Jam rritur në çiflik.
ai dhe vëllai i tij	Janë rritur në çiflik.
ai	Është rritur në çiflik.
ti	Je rritur në çiflik.
ti dhe ajo	Jini rritur në çiflik.
ti dhe unë	Jemi rritur në çiflik.
ajo dhe motra e saj	Janë rritur në çiflik.
ajo	Është rritur në çiflik.

(21) MULTIPLE CORRELATION

mbahu	Mbahu mirë, mos biesh e mbytesh.
mbahuni	Mbahuni mirë, mos bini e mbyteni.
të mbahet	Të mbahet mirë, mos bjerë e mbytet.
të mbahen	Të mbahen mirë, mos bien e mbyten.
të mbahemi	Të mbahemi mirë, mos biem e mbytemi.
të mbaheni	Të mbaheni mirë, mos bini e mbyteni.
të mbahesh	Të mbahesh mirë, mos biesh e mbytesh.
mbahuni	Mbahuni mirë, mos bini e mbyteni.

DRILLS

UNIT 21

(22) SIMPLE CORRELATION

ndahen	Ata nuk ndahen kurrë.
ndaheni	Ju nuk ndaheni kurrë.
ndahemi	Ne nuk ndahemi kurrë.
u ndatë	Ju nuk u ndatë kurrë.
u ndamë	Ne nuk u ndamë kurrë.
u ndanë	Ata nuk u ndanë kurrë.
ndaheni	Ju nuk ndaheni kurrë.
u ndamë	Ne nuk u ndamë kurrë.

(23) RESPONSE

Nga t'ja marr?	Merrja djathtas.
Nga t'ja marrim?	Merrjani djathtas.
Nga t'ja marrin?	T'ja marrin djathtas.
Nga t'ja marrë?	T'ja marrë djathtas.
Nga t'ja marrim?	Merrjani djathtas.
Nga t'ja marr?	Merrja djathtas.
Nga t'ja marrë?	T'ja marrë djathtas.
Nga t'ja marrin?	T'ja marrin djathtas.

DRILLS

UNIT 21

(24) SIMPLE CORRELATION

na shpie	Kjo rrugë na shpie drejt në kasollen tonë.
më shpie	Kjo rrugë më shpie drejt në kasollen time.
të shpie	Kjo rrugë të shpie drejt në kasollen tënde.
e shpie	Kjo rrugë e shpie drejt në kasollen e tij.
ju shpie	Kjo rrugë ju shpie drejt në kasollen tuaj.
i shpie	Kjo rrugë i shpie drejt në kasollen e tyre.
na shpie	Kjo rrugë na shpie drejt në kasollen tonë.
të shpie	Kjo rrugë të shpie drejt në kasollen tënde.
ju shpie	Kjo rrugë ju shpie drejt në kasollen tuaj.
më shpie	Kjo rrugë më shpie drejt në kasollen time.
i shpie	Kjo rrugë i shpie drejt në kasollen e tyre.

DRILLS

UNIT 21

ANALYSIS 1: THE SINGULAR COMMAND FORM

(25) RESPONSE

Ku të pushoj?	Më mirë pusho në Korçë.
Ku të shkoj?	Më mirë shko në Korçë.
Ku të mësoj?	Më mirë mëso në Korçë.
Ku ta kërkoj?	Më mirë kërkoje në Korçë.
Ku t'i kërkoj?	Më mirë kërkoji në Korçë.
Ku t'i takoj?	Më mirë takoji në Korçë.
Ku ta takoj?	Më mirë takoje në Korçë.
Ku të pushoj?	Më mirë pusho në Korçë.

(26) RESPONSE

Kur ta laj?	Laje tani.
Kur t'i bëj?	Bëji tani.
Kur t'i laj?	Laji tani.
Kur ta rrëfej?	Rrëfeje tani.
Kur ta bëj?	Bëje tani.
Kur t'i rrëfej?	Rrëfeji tani.
Kur ta ndaj?	Ndaje tani.
Kur t'i ndaj?	Ndaji tani.
Kur të vij?	Eja tani.

DRILLS

UNIT 21

(27) RESPONSE

Ku të rri?	Eja dhe rri me ne.
Ku të ha?	Eja dhe ha me ne.
Ku të pi?	Eja dhe pi me ne.
Ku të këcej?	Eja dhe këce me ne.
Ku të këndoj?	Eja dhe këndo me ne.
Ku të ha?	Eja dhe ha me ne.
Ku të rri?	Eja dhe rri me ne.
Ku të lexoj?	Eja dhe lexo me ne.

(28) RESPONSE

Sa mollë doni të shpie?	Shpjerë sa të duash.
Sa mollë doni të laj?	Laj sa të duash.
Sa mollë doni të ndaj?*	Ndaj sa të duash.
Sa mollë doni të ha?	Ha sa të duash.
Sa mollë doni të urdhëroj?	Urdhëro sa të duash.
Sa mollë doni të pastroj?	Pastro sa të duash.
Sa mollë doni të shpie?	Shpjerë sa të duash.
Sa mollë doni të ha?	Ha sa të duash.

* D.m.th. sa mollë doni të ve mënjanë?

DRILLS

UNIT 21

(29) SIMPLE SUBSTITUTION

dardha	Shko në kopsht e bjena disa dardha.
mollë	Shko në kopsht e bjena disa mollë.
pjepra	Shko në kopsht e bjena disa pjepra.
lule	Shko në kopsht e bjena disa lule.
rrush	Shko në kopsht e bjena disa rrush.
gurë	Shko në kopsht e bjena disa gurë.
fryte	Shko në kopsht e bjena disa fryte.
lule	Shko në kopsht e bjena disa lule.

(30) SIMPLE SUBSTITUTION

je i lodhur	Fli, se je i lodhur.
është vonë	Fli, se është vonë.
u ngrys	Fli, se u ngrys.
është heret akoma	Fli, se është heret akoma.
s'ka gdhirë akoma	Fli, se s'ka gdhirë akoma.
është heret akoma	Fli, se është heret akoma.
është akoma pesë e gjysmë	Fli, se është akoma pesë e gjysmë.
duhet të jesh i lodhur	Fli, se duhet të jesh i lodhur.

DRILLS

UNIT 21

(31) RESPONSE

Ku do ta lë çelësin?	Lere përmbi tryezën.
Ku do ta ve çelësin?	Vere përmbi tryezën.
Ku do t'i ve plaçkat?	Veri përmbi tryezën.
Ku do t'i lë rrobat?	Leri përmbi tryezën.
Ku do ta lë pjenrin?	Lere përmbi tryezën.
Ku do ta ve biletën?	Vere përmbi tryezën.
Ku do t'i ve biletat?	Veri përmbi tryezën.
Ku do t'i lë lulet?	Leri përmbi tryezën.

(32) RESPONSE

Kur t'i zë kafshët?	Zeri tani.
Kur ta zë kalin?	Zere tani.
Kur ta zë gomarin?	Zere tani.
Kur t'i zë kuajt?	Zeri tani.
Kur t'i zë lopët?	Leri tani.
Kur ta zë delen?	Zere tani.
Kur ta zë dhinë?	Zere tani.
Kur t'i zë dhentë?	Zeri tani.

DRILLS

UNIT 21

(33) RESPONSE

Po të më pyesin për ty?	Thuaj se jam i sëmurë.
Po të më pyesin për atë?	Thuaj se është i sëmurë.
Po të më pyesin për ju?	Thuaj se jemi të sëmurë.
Po të më pyesin për ata?	Thuaj se janë të sëmurë.
Po të më pyesin për ato?	Thuaj se janë të sëmura.
Po të më pyesin për Faikun?	Thuaj se është i sëmurë.
Po të më pyesin për vajzat?	Thuaj se janë të sëmura.
Po të më pyesin për Lulen?	Thuaj se është e sëmurë.

(34) RESPONSE

Kur doni t'ju paguaj?	Paguana çdo javë.
Kur do ta paguaj?	Paguaje çdo javë.
Kur duan t'i paguaj?	Paguaji çdo javë.
Kur do të të paguaj?	Paguamë çdo javë.
Kur do ta paguaj?	Paguaje çdo javë.
Kur doni t'ju paguaj?	Paguana çdo javë.
Kur duan t'i paguaj?	Paguaji çdo javë.
Kur do të të paguaj?	Paguamë çdo javë.

DRILLS

UNIT 21

(35) RESPONSE

Ç'doni t'ju rrëfej?	Rrëfena përmbi Borëbardhën*.
Ç'do të të rrëfej?	Rrëfemë përmbi Borëbardhën.
Ç'do të të tregoj?	Tregomë përmbi Borëbardhën.
Ç'do të të them?	Thuamë përmbi Borëbardhën.
Ç'doni t'ju tregoj?	Tregona përmbi Borëbardhën.
Ç'doni t'ju them?	Thuana përmbi Borëbardhën.
Ç'doni t'ju rrëfej?	Rrëfena përmbi Borëbardhën.
Ç'do të të rrëfej?	Rrëfemë përmbi Borëbardhën.

(36) RESPONSE

Në ç'orë doni t'ju zgjoj?	Zgjoma më tetë.
Në ç'orë do të të zgjoj?	Zgjomë më tetë.
Në ç'orë do ta zgjoj?	Zgjoje më tetë.
Në ç'orë duan t'i zgjoj?	Zgjoji më tetë.
Në ç'orë do ta zgjoj?	Zgjoje më tetë.
Në ç'orë doni t'ju zgjoj?	Zgjona më tetë.
Në ç'orë duan t'i zgjoj?	Zgjoji më tetë.
Në ç'orë do të të zgjoj?	Zgjomë më tetë.

* Borëbardha "Snow-White."

DRILLS

UNIT 21

(37) SIMPLE SUBSTITUTION

more Vasil	Ec dhe pak, more Vasil, se vonuam.
more Luan	Ec dhe pak, more Luan, se vonuam.
moj Dritë	Ec dhe pak, moj Dritë, se vonuam.
more Llazar	Ec dhe pak, more Llazar, se vonuam.
moj Fatime	Ec dhe pak, moj Fatime, se vonuam.
moj Lule	Ec dhe pak, moj Lule, se vonuam.
more Ali	Ec dhe pak, more Ali, se vonuam.
more Mehmet	Ec dhe pak, more Mehmet, se vonuam.

(38) RESPONSE

Dhe derën?	Hape dhe atë.
Dhe dritaret?	Hapi dhe ato.
Dhe kutinë?	Hape dhe atë.
Dhe kutitë?	Hapi dhe ato.
Dhe dritaren?	Hape dhe atë.
Dhe dyert?	Hapi dhe ato.
Dhe thasët?	Hapi dhe ata.
Dhe thesin?	Hape dhe atë.

DRILLS

UNIT 21

(39) SIMPLE CORRELATION

domatet	Hidhi dhe domatet.
orizin	Hidhe dhe orizin.
patatet	Hidhi dhe patatet.
bizelet	Hidhi dhe bizelet.
mishin	Hidhe dhe mishin.
peshkun	Hidhe dhe peshkun.
gjalpin	Hidhe dhe gjalpin.
ullinjtë	Hidhi dhe ullinjtë.

(40) SIMPLE SUBSTITUTION

Jani	Baba, dil se do të të flasë xha Jani.
Vangjeli	Baba, dil se do të të flasë xha Vangjeli.
Vasili	Baba, dil se do të të flasë xha Vasili.
Kozmai	Baba, dil se do të të flasë xha Kozmai.
Sotiri	Baba, dil se do të të flasë xha Sotiri.
Koli	Baba, dil se do të të flasë xha Koli.
Alekua	Baba, dil se do të të flasë xha Alekua.
Koçua	Baba, dil se do të të flasë xha Koçua.

DRILLS

UNIT 21

(41) RESPONSE

Dhe pambukun ç'ta bëj?	Mblidhe sa më shpejt.
Dhe dardhat, ç't'i bëj?	Mblidhi sa më shpejt.
Dhe mollët, ç't'i bëj?	Mblidhi sa më shpejt.
Dhe origjin, ç'ta bëj?	Mblidhe sa më shpejt.
Dhe paratë, ç't'i bëj?	Mblidhi sa më shpejt.
Dhe bizelet, ç't'i bëj?	Mblidhi sa më shpejt.
Dhe domatet, ç't'i bëj?	Mblidhi sa më shpejt.
Dhe fasulet, ç't'i bëj?	Mblidhi sa më shpejt.

(42) RESPONSE

Ku doni t'ju pres?	Pritna përjashta xhamisë.
Ku do ta pres?	Prite përjashta xhamisë.
Ku do të të pres?	Pritmë përjashta xhamisë.
Ku duan t'i pres?	Priti përjashta xhamisë.
Ku do ta pres?	Prite përjashta xhamisë.
Ku doni t'ju pres?	Pritna përjashta xhamisë.
Ku do të të pres?	Pritmë përjashta xhamisë.
Ku duan t'i pres?	Priti përjashta xhamisë.

DRILLS

UNIT 21

(43) RESPONSE

Dhe kalin, ç'ta bëj?	Shite.
Dhe lopët, ç't'i bëj?	Shiti.
Dhe lopën, ç'ta bëj?	Shite.
Dhe dhentë, ç't'i bëj?	Shiti.
Dhe shtëpinë, ç'ta bëj?	Shite.
Dhe shtëpitë, ç't'i bëj?	Shiti.
Dhe kafshët, ç't'i bëj?	Shiti.
Dhe kaun, ç'ta bëj?	Shite.

(44) RESPONSE

Ku ta sjell rakinë?	Sille në shtëpi.
Ku t'i sjell frytet?	Silli në shtëpi.
Ku t'i sjell domatet?	Silli në shtëpi.
Ku ta sjell pallton?	Sille në shtëpi.
Ku ta sjell orizin?	Sille në shtëpi.
Ku ta sjell shaminë?	Sille në shtëpi.
Ku t'i sjell rrobat?	Silli në shtëpi.
Ku t'i sjell plaçkat?	Silli në shtëpi.

DRILLS

UNIT 21

(45) RESPONSE

Ku ta marr orizin?	Merre tek Ismaili.
Ku ta marr verën?	Merre tek Ismaili.
Ku t'i marr fasulet?	Merri tek Ismaili.
Ku t'i marr dardhat?	Merri tek Ismaili.
Ku ta marr rakinë?	Merre tek Ismaili.
Ku t'i marr çorapet?	Merri tek Ismaili.
Ku ta marr sapunin?	Merre tek Ismaili.
Ku t'i marr këpucët?	Merri tek Ismaili.

(46) RESPONSE

Ç'ta bëj këtë top?	Jepja ndonjë djali.
Ç't'i bëj këto këpucë?	Jepjau ndonjë djali.
Ç'ta bëj këtë këmishë?	Jepja ndonjë djali.
Ç'ta bëj këtë qen?	Jepja ndonjë djali.
Ç't'i bëj këto gjëra?	Jepjau ndonjë djali.
Ç't'i bëj këto çorape?	Jepjau ndonjë djali.
Ç'ta bëj këtë xhaketë?	Jepja ndonjë djali.
Ç't'i bëj këto topa?	Jepjau ndonjë djali.

DRILLS

UNIT 21

(47) RESPONSE

Sa dyer doni që të hap?	Hap vetëm një.
Sa dritare doni që të mbyll?	Mbyll vetëm një.
Sa dhen doni që të shes?	Shit vetëm një.
Sa dhen doni që të marr?	Merr vetëm një.
Sa pjepra doni që të sjell?	Sill vetëm një.
Sa shishe doni që të marr?	Merr vetëm një.
Sa shishe doni që të shes?	Shit vetëm një.
Sa shishe doni që të sjell?	Sill vetëm një.

(48) RESPONSE

Si t'i flas atij?	Foli shqip.
Si t'u flas atyre?	Folu shqip.
Si të të flas ty?	Folmë shqip.
Si t'ju flas juve?	Folna shqip.
Si t'i flas kësaj?	Foli shqip.
Si të flas me të?	Folë shqip.
Si të flas me ta?	Folë shqip.
Si të flas me ty?	Folë shqip.

DRILLS

UNIT 21

(49) RESPONSE

Ta pres bukën?	Jo, mos e pre akoma.
T'i pres domatet?	Jo, mos i pre akoma.
T'i pres lulet?	Jo, mos i pre akoma.
Ta pres pjeprin?	Jo, mos e pre akoma.
Ta pres ëmbëlsirën.	Jo, mos e pre akoma.
T'i pres pjeprat?	Jo, mos i pre akoma.
Ta pres dardhën?	Jo, mos e pre akoma.
T'i pres patatet?	Jo, mos i pre akoma.

(50) SIMPLE CORRELATION

kalin	Mos e nga ti kalin.
lopët	Mos i nga ti lopët.
gomarin	Mos e nga ti gomarin.
gomarët	Mos i nga ti gomarët.
lopën	Mos e nga ti lopën.
dhentë	Mos i nga ti dhentë.
delen	Mos e nga ti delen.
automobilin	Mos e nga ti automobilin.

DRILLS

UNIT 21

ANALYSIS 2: MEDIOPASSIVE COMMAND FORMS

(51) STRUCTURE REPLACEMENT

Bëhu doktor.	Mos u bëj doktor.
Ndahu.	Mos u ndaj.
Mbahu.	Mos u mbaj.
Kthehu.	Mos u kthe.
Lahu.	Mos u laj.
Rruhu.	Mos u rruaj.
Bëhu oficer.	Mos u bëj oficer.
Kthehu.	Mos u kthe.

(52) VARIATION

Zgjohu.	Mos u zgjo akoma.
Lahu.	Mos u laj akoma.
Largohu.	Mos u largo akoma.
Afrohu.	Mos u afro akoma.
Rruhu.	Mos u rruaj akoma.
Martohu.	Mos u marto akoma.
Vishu.	Mos u vish akoma.
Largchu.	Mos u largo akoma.

DRILLS

UNIT 21

(53) RESPONSE

Do të nisem sot.	Mos u nis akoma.
Do të martohem këtë muaj.	Mos u marto akoma.
Do të afrohem tani.	Mos u afro akoma.
Do të qethem sot.	Mos u qeth akoma.
Do të rruhem tani.	Mos u rruaj akoma.
Do të kthehem sot.	Mos u kthe akoma.
Do të largohem tani.	Mos u largo akoma.
Do të lahem tani.	Mos u laj akoma.

(54) RESPONSE

Nxitohu!	Sapo më the "mos u nxito!"
Largohu!	Sapo më the "mos u largo!"
Lahu!	Sapo më the "mos u laj!"
Rruhu!	Sapo më the "mos u rruaj!"
Mbahu pas meje!	Sapo më the "mos u mbaj pas meje!"
Ulu!	Sapo më the "mos u ul!"
Bëhu avokat!	Sapo më the "mos u bëj avokat!"
Nxitohu!	Sapo më the "mos u nxito!"

DRILLS

UNIT 21

ANALYSIS 3: THE OPTATIVE PERSON SUFFIXES

(55) SIMPLE CORRELATION (with free form cues)

ne	Na mbroftë zoti!
ty	Të mbroftë zoti!
ju	Ju mbroftë zoti!
atë	E mbroftë zoti!
ato	I mbroftë zoti!
mua	Më mbroftë zoti!
ata	I mbroftë zoti!
ty	Të mbroftë zoti!

(56) SIMPLE CORRELATION

të	Të lumshin këmbët që na erdhe.
ju	Ju lumshin këmbët që na erdhët.
u	U lumshin këmbët që na erdhën.
i	I lumshin këmbët që na erdhi.
ju	Ju lumshin këmbët që na erdhët.
të	Të lumshin këmbët që na erdhe.
i	I lumshin këmbët që na erdhi.
u	U lumshin këmbët që na erdhën.

DRILLS

UNIT 21

(57) SIMPLE CORRELATION (omit cue from response)

ti	Rrofsh sa malet!
ju	Rroftë sa malet!
ne	Rrofshim sa malet!
ju	Rrofshi sa malet!
ata	Rrofshin sa malet!
ajo	Rroftë sa malet!
ti	Rrofsh sa malet!
ju	Rrofshi sa malet!

(58) SIMPLE CORRELATION (omit cue from response)

ti	Mos pafsh ditë të bardhë!
ai	Mos paftë ditë të bardhë.
ju	Mos pafshi ditë të bardhë!
ata	Mos pafshin ditë të bardhë!
ajo	Mos paftë ditë të bardhë!
ato	Mos pafshin ditë të bardhë!
ti	Mos pafsh ditë të bardh!
ju	Mos pafshi ditë të bardhë!

DRILLS

UNIT 21

(59) SIMPLE CORRELATION (omit cue from response)

ti	Mbeç me shëndet!
ju	Mbeçi me shëndet!
ai	Mbestë me shëndet!
ata	Mbeçin me shëndet!
ju	Mbeçi me shëndet!
ato	Mbeçin me shëndet!
ajo	Mbestë me shëndet!
ti	Mbeç me shëndet!

(60) SIMPLE CORRELATION (omit cue from response)

ata	Paçin jetë të gjatë dhe të lumtur!
ju	Paçi jetë të gjatë dhe të lumtur!
ai	Pastë jetë të gjatë dhe të lumtur!
ne	Paçim jetë të gjatë dhe të lumtur!
ato	Paçin jetë të gjatë dhe të lumtur!
ajo	Pastë jetë të gjatë dhe të lumtur!
ju	Paçi jetë të gjatë dhe të lumtur!
ti	Paç jetë të gjatë dhe të lumtur!

DRILLS

UNIT 21

(61) SIMPLE CORRELATION (omit cue from response)

unë	Në mos qofsha dembel.*
ti	Në mos qofsh dembel.*
ajo	Në mos qoftë dembele.*
ai	Në mos qoftë dembel.
ne	Në mos qofshim dembelë.*
ju	Në mos qofshi dembelë.*
ato	Në mos qofshin dembela.*
ata	Në mos qofshin dembelë.*

* Also Në mos u dembelofsha/u dembelofsh/u dembeloftë/u dembelofshim/u dembelofshi/u dembelofshin.

DRILLS

UNIT 21

(62) DIRECTED DIALOGUE

Pyeteni X-in si e ndien veten.

Thuajini Z-ës se ju dhëmb akoma pak dora, por jini më mirë se mbrëmë.

Thuajini X-it se ka fjetur dymbëdhjetë orë.

Pyeteni Z-ën pse, sa është ora.

Thuajini X-it se është dhjetë e gjysmë.

Pyeteni Z-ën ç'kini për të ngrënë.

Thuajini X-it se i bletë një akullore.

Thuajini Z-ës: "Rrofsh, moj grua!"

(63) DIRECTED DIALOGUE

Pyeteni X-in pse e mori shkopin.

Thuajini Z-it se në kullotat ka qen shumë të këqij.

Thuajini X-it se atëherë do t'ishte mirë po të kishit dhe ju një shkop.

Thuajini Z-it se ka të drejtë. Thuajini të marrë një shkop nga shtëpia.

Pyeteni X-in ku i venë shkopinjtë.

Thuajini Z-it se ka dy shkopinj prapa derës. Pyeteni a i gjeti.

Thuajini X-it se shihni vetëm një shkop.

Thuajini Z-it se tjetrin duhet ta ketë marrë i ati.

DRILLS

UNIT 21

(64) DIRECTED DIALOGUE

Thuajini X-it se doni ta pyetni diçka.

Thuajini Z-it t'ju pyesë çdo gjë që të dojë.

Thuajini X-it se dje ju thanë se ngordhi Skënder Lluka.

Thuajini Z-it se nuk e dëgjuat.

Thuajini X-it se ju kishin thënë se vetëm për kafshët themi se ngordhin.

Thuajini Z-it se ashtu është, por ngandonjëherë thuhet edhe për njerëz që nuk i duam ose që janë të liq.

Thuajini X-it se nuk do ta mësoni kurrë gjuhën shqipe.

Thuajini Z-it mos të bëhet merak, pse e flet pothuaj si ju Shqiptarët.

(65) DIRECTED DIALOGUE

Pyeteni X-in a ka dhjetë minuta të lira.

Thuajini Z-ës se jini i lirë tani për tani dhe pyeteni pse pyet.

Pyeteni X-in a ta lajë ai foshnjen sot.

Thuajini Z-ës se kini pak frikë mos ju bjerë nga duart, se s'jini mësuar.

Thuajini X-it mos të bëhet merak.

Pyeteni Z-ën ajo ç'do të bëjë.

Thuajini X-it se ju kini për të pregatitur darkën, pse m' orën tetë vijnë të ftuarit.

DRILLS

UNIT 21

(66) DIRECTED DIALOGUE

Pyeteni X-in si venë punët.

Thuajini Z-it se s'venë dhe aq mirë.

Pyeteni X-in pse, ç'ka kësaj here.

Thuajini Z-it se prapë jini pa para, dhe duhet të paguani për disa gjëra që ju dërguan nga Tirana.

Pyeteni X-in a është të paktën mirë me shëndet.

Thuajini Z-it se ju dhëmbin krahët dhe këmbët, por me ç'para të shkoni tek doktori.

Thuajini X-it të shkojë tek doktori i gjatë, pse s'është e nevojshme t'i ketë paratë në dorë.

Thuajini Z-it se i gjati s'është doktor i mirë.

Thuajini X-it se tek i shkurti s'mund të shkojë pa para.

Thuajini Z-it se paratë do t'i mirrni borxh. Pyeteni a ka ai dy mijë lekë për një javë.

Thuajini X-it se kini , por jo për të dhënë borxh.

Thuajini Z-it se ai ju njeh mirë.

Thuajini X-it se e njihni shumë mirë dhe prandaj s'mund t'i jepni borxh.

END OF DRILLS FOR UNIT 21

DRILLS

UNIT 22

(1) SIMPLE CORRELATION (omit cue from response)

mua	Më pëlqen vjeshta, kur bien gjethet.
ty	Të pëlqen vjeshta, kur bien gjethet.
atyre	U pëlqen vjeshta, kur bien gjethet.
neve	Na pëlqen vjeshta, kur bien gjethet.
asaj	I pëlqen vjeshta, kur bien gjethet.
juve	Ju pëlqen vjeshta, kur bien gjethet.
mua	Më pëlqen vjeshta, kur bien gjethet.
atij	I pëlqen vjeshta, kur bien gjethet.

(2) SIMPLE CORRELATION

mua	Mua më pëlqen më shumë prendvera, pse çelin lulet.
atyre	Atyre u pëlqen më shumë prendvera, pse çelin lulet.
juve	Juve ju pëlqen më shumë prendvera, pse çelin lulet.
ty	Ty të pëlqen më shumë prendvera, pse çelin lulet.
mua	Mua më pëlqen më shumë prendvera, pse çelin lulet.
asaj	Asaj i pëlqen më shumë prendvera, pse çelin lulet.
neve	Neve na pëlqen më shumë prendvera, pse çelin lulet.
atyre	Atyre u pëlqen më shumë prendvera, pse çelin lulet.

DRILLS

UNIT 22

(3) SUBSTITUTION IN VARIABLE SLOT

Ke një mizë në faqe.

kam	Kam një mizë në faqe.
në kurriz	Kam një mizë në kurriz.
kisha	Kisha një mizë në kurriz.
në dorë	Kisha një mizë në dorë.
ka	Ka një mizë në dorë.
në faqe	Ka një mizë në faqe.
kishte	Kishte një mizë në faqe.
kishe	Kishe një mizë në faqe.

(4) RESPONSE

Shtëpia ime është tepër e vjetër.	Duhet ta rrëzosh.
Shtëpia jonë është tepër e vjetër.	Duhet ta rrëzoni.
Shtëpia jote është tepër e vjetër.	Duhet ta rrëzoj.
Shtëpia e tyre është tepër e vjetër.	Duhet ta rrëzojnë.
Shtëpia e tij është tepër e vjetër.	Duhet ta rrëzojë.
Shtëpia juaj është tepër e vjetër.	Duhet ta rrëzojmë.
Shtëpitë e tyre janë tepër të vjetra.	Duhet t'i rrëzojnë.
Shtëpitë tuaja janë tepër të vjetra.	Duhet t'i rrëzojmë.

DRILLS

UNIT 22

(5) SIMPLE CORRELATION (omit cue from response)

ne	Kur do ta shtypim rrushin?
ju	Kur do ta shtypni rrushin?
ti	Kur do ta shtypësh rrushin?
unë	Kur do ta shtyp rrushin?
ai	Kur do ta shtypë rrushin?
ata	Kur do ta shtypin rrushin?
ne	Kur do ta shtypim rrushin?
ju	Kur do ta shtypni rrushin?

(6) SUBSTITUTION IN VARIABLE SLOT

Sa të holla i ka këmbët!

të trasha	Sa të trasha i ka këmbët!
kanë	Sa të trasha i kanë këmbët!
të bukura	Sa të bukura i kanë këmbët!
sytë	Sa të bukur i kanë sytë!
ke	Sa të bukur i ke sytë!
të mëdhej	Sa të mëdhej i ke sytë!
ka	Sa të mëdhej i ka sytë!
të zinj	Sa të zinj i ka sytë!

DRILLS

UNIT 22

(7) SIMPLE CORRELATION

mos i trazo	Mos i trazo bletët, se do të të pickojnë.
mos i trazoni	Mos i trazoni bletët, se do t'ju pickojnë.
të mos i trazojë	Të mos i trazojë bletët, se do ta pickojnë.
të mos i trazojnë	Të mos i trazojnë bletët, se do t'i pickojnë.
të mos i trazosh	Të mos i trazosh bletët, se do të të pickojnë.
të mos i trazojmë	Të mos i trazojmë bletët, se do të na pickojnë.
të mos i trazoni	Të mos i trazoni bletët, se do t'ju pickojnë.
të mos i trazojë	Të mos i trazojë bletët, se do ta pickojnë.

DRILLS

UNIT 22

(8) SIMPLE CORRELATION

një lepur	Një lepur u fsheh nëpër drizat.
dy lepura	Dy lepura u fshehën nëpër drizat.
një ujk	Një ujk u fsheh nëpër drizat.
një dele	Një dele u fsheh nëpër drizat.
dy dhen	Dy dhen u fshehën nëpër drizat.
dy dhi	Dy dhi u fshehën nëpër drizat.
dy ujq	Dy ujq u fshehën nëpër drizat.
një dhi	Një dhi u fsheh nëpër drizat.

(9) SIMPLE CORRELATION

lepurin	Ruaje lepurin gjersa të sjell çiften.
lepurat	Ruaji lepurat gjersa të sjell çiften.
ujqtë	Ruaji ujqtë gjersa të sjell çiften.
ujkun	Ruaje ujkun gjersa të sjell çiften.
qenin	Ruaje qenin gjersa të sjell çiften.
kalin	Ruaje kalin gjersa të sjell çiften.
qentë	Ruaji qentë gjersa të sjell çiften.
lepurat	Ruaji lepurat gjersa të sjell çiften.

DRILLS

UNIT 22

(10) SIMPLE SUBSTITUTION

Italie	Këto këpucë janë prej lëkure Italie.
Anglie	Këto këpucë janë prej lëkure Anglie.
Amerike	Këto këpucë janë prej lëkure Amerike.
France	Këto këpucë janë prej lëkure France.
gjermane	Këto këpucë janë prej lëkure gjermane.
angleze	Këto këpucë janë prej lëkure angleze.
frenge	Këto këpucë janë prej lëkure frenge.
italiane	Këto këpucë janë prej lëkure italiane.

(11) SIMPLE SUBSTITUTION

e merr	Mos e merr më qafë!
e marrim	Mos e marrim më qafë!
e mirrni	Mos e mirrni më qafë!
i marrim	Mos i marrim më qafë!
e merr	Mos e merr më qafë!
i merrni	Mos i merrni më qafë!
i merr	Mos i merr më qafë!
e merrni	Mos e merrni më qafë!

DRILLS

UNIT 22

(12) SIMPLE CORRELATION (omit cue from response)

unë	U nxiva në diell.
ne	U nximë në diell.
ti	U nxive në diell.
ju	U nxitë në diell.
ajo	U nxi në diell.
ata	U nxinë në diell.
unë	U nxiva në diell.
ai	U nxi në diell.

(13) SIMPLE SUBSTITUTION

të mbledhim	Të mbledhim ca dru për zjarr.
të mblidhni	Të mblidhni ca dru për zjarr.
të mbledhësh	Të mbledhësh ca dru për zjarr.
të mbledhin	Të mbledhin ca dru për zjarr.
të mbledhë	Të mbledhë ca dru për zjarr.
të mblidhni	Të mblidhni ca dru për zjarr.
mblidhni	Mblidhni ca dru për zjarr.
mblidh	Mblidh ca dru për zjarr.

DRILLS

UNIT 22

(14) SIMPLE SUBSTITUTION

tënd	Hidhma çakmakun tënd.
tim	Hidhma çakmakun tim.
tuaj	Hidhma çakmakun tuaj.
e saj	Hidhma çakmakun e saj.
tonë	Hidhma çakmakun tonë.
e tij	Hidhma çakmakun e tij.
e tyre	Hidhma çakmakun e tyre.
tënd	Hidhma çakmakun tën.

(15) SIMPLE CORRELATION (omit cue from response)

ti	Do ta ndezësh llambën.
ju	Do ta ndezni llambën.
unë	Do ta ndez llambën.
ne	Do ta ndezim llambën.
ai	Do ta ndezë llambën.
ti	Do ta ndezësh llambën.
ata	Do ta ndezin llambën.
ajo	Do ta ndezë llambën.

DRILLS

UNIT 22

(16) SIMPLE SUBSTITUTION

shiko	Shiko mirë mos ngrihet shumë flaka.
shikoni	Shikoni mirë mos ngrihet shumë flaka.
të shikojmë	Të shikojmë mirë mos ngrihet shumë flaka.
të shikojë	Të shikojë mirë mos ngrihet shumë flaka.
të shikojnë	Të shikojnë mirë mos ngrihet shumë flaka.
të shikoni	Të shikoni mirë mos ngrihet shumë flaka.
të shikosh	Të shikosh mirë mos ngrihet shumë flaka.
të shikojmë	Të shikojmë mirë mos ngrihet shumë flaka.

(17) SIMPLE CORRELATION

ka	Ka frikë mos digjet.
ke?	Ke frikë mos digjesh?
kam	Kam frikë mos digjem.
kemi	Kemi frikë mos digjemi.
kini?	Kini frikë mos digjeni?
kanë	Kanë frikë mos digjen.
kam	Kam frikë mos digjem.
keni?	Keni frikë mos digjeni?

DRILLS

UNIT 22

(18) SIMPLE SUBSTITUTION

dhi me dhen	Do të shkëmbej dhi me dhen.
lopë me qe.	Do të shkëmbej lopë me qe.
dhen me dhi	Do të shkëmbej dhen me dhi.
gomarë me kuaj	Do të shkëmbej gomarë me kuaj.
një dhi me një dele	Do të shkëmbaj një dhi me një dele.
një kalë me dy gomarë	Do të shkëmbej një kalë me dy gomarë.
një kalë me një lopë	Do të shkëmbej një kalë me një lopë.
dy qe me një kalë	Do të shkëmbej dy qe me një kalë.

(19) SIMPLE SUBSTITUTION

kur bie shi	Kur bie shi, bëhet baltë e madhe*.
kur bie borë	Kur bie borë, bëhet baltë e madhe.
po të bjerë shi	Po të bjerë shi, bëhet baltë e madhe.
po të bjerë borë	Po të bjerë borë, bëhet baltë e madhe.
kur bie borë	Kur bie borë, bëhet baltë e madhe.
kur bie shi	Kur bie shi, bëhet baltë e madhe.
po të bjerë borë	Po të bjerë borë, bëhet baltë e madhe.
po të bjerë shi	Po të bjerë shi, bëhet baltë e madhe.

* Also <u>bëhet llucë e madhe</u> and <u>bëhet gjol i madh</u>.

DRILLS

UNIT 22

(20) SUBSTITUTION IN VARIABLE SLOT

Për bujqësinë shiu është i keq tashti.

i mirë	Për bujqësinë shiu është i mirë tashti.
bora	Për bujqësinë bora është e mirë tashti.
e nevojshme	Për bujqësinë bora është e nevojshme tashti.
e keqe	Për bujqësinë bora është e keqe tashti.
shiu	Për bujqësinë shiu është i keq tashti.
i nevojshëm	Për bujqësinë shiu është i nevojshëm tashti.

(21) SUBSTITUTION IN VARIABLE SLOT

Ne fshatarët s'kemi mundësi të punojmë arat.

të pregatitim	Ne fshatarët s'kemi mundësi të pregatitim arat.
ju fshatarët	Ju fshatarët s'kini mundësi të pregatitni arat.
të punoni	Ju fshatarët s'kini mundësi të punoni arat.
fshatari	Fshatari s'ka mundësi të punojë arat.
të pregatisë	Fshatari s'ka mundësi të pregatisë arat.
fshatarët	Fshatarët s'kanë mundësi të pregatitin arat.
ne fshatarët	Ne fshatarët s'kemi mundësi të pregatitim arat.
të punojmë	Ne fshatarët s'kemi mundësi të punojmë arat.

DRILLS

UNIT 22

(22) SIMPLE SUBSTITUTION

misër	Po të më vejë mbarë, marr pothuaj pesëdhjetë kujntalë misër.
grurë	Po të më vejë mbarë, marr pothuaj pesëdhjetë kujntalë grurë.
tërshërë	Po të më vejë mbarë, marr pothuaj pesëdhjetë kujntalë tërshërë.
misër	Po të më vejë mbarë, marr pothuaj pesëdhjetë kujntalë misër.
elb	Po të më vejë mbarë, marr pothuaj pesëdhjetë kujntalë elb.
grurë	Po të më vejë mbarë, marr pothuaj pesëdhjetë kujntalë grurë.
tërshërë	Po të më vejë mbarë, marr pothuaj pesëdhjetë kujntalë tërshërë.
elb	Po të më vejë mbarë, marr pothuaj pesëdhjetë kujntalë elb.

DRILLS

UNIT 22

(23) SUBSTITUTION IN VARIABLE SLOT

Ne marrim nja tridhjetë tridhjetë e pesë kujntalë grurë.

ata	Ata marrin nja tridhjetë tridhjetë e pesë kujntalë grurë.
tërshërë	Ata marrin nja tridhjetë tridhjetë e pesë kujntalë tërshërë.
ju	Ju mirrni nja tridhjetë tridhjetë e pesë kujntalë tërshërë.
misër	Ju mirrni nja tridhjetë tridhjetë e pesë kujntalë misër.
ne	Ne marrim nja tridhjetë tridhjetë e pesë kujntalë misër.
elb	Ne marrim nja tridhjetë tridhjetë e pesë kujntalë elb.
ata	Ata marrin nja tridhjetë tridhjetë e pesë kujntalë elb.
misër	Ata marrin nja tridhjetë tridhjetë e pesë kujntalë misër.

DRILLS

UNIT 22

(24) RESPONSE

Ti mbjell dhe elb?	Shumë pak, se hedh pak farë.
Ju mbillni dhe elb?	Shumë pak, se hedhim pak farë.
Ata mbjellin dhe elb?	Shumë pak, se hedhin pak farë.
Ai mbjell dhe elb?	Shumë pak, se hedh pak farë.
Ai mbillte dhe elb?	Shumë pak, se hidhte pak farë.
Ju mbillni dhe elb?	Shumë pak, se hedhim pak farë.
Ti mbjell dhe elb?	Shumë pak, se hedh pak farë.
Ata mbjellin dhe elb?	Shumë pak, se hedhin pak farë.

(25) SIMPLE CORRELATION

të uroj	Të uroj që të të vejë mbarë sivjet.
ju uroj	Ju uroj që t'ju vejë mbarë sivjet.
i uroj	I uroj që t'i vejë mbarë sivjet.
u uroj	U uroj që t'u vejë mbarë sivjet.
ju uroj	Ju uroj që t'ju vejë mbarë sivjet.
të uroj	Të uroj që të të vejë mbarë sivjet.
u uroj	U uroj që t'u vejë mbarë sivjet.
i uroj	I uroj që t'i vejë mbarë sivjet.

DRILLS

UNIT 22

(26) SIMPLE CORRELATION (omit cue from response)

ty	I lutem zotit që të të vejë mbarë.
neve	I lutem zotit që të na vejë mbarë.
asaj	I lutem zotit që t'i vejë mbarë.
atyre	I lutem zotit që t'u vejë mbarë.
mua	I lutem zotit që të më vejë mbarë.
juve	I lutem zotit që t'ju vejë mbarë.
ty	I lutem zotit që të të vejë mbarë.
atij	I lutem zotit që t'i vejë mbarë.

(27) SUBSTITUTION IN VARIABLE SLOT

Doni t'ju ndihmojmë në korrjen e grurit?

t'ju ndihmoj	Doni t'ju ndihmoj në korrjen e grurit?
e tërshërës	Doni t'ju ndihmoj në korrjen e tërshërës?
t'ju ndihmojnë	Doni t'ju ndihmojnë në korrjen e tërshërës?
t'ju ndihmojë	Doni t'ju ndihmojë në korrjen e tërshërës?
e elbit	Doni t'ju ndihmojë në korrjen e elbit?
t'ju ndihmojmë	Doni t'ju ndihmojmë në korrjen e elbit?
e grurit	Doni t'ju ndihmojmë në korrjen e grurit?
t'ju ndihmojë	Doni t'ju ndihmojë në korrjen e grurit?

DRILLS

UNIT 22

(28) SIMPLE SUBSTITUTION

tënd	Në atdheun tënd ka shumë vegla të ndryshme.
e saj	Në atdheun e saj ka shumë vegla të ndryshme.
tim	Në atdheun tim ka shumë vegla të ndryshme.
tonë	Në atdheun tonë ka shumë vegla të ndryshme.
e tyre	Në atdheun e tyre ka shumë vegla të ndryshme.
e tij	Në atdheun e tij ka shumë vegla të ndryshme.
tim	Në atdheun tim ka shumë vegla të ndryshme.
tuaj	Në atdheun tuaj ka shumë vegla të ndryshme.
tënd	Në atdheun tënd ka shumë vegla të ndryshme.
tonë	Në atdheun tonë ka shumë vegla të ndryshme.

DRILLS

UNIT 22

(29) MULTIPLE CORRELATION

ne kemi	Ne kemi shumë traktorë që përdorim për të punuar tokën.
ju kini	Ju kini shumë traktorë që përdorni për të punuar tokën.
ai ka	Ai ka një traktor që përdor për të punuar tokën.
bujqtë kanë	Bujqtë kanë shumë traktorë që përdorin për të punuar tokën.
ti ke	Ti ke një traktor që përdor për të punuar tokën.
ai kishte	Ai kishte një traktor që përdorte për të punuar tokën.
unë kam	Unë kam një traktor që përdor për të punuar tokën.
Amerikanët kanë	Amerikanët kanë shumë traktorë që përdorin për të punuar tokën.

DRILLS

UNIT 22

(30) SIMPLE SUBSTITUTION

kini dhe maqina	Kini dhe maqina për mbjelljen dhe korrjen e bereqetit.
ka dhe një maqinë	Ka dhe një maqinë për mbjelljen dhe korrjen e bereqetit.
kanë dhe maqina	Kanë dhe maqina për mbjelljen dhe korrjen e bereqetit.
kemi dhe maqina	Kemi dhe maqina për mbjelljen dhe korrjen e bereqetit.
ke dhe një maqinë	Ke dhe një maqinë për mbjelljen dhe korrjen e bereqetit.
kanë dhe një maqinë	Kanë dhe një maqinë për mbjelljen dhe korrjen e bereqetit.
kam dhe një maqinë	Kam dhe një maqinë për mbjelljen dhe korrjen e bereqetit.
kemi dhe një maqinë	Kemi dhe një maqinë për mbjelljen dhe korrjen e bereqetit.

DRILLS

UNIT 22

(31) SIMPLE CORRELATION

ti	Me dëshirën e perëndisë, do të martohesh edhe ti.
ne	Me dëshirën e perëndisë, do të martohemi edhe ne.
ajo	Me dëshirën e perëndisë, do të martohet edhe ajo.
unë	Me dëshirën e perëndisë, do të martohem edhe unë.
ju	Me dëshirën e perëndisë, do të martoheni edhe ju.
ato	Me dëshirën e perëndisë, do të martohen edhe ajo.
ti	Me dëshirën e perëndisë, do të martohesh edhe ti.
ai	Me dëshirën e perëndisë, do të martohet edhe ai.

(32) SIMPLE CORRELATION

bleva	Bleva një traktor që të më pakësojë vuajtjet dhe mundimet.
blemë	Blemë një traktor që të na pakësojë vuajtjet dhe mundimet.
bleu	Bleu një traktor që t'i pakësojë vuajtjet dhe mundimet.
bleve	Bleve një traktor që të të pakësojë vuajtjet dhe mundimet.
blenë	Blenë një traktor që t'u pakësojë vuajtjet dhe mundimet.
bletë	Bletë një traktor që t'ju pakësojë vuajtjet dhe mundimet.
bleu	Bleu një traktor që t'i pakësojë vuajtjet dhe mundimet.
bleva	Bleva një traktor që të më pakësojë vuajtjet dhe mundimet.

DRILLS

UNIT 22

ANALYSIS 2: BOUND FORMS OF PRONOUNS

(33) RESPONSE

Të pa vajza?	Më pa.
E pa vajza?	E pa.
Më pa vajza?	Të pa.
Ju pa vajza?	Na pa.
I pa vajza?	I pa.
Na pa vajza?	Ju pa.
Më pa vajza?	Të pa.
Të pa vajza?	Më pa.

(34) VARIATION

Pashë një vajzë.	Më pa një vajzë.
Pe një vajzë.	Të pa një vajzë.
Pa një vajzë.	E pa një vajzë.
Patë një vajzë.	Ju pa një vajzë.
Pamë një vajzë.	Na pa një vajzë.
Pe një vajzë.	Të pa një vajzë.
Panë një vajzë.	I pa një vajzë.
Pashë një vajzë.	Më pa një vajzë.

DRILLS

UNIT 22

(35) VARIATION

E pashë.	Më pa.
Ju pashë.	Më patë.
I pashë.	Më panë.
Të pashë.	Më pe.
E pamë.	Na pa.
I pamë.	Na panë.
Të pamë.	Na pe.
Ju pamë.	Na patë.

(36) VARIATION

Më ndihmoi.	E ndihmova.
Më ndihmove.	Të ndihmova.
Më ndihmuat.	Ju ndihmova.
Na ndihmuat.	Ju ndihmuam.
Më ndihmuan.	I ndihmova.
I ndihmuam.	Na ndihmuan.
E ndihmuan.	I ndihmoi.
E ndihmuat.	Ju ndihmoi.

DRILLS

UNIT 22

(37) VARIATION

Pashë motrat e saja.	Po të miat i pe?
Pashë vëllanë e saj.	Po timin e pe?

DRILLS

UNIT 26

(42) RESPONSE

Vëllanë tim e zunë Gjermanët.	Edhe tëndin?
Motrën time e zunë Gjermanët.	Edhe tënden?
Vëllezërit e mi i zunë Gjermanët.	Edhe të tutë?
Babanë tim e zunë Gjermanët.	Edhe tëndin?
Vajzat e mia i zunë Gjermanët.	Edhe të tuat?
Djemtë e mi i zunë Gjermanët.	Edhe të tutë?
Vajzën time e zunë Gjermanët.	Edhe tënden?
Motrat e mia i zunë Gjermanët.	Edhe të tuat?

(43) RESPONSE

Vëllanë e tij e vranë Gjermanët.	Edhe të tijin, eh?
Motrën e tij e vranë Gjermanët.	Edhe të tijën, eh?
Motrën e saj e vranë Gjermanët.	Edhe të sajën, eh?
Motrat e saja i vranë Gjermanët.	Edhe të sajat, eh?
Motrat e tija i vranë Gjermanët.	Edhe të tijat, eh?
Vëllanë e saj e vranë Gjermanët.	Edhe të sajin, eh?
Vëllezërit e saj i vranë Gjermanët.	Edhe të sajtë, eh?
Vëllezërit e tij i vranë Gjermanët.	Edhe të tijtë, eh?

DRILLS

UNIT 26

(44) RESPONSE

Takova vajzën e Vasilit.	Po tonën e takove?
Takova djalin e Vasilit.	Po tonin e takove?
Takova djemtë e Vasilit.	Po tonët i takove?
Takova vajzat e Vasilit.	Po tonat i takove?
Takova nipërit e Vasilit.	Po tonët i takove?
Takova nipin e Vasilit.	Po tonin e takove?
Takova mbesën e Vasilit.	Po tonën e takove?
Takova mbesat e Vasilit.	Po tonat i takove?

(45) RESPONSE

Takuan djalin e tyre.	Po tuajin e takuan?
Takuan djemtë e tyre.	Po tuajt i takuan?
Takuan vajzën e tyre.	Po tuajën e takuan?
Takuan vajzat e tyre.	Po tuajat i takuan?
Takuan motrën e tyre.	Po tuajën e takuan?
Takuan vëllezërit e tyre.	Po tuajt i takuan?
Takuan vëllanë e tyre.	Po tuajin e takuan?
Takuan motrat e tyre.	Po tuajat i takuan?

DRILLS

UNIT 26

(46) RESPONSE

Djalin e tyre e vranë Gjermanët.	Edhe të tyrin, eh?
Vajzat e tyre i vranë Gjermanët.	Edhe të tyret, eh?
Vajzën e tyre e vranë Gjermanët.	Edhe të tyren, eh?
Babanë e tyre e vranë Gjermanët.	Edhe të tyrin, eh?
Djemtë e tyre i vranë Gjermanët.	Edhe të tyret, eh?
Nënën e tyre e vranë Gjermanët.	Edhe të tyren, eh?
Motrat e tyre i vranë Gjermanët.	Edhe të tyret, eh?
Vëllezërit e tyre i vranë Gjermanët.	Edhe të tyret, eh?

(47) REPONSE

Djalit tim i dhanë një libër.	Edhe timit.
Vajzës sime i dhanë një libër.	Edhe simes.
Vajzavet të mia u dhanë nga një libër.	Edhe të miavet.
Djemvet të mi u dhanë nga një libër.	Edhe të mivet.
Vëllait tim i dhanë një libër.	Edhe timit.
Vëllezërvet të mi u dhanë nga një libër.	Edhe të mivet.
Motrës sime i dhanë një libër.	Edhe simes.
Motravet të mia u dhanë nga një libër.	Edhe të miavet.

DRILLS

UNIT 26

(48) RESPONSE

Vajzës së saj i dhanë lule.	Po sates ç'i dhanë?
Gjyshit të saj i dhanë lule.	Po tëndit ç'i dhanë?
Vajzavet të saja u dhanë lule.	Po të tunvet ç'u dhanë?
Prindvet të saj u dhanë lule.	Po të tuvet ç'u dhanë?
Motrës së saj i dhanë lule.	Po sates ç'i dhanë?
Motravet të saja u dhanë lule.	Po të tuavet ç'u dhanë?
Vjehërvet të saj u dhanë lule.	Po të tuvet ç'u dhanë?
Babait të saj i dhanë lule.	Po tëndit ç'i dhanë?

(49) RESPONSE

Djalit të tij i dhëmb koka.	Edhe të sajit.
Djemvet të tij u dhëmb koka.	Edhe të sajvet.
Djemvet të saj u dhëmb koka.	Edhe të tijvet.
Djalit të saj i dhëmb koka.	Edhe të tijit.
Vajzës së saj i dhëmb koka.	Edhe së tijës.
Vajzavet të saja u dhëmb koka.	Edhe të tijavet.
Vajzavet të tija u dhëmb koka.	Edhe të sajavet.
Vajzës së tij i dhëmb koka.	Edhe së sajës.

DRILLS

UNIT 26

(50) RESPONSE

Vajzës sonë i dhanë një libër.	Edhe sonës.
Vajzavet tona u dhanë nga një libër.	Edhe tonavet.
Djemvet tonë u dhanë nga një libër.	Edhe tonëvet.
Djalit tonë i dhanë një libër.	Edhe tonit.
Motrës sonë i dhanë një libër.	Edhe sonës.
Vëllezërvet tonë u dhanë nga një libër.	Edhe tonëvet.
Vëllait tonë i dhanë një libër.	Edhe tonit.
Motravet tona u dhanë nga një libër.	Edhe tonavet.

(51) RESPONSE

Vëllait tuaj nuk i dhanë gjë.	Po tuajit?
Motrës suaj nuk i dhanë gjë.	Po suajës?
Motravet tuaja nuk u dhanë gjë.	Po tuajavet?
Vëllezërvet tuaj nuk u dhanë gjë.	Po tuajvet?
Djalit tuaj nuk i dhanë gjë.	Po tuajit?
Djemvet tuaj nuk u dhanë gjë.	Po tuajvet?
Vajzavet tuaja nuk u dhanë gjë.	Po tuajavet?
Vajzës suaj nuk i dhanë gjë.	Po suajës?

DRILLS

UNIT 26

(52) RESPONSE

Djalit tonë i prunë lule.	Po të tyrit?
Vajzës sonë i prunë lule.	Po së tyres?
Vajzavet tona u prunë lule.	Po të tyrevet?
Djemvet tonë u prunë lule.	Po të tyrevet?
Motrës sonë i prunë lule.	Po së tyres?
Vëllezërvet tonë u prunë lule.	Po të tyrevet?
Vëllait tonë i prunë lule.	Po të tyrit?
Motravet tona u prunë lule.	Po të tyrevet?

(53) DIRECTED DIALOGUE

Pyeteni X-in a ka me të vërtetë aq shumë para xhaxhai i tij.

Thuajini Z-it se paska para sa të dojë (Z-i).

Thuajini X-it se të paktën juve s'ju duket të jetë fukara.

Thuajini Z-it ç'fukara, me dy fabrika dhe me një minierë hekuri.

Thuajini X-it se ju tha (X-i) se ka edhe puse vajguri.

Thuajini Z-it se ka të drejtë: ka edhe puse vajguri në Teksas.

Pyeteni X-in a është i martuar (xhaxhai i tij).

Thuajini Z-it se, jo vetëm që është i martuar, por se i ndërron gratë çdo dy-tre vjet.

Thuajini X-it se paska fat ky burrë.

DRILLS

UNIT 26

(54) DIRECTED DIALOGUE

Thuajini X-it se gjetën vajgur n'atdheun tuaj.

Thuajini Z-it se gëzoheni.

Thuajini X-it se gjithnjë thonin se ishit fukarenj, por asnjeri s'kishte kërkuar kurrë për të gjetur pasuritë e vendit.

Thuajini Z-it më mirë vonë se kurrë.

Thuajini X-it se besoni se ka edhe pasuri të tjera në Shqipëri.

Thuajini Z-it kush e di. Kini nevojë për shumë të holla për t'i gjetur.

Thuajini X-it se, sidoqoftë, këto të holla nuk shkojnë kot.

(55) DIRECTED DIALOGUE

Pyeteni X-in ç'punë bën.

Thuajini Z-it se jini nëpunës në Ministrinë e Punëvet të Jashtme.

Pyeteni X-in a i pëlqen puna e tij.

Thuajini Z-it se ju pëlqen mjaft.

Pyeteni X-in a e kanë dërguar ndonjëherë në shtete të huaja.

Thuajini Z-it se, për fat të keq, kini punuar gjithnjë këtu në Tiranë.

Urojini X-it ta dërgojnë shpejt ku dëshiron ai.

Thuajini Z-it se do t'ju pëlqente t'ju dërgonin në Shtetet e Bashkuara në Nju Jork.

SPOKEN ALBANIAN

DRILLS

UNIT 26

(56) DIRECTED DIALOGUE

Pyeteni X-in kush është ai zotni me kapelë të zezë dhe me dorëza ngjyrë hiri.

Thuajini Z-it se ai është "Ministër" Doda.

Pyeteni X-in ministër i kujt është.

Thuajini Z-it se s'është ministër, por kështu e quajnë të gjithë.

Pyeteni X-in pse e quajnë kështu. A ka qenë ndonjëherë 'ministër?

Thuajini Z-it se s'ka qenë as nëpunës ministrie, por flet sikur të jetë njeri me shumë rëndësi.

Thuajini X-it se ju foli frengjisht, por s'e kuptuat dot.

Pyeteni Z-in pse, s'di frengjisht (Z-i).

Thuajini X-it se ju dini frengjisht; "Ministri" s'di.

Pyeteni Z-in atëherë pse nuk i foli shqip.

Thuajini X-it se ashtu i folët.

Pyeteni Z-in ç'bëri atëherë Doda.

Thuajini X-it se ju shikoi me çudi dhe ju tha: "Nuk e dija se zotnia jote e fliste aq mirë gjuhën tonë".

Thuajini Z-it se me të vërtetë qenka për t'u lidhur.

DRILLS

UNIT 26

(57) DIRECTED DIALOGUE

Thuajini X-it se dje erdhi një inspektor në zyrën tuaj.

Pyeteni Z-in kush e dërgoi.

Thuajini X-it se e dërgoi qeveria.

Pyeteni Z-in ç'ndodhi.

Thuajini X-it se patët frikë kur e patë.

Pyeteni Z-in pse u tremb. A kishte diçka për të fshehur?

Thuajini X-it se të gjithë kini diçka për të fshehur.

Thuajini Z-it se ashtu është.

END OF DRILLS FOR UNIT 26

DRILLS

UNIT 27

(1) SIMPLE SUBSTITUTION

tri javëve	Brenda tri javëve duhet të shkojmë në Jugosllavi.
tre muajve	Brenda tre muajve duhet të shkojmë në Jugosllavi.
pesë ditve	Brenda pesë ditve duhet të shkojmë në Jugosllavi.
katër javëve	Brenda katër javëve duhet të shkojmë në Jugosllavi.
një jave	Brenda një jave duhet të shkojmë në Jugosllavi.
dy javëve	Brenda dy javëve duhet të shkojmë në Jugosllavi.
katër ditve	Brenda katër ditve duhet të shkojmë në Jugosllavi.
tri ditve	Brenda tri ditve duhet të shkojmë në Jugosllavi.

(2) SIMPLE SUBSTITUTION

shqiptare	Udhëtoj gjithnjë me pashaportë* shqiptare.
amerikane	Udhëtoj gjithnjë me pashaportë amerikane.
turke	Udhëtoj gjithnjë me pashaportë turke.
italiane	Udhëtoj gjithnjë me pashaportë italiane.
frenge	Udhëtoj gjithnjë me pashaportë frenge.
angleze	Udhëtoj gjithnjë me pashaportë angleze.
gjermane	Udhëtoj gjithnjë me pashaportë gjermane.
jugosllave	Udhëtoj gjithnjë me pashaportë jugosllave.

* Also <u>pasaportë</u>.

DRILLS

UNIT 27

(3) MULTIPLE CORRELATION

jam	Jam i sigurt se brenda këtyre ditve do t'i kem gati.
jemi	Jemi të sigurt se brenda këtyre ditve do t'i kemi gati.
është	Është i sigurt se brenda këtyre ditve do t'i ketë gati.
a je?	A je i sigurt se brenda këtyre ditve do t'i kesh gati?
a jini?	A jini të sigurt se brenda këtyre ditve do t'i kini gati?
jam	Jam i sigurt se brenda këtyre ditve do t'i kem gati.
janë	Janë të sigurt se brenda këtyre ditve do t'i kenë gati.
jemi	Jemi të sigurt se brenda këtyre ditve do t'i kemi gati.

(4) RESPONSE

A është e lehtë* kjo punë?	Jo, është mjaft e rëndë.
A është i lehtë* ky mësim?	Jo, është mjaft i rëndë.
A është e lehtë shqipja?	Jo, është mjaft e rëndë.
A janë të lehta këto mësime?	Jo, janë mjaft të rënda.
A është e lehtë kjo gjuhë?	Jo, është mjaft e rëndë.
A janë të lehta këto punë?	Jo, janë mjaft të rënda.
A janë të lehta këto valle?	Jo, janë mjaft të rënda.
A janë të lehta këto këngë?	Jo, janë mjaft të rënda.

* Also kollaj.

DRILLS

UNIT 27

(5) STRUCTURE REPLACEMENT

Ku duhet paraqitur lutja ime?	Ku duhen paraqitur lutjet tona?
Ku duhet paraqitur lutja jote?	Ku duhen paraqitur lutjet tuaja?
Ku duhet paraqitur lutja e tij?	Ku duhen paraqitur lutjet e tyre?
Ku duhet paraqitur lutja e saj?	Ku duhen paraqitur lutjet e tyre?
Ku duhet paraqitur lutja jote?	Ku duhen paraqitur lutjet tuaja?
Ku duhet paraqitur lutja ime?	Ku duhen paraqitur lutjet tona?
Ku duhet paraqitur lutja jote?	Ku duhen paraqitur lutjet tuaja?
Ku duhet paraqitur lutja e saj?	Ku duhen paraqitur lutjet e tyre?

(6) RESPONSE

Ku duhet paraqitur lutja ime?	Jotja këtu në Ministri.
Ku duhet paraqitur lutja jote?	Imja këtu në Ministri.
Ku duhet paraqitur lutja e tij?	E tija këtu në Ministri.
Ku duhet paraqitur lutja e saj?	E saja këtu në Ministri.
Ku duhet paraqitur lutja jote?	Imja këtu në Ministri.
Ku duhen paraqitur lutjet tona?	Tuajat këtu në Ministri.
Ku duhen paraqitur lutjet e tyre?	Të tyret këtu në Ministri.
Ku duhen paraqitur lutjet tuaja?	Tonat këtu në Ministri.

DRILLS

UNIT 27

(7) SIMPLE SUBSTITUTION

Ku duhen paraqitur lutjet?

jona	Jona këtu në Komitet, ndërsa jotja duhet dërguar në kryeqytet.
e tija	E tija këtu në Komitet, ndërsa jotja duhet dërguar në kryeqytet.
e tyrja	E tyrja këtu në Komitet, ndërsa jotja duhet dërguar në kryeqytet.
tonat	Tonat këtu në Komitet, ndërsa jotja duhet dërguar në kryeqytet.
të tyret	Të tyret këtu në Komitet, ndërsa jotja duhet dërguar në kryeqytet.
e saja	E saja këtu në Komitet, ndërsa jotja duhet dërguar në kryeqytet.
imja	Imja këtu në Komitet, ndërsa jotja duhet dërguar në kryeqytet.
jona	Jona këtu në Komitet, ndërsa jotja duhet dërguar në kryeqytet.

5

DRILLS

UNIT 27

(8) SIMPLE SUBSTITUTION

amerikane	Ku ndodhet konsullata amerikane?
angleze	Ku ndodhet konsullata angleze?
turke	Ku ndodhet konsullata turke?
frenge	Ku ndodhet konsullata frenge?
italiane	Ku ndodhet konsullata italiane?
jugosllave	Ku ndodhet konsullata jugosllave?
ruse	Ku ndodhet konsullata ruse?
gjermane	Ku ndodhet konsullata gjermane?

(9) SIMPLE CORRELATION

mua	Mua më nevojitet vetëm viza.
atyre	Atyre u nevojitet vetëm viza.
asaj	Asaj i nevojitet vetëm viza.
juve	Juve ju nevojitet vetëm viza.
neve	Neve na nevojitet vetëm viza.
atij	Atij i nevojitet vetëm viza.
ty	Ty të nevojitet vetëm viza.
mua	Mua më nevojitet vetëm viza.

DRILLS

UNIT 27

(10) SIMPLE CORRELATION

për timen	Për timen do të shkojë shumë kohë përpara se ta marr.
për tënden	Për tënden do të shkojë shumë kohë përpara se ta marrësh.
për tonën	Për tonën do të shkojë shumë kohë përpara se ta marrim.
për të tijën	Për të tijën do të shkojë shumë kohë përpara se ta marrë.
për të tyren	Për të tyren do të shkojë shumë kohë përpara se ta marrin.
për tuajën	Për tuajën do të shkojë shumë kohë përpara se ta mirrni.
për të sajën	Për të sajën do të shkojë shumë kohë përpara se ta marrë.
për tënden	Për tënden do të shkojë shumë kohë përpara se ta marrësh.

DRILLS

UNIT 27

(11) SIMPLE CORRELATION

bir	Për ç'arësye nuk e pranove tim bir?
bijë	Për ç'arësye nuk e pranove time bijë?
shoqje	Për ç'arësye nuk e pranove time shoqje?
atë	Për ç'arësye nuk e pranove tim atë?
vëlla	Për ç'arësye nuk e pranove tim vëlla?
motër	Për ç'arësye nuk e pranove time motër?
shoq	Për ç'arësye nuk e pranove tim shoq?
ëmë	Për ç'arësye nuk e pranove time ëmë?

(12) SIMPLE CORRELATION

lutja	Lutja duhet firmuar prej Ministrit të Jashtëm në Tiranë.
lutjet	Lutjet duhen firmuar prej Ministrit të Jashtëm në Tiranë.
pasha-porta	Pashaporta duhet firmuar prej Ministrit të Jashtëm në Tiranë.
letra	Letra duhet firmuar prej Ministrit të Jashtëm në Tiranë.
pasha-portat	Pashaportat duhen firmuar prej Ministrit të Jashtëm në Tiranë.
letrat	Letrat duhen firmuar prej Ministrit të Jashtëm në Tiranë.
lutja	Lutja duhet firmuar prej Ministrit të Jashtëm në Tiranë.
pasha-portat	Pashaportat duhen firmuar prej Ministrit të Jashtëm në Tiranë.

DRILLS

UNIT 27

(13) MULTIPLE CORRELATION

lajm	Ky lajm s'duhet botuar.
lajme	Këto lajme s'duhen botuar.
letra	Këto letra s'duhen botuar.
gjë	Kjo gjë s'duhet botuar.
letër	Kjo letër s'duhet botuar.
gjëra	Këto gjëra s'duhen botuar.
lajme	Këto lajme s'duhen botuar.
lajm	Kjo lajm s'duhet botuar.

(14) SIMPLE SUBSTITUTION

është botuar	Në gazetën e sotshme është botuar një lajm interesant.
ishte botuar	Në gazetën e sotshme ishte botuar një lajm interesant.
lexova	Në gazetën e sotshme lexova një lajm interesant.
pashë	Në gazetën e sotshme pashë një lajm interesant.
lexuam	Në gazetën e sotshme lexuam një lajm interesant.
pamë	Në gazetën e sotshme pamë një lajm interesant.
panë	Në gazetën e sotshme panë një lajm interesant.
lexuan	Në gazetën e sotshme panë një lajm interesant.

DRILLS

UNIT 27

(15) SIMPLE CORRELATION

mësuesit	Mësuesit i paguan Ministria e Arësimit.
mësuesen	Mësuesen e paguan Ministria e Arësimit.
mua	Mua më paguan Ministria e Arësimit.
mësuesin	Mësuesin e paguan Ministria e Arësimit.
ne	Ne na paguan Ministria e Arësimit.
atë	Atë e paguan Ministria e Arësimit.
mësueset	Mësueset i paguan Ministria e Arësimit.
ato	Ato i paguan Ministria e Arësimit.

(16) MULTIPLE CORRELATION

e bija	Thuhet* se e bija e Ministrit është e sëmurë.
i biri	Thuhet se i biri i Ministrit është i sëmurë.
të vëllezërit	Thuhet se të vëllezërit e Ministrit janë të sëmurë.
të motrat	Thuhet se të motrat e Ministrit janë të sëmura.
të bijat	Thuhet se të bijat e Ministrit janë të sëmura.
i vëllai	Thuhet se i vëllai i Ministrit është i sëmurë.
e shoqja	Thuhet se e shoqja e Ministrit është e sëmurë.
të bijtë	Thuhet se të bijtë e Ministrit janë të sëmurë.

* Also thohet.

DRILLS

UNIT 27

(17) SIMPLE SUBSTITUTION

në paradë	Hajde të bëjmë sehir në paradë.
në shes	Hajde të bëjmë sehir në shes.
në park	Hajde të bëjmë sehir në park.
në festë	Hajde të bëjmë sehir në festë.
si lozin	Hajde të bëjmë sehir si lozin.
si këcejnë	Hajde të bëjmë sehir si këcejnë.
si bredhin	Hajde të bëjmë sehir si bredhin.
si hedhin gur	Hajde të bëjmë sehir si hedhin gur.

(18) SIMPLE CORRELATION

këpucë	Kush është ky plak me këpucë të grisura?
këmishë	Kush është ky plak me këmishë të grisur?
mushama	Kush është ky plak me mushama të grisur?
pantallona	Kush është ky plak me pantallona të grisura?
rroba	Kush është ky plak me rroba të grisura?
pallto	Kush është ky plak me pallto të grisur?
kapelë	Kush është ky plak me kapelë të grisur?
xhaketë	Kush është ky plak me xhaketë të grisur?

DRILLS

UNIT 27

(19) SIMPLE SUBSTITUTION

interesohem	Interesohem për historinë e Kohës së Mesme*.
interesohesha	Interesohesha për historinë e Kohës së Mesme.
interesohej	Interesohej për historinë e Kohës së Mesme.
interesoheshim	Interesoheshim për historinë e Kohës së Mesme.
interesohet	Interesohet për historinë e Kohës së Mesme.
interesohemi	Interesohemi për historinë e Kohës së Mesme.
interesohen	Interesohen për historinë e Kohës së Mesme.
interesoheshin	Interesoheshin për historinë e Kohës së Mesme.

(20) RESPONSE

Na rrëfe ndonjë histori.	Ç't'ju rrëfej?
Më rrëfe ndonjë histori.	Ç'të të rrëfej?
Rrëfeji ndonjë histori.	Ç't'i rrëfej?
Rrëfeju ndonjë histori.	Ç't'u rrëfej?
Rrëfena ndonjë histori.	Ç't'ju rrëfej?
Rrëfeji ndonjë histori.	Ç't'i rrëfej?
Rrëfemë ndonjë histori.	Ç'të të rrëfej?
Rrëfeju ndonjë histori.	Ç't'u rrëfej?

* Also e Mesjetës.

DRILLS

UNIT 27

(21) SIMPLE CORRELATION

një fshatari	E shoqja e tij ja la një fshatari kur vdiq.
një katundari	E shoqja e tij ja la një katundari kur vdiq.
disa fshatarëve	E shoqja e tij ua la disa fshatarëve kur vdiq.
disa miqve	E shoqja e tij ua la disa miqve kur vdiq.
një miku	E shoqja e tij ja la një miku kur vdiq.
disa nipërve	E shoqja e tij ua la disa nipërve kur vdiq.
një krushku	E shoqja e tij ja la një krushku kur vdiq.
disa mbesave	E shoqja e tij ua la disa mbesave kur vdiq.

(22) SIMPLE SUBSTITUTION

shpura	E shpura në parakalim.
shpure?	E shpure në parakalim?
shpumë	E shpumë në parakalim.
shpuri	E shpuri në parakalim.
shpunë	E shpunë në parakalim.
shputë?	E shputë në parakalim?
shpumë	E shpumë në parakalim.
shpura	E shpura në parakalim.

DRILLS

UNIT 27

(23) SIMPLE CORRELATION

la	E la në një baulle gjersa u plak.
lamë	E lamë në një baulle gjersa u plakëm.
lanë	E lanë në një baulle gjersa u plakën.
lashë	E lashë në një baulle gjersa u plaka.
latë	E latë në një baulle gjersa u plakët.
le	E le në një baulle gjersa u plake.
lanë	E lanë në një baulle gjersa u plakën.
la	E la në një baulle gjersa u plak.

(24) MULTIPLE CORRELATION

djalit	Ja kishte dhënë një mbesë e tij djalit të saj.
bijvet	Ua kishte dhënë një mbesë e tij bijvet të saj.
bijavet	Ua kishte dhënë një mbesë e tij bijavet të saja.
bijës	Ja kishte dhënë një mbesë e tij bijës së saj.
birit	Ja kishte dhënë një mbesë e tij birit të saj.
vajzavet	Ua kishte dhënë një mbesë e tij vajzavet të saja.
burrit	Ja kishte dhënë një mbesë e tij burrit të saj.
djemvet	Ua kishte dhënë një mbesë e tij djemvet të saj.

DRILLS

UNIT 27

(25) SIMPLE SUBSTITUTION

rrëmbeva	I rrëmbeva kapelën nga koka.
rrëmbeu	I rrëmbeu kapelën nga koka.
rrëmbyem	I rrëmbyem kapelën nga koka.
rrëmbeve	I rrëmbeve kapelën nga koka.
rrëmbyen	I rrëmbyen kapelën nga koka.
rrëmbyet	I rrëmbyet kapelën nga koka.
rrëmbeu	I rrëmbeu kapelën nga koka.
rrëmbyen	I rrëmbyen kapelën nga koka.

(26) SIMPLE SUBSTITUTION

hyra	Hyra në ujë gjer në brez.
hymë	Hymë në ujë gjer në brez.
hytë	Hytë në ujë gjer në brez.
hynë	Hynë në ujë gjer në brez.
hyri	Hyri në ujë gjer në brez.
hyre	Hyre në ujë gjer në brez.
hyra	Hyra në ujë gjer në brez.
hymë	Hymë në ujë gjer në brez.

DRILLS

UNIT 27

(27) MULTIPLE CORRELATION

i biri	I biri është shumë i mësuar.
e shoqja	E shoqja është shumë e mësuar.
të bijtë	Të bijtë janë shumë të mësuar.
e motra	E motra është shumë e mësuar.
të motrat	Të motrat janë shumë të mésuara.
i vëllai	I vëllai është shumë i mësuar.
të vëllezërit	Të vëllezërit janë shumë të mësuar.
të bijat	Të bijat janë shumë të mësuara.

(28) MULTIPLE CORRELATION

ja pa atij	Kur ja pa atij, ja rrëmbeu menjëherë.
ja pashë atij	Kur ja pashë atij, ja rrëmbeva menjëherë.
ja pe atij	Kur ja pe atij, ja rrëmbeve menjëherë.
ua pa atyreve	Kur ua pa atyreve, ua rrëmbeu menjëherë.
ua panë atyreve	Kur ua panë atyreve, ua rrëmbyen menjëherë.
ua pashë atyreve	Kur ua pashë atyreve, ua rrëmbeva menjëherë.
ja pashë asaj	Kur ja pashë asaj, ja rrëmbeva menjëherë.
ua pamë atyreve	Kur ua pamë atyreve, ua rrëmbyem menjëherë.

DRILLS

UNIT 27

(29) SIMPLE SUBSTITUTION

e Skënderbeut	Kish një vulë të vjetër, që kish të shtypur emrin e Skënderbeut.
e Kastriotit	Kish një vulë të vjetër, që kish të shtypur emrin e Kastriotit.
e gjyshit tim	Kish një vulë të vjetër, që kish të shtypur emrin e gjyshit tim.
e fshatit tonë	Kish një vulë të vjetër, që kish të shtypur emrin e fshatit tonë.
e qytetit tonë	Kish një vulë të vjetër, që kish të shtypur emrin e qytetit tonë.
e stërgjyshit tim	Kish një vulë të vjetër, që kish të shtypur emrin e stërgjyshit tim.
e stërgjyshes sonë	Kish një vulë të vjetër, që kish të shtypur emrin e stërgjyshes sonë.
e stërgjyshes sime	Kish një vulë të vjetër, që kish të shtypur emrin e stërgjyshes sime.

DRILLS

UNIT 27

(30) RESPONSE

Rrëfemë një përrallë.	Cilën do që të të rrëfej?
Rrëfena një përrallë.	Cilën doni që t'ju rrëfej?
Rrëfeji një përrallë.	Cilën do që t'i rrëfej?
Rrëfeju një përrallë.	Cilën duan që t'u rrëfej?
Rrëfena një përrallë.	Cilën doni që t'ju rrëfej?
Rrëfeji një përrallë.	Cilën do që t'i rrëfej?
Rrëfemë një përrallë.	Cilën do që të të rrëfej?
Rrëfeju një përrallë.	Cilën duan që t'u rrëfej?

DRILLS

UNIT 27

ANALYSIS 1: MEDIOPASSIVE FORMS OF VERBS BASED ON THE STEM du-

(31) STRUCTURE REPLACEMENT

Plaçkat duhet të dërgohen sot.	Plaçkat duhen dërguar sot.
Letra duhet të dërgohet sot.	Letra duhet dërguar sot.
Lutjet duhet të dërgohen sot.	Lutjet duhen dërguar sot.
Lutja duhet të dërgohet sot.	Lutja duhet dërguar sot.
Gazetat duhet të dërgohen sot.	Gazetat duhen dërguar sot.
Letrat duhet të dërgohen sot.	Letrat duhen dërguar sot.
Gazeta duhet të dërgohet sot.	Gazeta duhet dërguar sot.
Çeku duhet të dërgohet sot.	Çeku duhet dërguar sot.

DRILLS

UNIT 27

(32) STRUCTURE REPLACEMENT

Lutja duhet t'i paraqitet Ministrit.	Lutja i duhet paraqitur Ministrit.
Lutjet duhet t'i paraqiten Ministrit.	Lutjet i duhen paraqitur Ministrit.
Lutjet duhet t'u paraqiten Ministravet.	Lutjet u duhen paraqitur Ministravet.
Lutja duhet t'u paraqitet Ministravet.	Lutja u duhet paraqitur Ministravet.
Letra duhet t'i paraqitet Ministrit.	Letra i duhet paraqitur Ministrit.
Letrat duhet t'u paraqiten Ministravet.	Letrat u duhen paraqitur Ministravet.
Letrat duhet t'i paraqiten Ministrit.	Letrat i duhen paraqitur Ministrit.
Letra duhet t'u paraqitet Ministravet.	Letra u duhet paraqitur Ministravet.

DRILLS

UNIT 27

(33) STRUCTURE REPLACEMENT

Letra duhet të dërgohet sot.	Letra duhet dërguar sot.
Lutjet duhet të paraqiten sot.	Lutjet duhen paraqitur sot.
Letra duhet të shkruhet sot.	Letra duhet shkruar sot.
Lutja duhet t'i paraqitet sot.	Lutja i duhet paraqitur sot.
Puna duhet të bëhet sot.	Puna duhet bërë sot.
Letrat duhet t'i jepen* sot.	Letrat i duhen dhënë sot.
Lajmet duhet t'u thuhen sot.	Lajmet u duhen thënë sot.
Lajmi duhet t'i thuhet sot.	Lajmi i duhet thënë sot.
Këto punë duhet të bëhen sot.	Këto punë duhen bërë sot.
Letrat duhet të shkruhen sot.	Letrat duhen shkruar sot.
Letra duhet t'u jepet* sot.	Letra u duhet dhënë sot.

* Also <u>jipen</u>, <u>jipet</u>.

DRILLS

UNIT 27

ANALYSIS 2: TIME EXPRESSIONS

(34) VARIATION

Sot një javë* isha në Tiranë.	Për një javë do të jem në Tiranë.
Sot një muaj isha në Tiranë.	Për një muaj do të jem në Tiranë.
Sot dy muaj ishim në Tiranë.	Për dy muaj do të jemi në Tiranë.
Sot një javë ishte në Tiranë.	Për një javë do të jetë në Tiranë.
Sot një vit ishe në Tiranë.	Për një vit do të jesh në Tiranë.
Sot dy vjet ishin në Tiranë.	Për dy vjet do të jenë në Tiranë.
Sot tri javë ishit në Tiranë.	Për tri javë do të jini në Tiranë.
Sot tre muaj ishim në Tiranë.	Për tre muaj do të jemi në Tiranë.

* Also si sot një javë, etc.

DRILLS

UNIT 27

(35) RESPONSE

Kur do të kthehet?	Një javë pas së hënës* do të jetë prapë këtu.
Kur do të kthehen?	Një javë pas së hënës do të jenë prapë këtu.
Kur do të kthehemi?	Një javë pas së hënës do të jemi prapë këtu.
Kur do të kthehet?	Një javë pas së hënës do të jetë prapë këtu.
Kur do të kthehesh?	Një javë pas së hënës do të jem prapë këtu.
Kur do të kthehen?	Një javë pas së hënës do të jenë prapë këtu.
Kur do të kthehemi?	Një javë pas së hënës do të jemi prapë këtu.
Kur do të kthehesh?	Një javë pas së hënës do të jem prapë këtu.

* Also <u>të hënën një javë</u>.

DRILLS

UNIT 27

(36) SIMPLE CORRELATION (with nominative cues)

dita	Kjo punë do të mbarohet brenda ditës.
kjo javë	Kjo punë do të mbarohet brenda kësaj jave.
muaji	Kjo punë do të mbarohet brenda muajit.
këto dit	Kjo punë do të mbarohet brenda këtyre ditve.
një vit	Kjo punë do të mbarohet brenda një viti.
viti	Kjo punë do të mbarohet brenda vitit.
java	Kjo punë do të mbarohet brenda javës.
ky muaj	Kjo punë do të mbarohet brenda këtij muaji.

(37) RESPONSE

Sa të mori kjo punë?	E mbarova në tri javë.
Sa i mori kjo punë?	E mbaroi në tri javë.
Sa ju mori kjo punë?	E mbaruam në tri javë.
Sa u mori kjo punë?	E mbaruan në tri javë.
Sa i mori kjo punë?	E mbaroi në tri javë.
Sa të mori kjo punë?	E mbarova në tri javë.
Sa u mori kjo punë?	E mbaruan në tri javë.
Sa ju mori kjo punë?	E mbaruam në tri javë.

DRILLS

UNIT 27

(38) SIMPLE SUBSTITUTION

e hëna	Nga e hëna do të jemi gati.
java që vjen	Nga java që vjen do të jemi gati.
shkurti	Nga shkurti do të jemi gati.
marta që vjen	Nga marta që vjen do të jemi gati.
korriku	Nga korriku do të jemi gati.
muaji që vjen	Nga muaji që vjen do të jemi gati.
e premtja	Nga e premtja do të jemi gati.
shtatori	Nga shtatori do të jemi gati.

(39) SIMPLE SUBSTITUTION

Për sa kohë do të shkosh në Jugosllavi?

tri javë	Për tri javë.
disa dit	Për disa dit.
një muaj	Për një muaj.
pak kohë	Për pak kohë.
një javë	Për një javë.
tre muaj	Për tre muaj.
një vit	Për një vit.
disa javë	Për disa javë.

DRILLS

UNIT 27

(40) SIMPLE CORRELATION

javën që vjen	Javën që vjen do të jem në Durrës.
javën e shkuar	Javën e shkuar isha në Durrës.
javën e kaluar	Javën e kaluar isha në Durrës.
javën që shkoi	Javën që shkoi isha në Durrës.
vitin që vjen	Vitin që vjen do të jem në Durrës.
të enjten që vjen	Të enjten që vjen do të jem në Durrës.
muajin që vjen	Muajin që vjen do të jem në Durrës.
të mërkurën e kaluar	Të mërkurën e kaluar isha në Durrës.
muajin e shkuar	Muajin e shkuar isha në Durrës.
të shtunën e shkuar	Të shtunën e shkuar isha në Durrës.

DRILLS

UNIT 27

ANALYSIS 3: TYPES OF ALBANIAN ADJECTIVES

(41) MULTIPLE CORRELATION

ky është	Ky është i fejuari i Dritës.
e pashë	E pashë të fejuarin e Dritës.
do t'ja them	Do t'ja them të fejuarit të Dritës.
ku është?	Ku është i fejuari i Dritës?
e pe?	E pe të fejuarin e Dritës?
mos i beso	Mos i beso të fejuarit të Dritës.
do t'i flas	Do t'i flas të fejuarit të Dritës.
ti e njeh?	Ti e njeh të fejuarin e Dritës?

(42) MULTIPLE CORRELATION

këta janë	Këta janë të fejuarit e vajzavet.
ti i njeh?	Ti i njeh të fejuarit e vajzavet?
ua thashë	Ua thashë të fejuarvet të vajzavet.
ku janë?	Ku janë të fejuarit e vajzavet?
do t'u flas	Do t'u flas të fejuarvet të vajzavet.
nuk i kam parë	Nuk i kam parë të fejuarit e vajzavet.
do t'ua jap	Do t'ua jap të fejuarvet të vajzavet.
i ke takuar?	I ke takuar të fejuarit e vajzavet?

DRILLS

UNIT 27

(43) MULTIPLE CORRELATION

kjo është	Kjo është e fejuara e Skënderit.
ti e njeh?	Ti e njeh të fejuarën e Skënderit?
ja thashë	Ja thashë së fejuarës së Skënderit.
s'e kam takuar	S'e kam takuar të fejuarën e Skënderit.
kush është?	Kush është e fejuara e Skënderit?
mos i beso	Mos i beso së fejuarës së Skënderit.
e pashë	E pashë të fejuarën e Skënderit.
do t'ja dërgoj	Do t'ja dërgoj së fejuarës së Skënderit.

(44) MULTIPLE CORRELATION

cilat janë?	Cilat janë të fejuarat e djemvet?
ti i njeh?	Ti i njeh të fejuarat e djemvet?
ua dërgova	Ua dërgova të fejuaravet të djemvet.
s'i kam takuar akoma	S'i kam takuar akoma të fejuarat e djemvet.
ua thashë	Ua thashë të fejuaravet të djemvet.
ku janë?	Ku janë të fejuarat e djemvet?
ua dhashë	Ua dhashë të fejuaravet të djemvet.
i kam parë	I kam parë të fejuarat e djemvet.

DRILLS

UNIT 27

(45) SIMPLE SUBSTITUTION (with nominative cues)

i martuar	Ajo shkon me një të martuar.
i shkurtër	Ajo shkon me një të shkurtër.
i trashë	Ajo shkon me një të trashë.
i gjatë	Ajo shkon me një të gjatë.
i thatë	Ajo shkon me një të thatë.
i ri	Ajo shkon me një të ri.
i trashë	Ajo shkon me një të trashë.
i shkurtër	Ajo shkon me një të shkurtër.

(46) SIMPLE SUBSTITUTION (with nominative cues)

e bukur	Ai shkon me një të bukur.
e trashë	Ai shkon me një të trashë.
e gjatë	Ai shkon me një të gjatë.
e hollë	Ai shkon me një të hollë.
e shkurtër	Ai shkon me një të shkurtër.
e martuar	Ai shkon me një të martuar.
e re	Ai shkon me një të re.
e thatë	Ai shkon me një të thatë.

DRILLS

UNIT 27

(47) RESPONSE

Kujt ja the, një të holli?	Jo, një të trashi.
Kujt ja the, një së holle?	Jo, një së trashe.
Cilëve ua the, disa të trashëve?	Jo, disa të hollëve.
Cilave ua the, disa të hollave?	Jo, disa të trashave.
Cilëve ua the, disa të gjatëve?	Jo, disa të shkurtërve.
Kujt ja the, një së gjate?	Jo, një së shkurtre.
Kujt ja the, një të shkurtri?	Jo, një të gjati.
Cilave ua the, disa të shkurtrave?	Jo, disa të gjatave.

(48)

Cilit ja dhe letrën?	Një Shqiptari.
Cilës ja dhe letrën?	Një Shqiptareje.
Me cilin ishe?	Me një Shqiptar.
Me cilën ishe?	Me një Shqiptare.
Me cilat ishe?	Me disa Shqiptare.
Cilëve ua dhe letrën?	Disa Shqiptarëve.
Cilave ua dhe letrën?	Disa Shqiptareve.
Me cilët ishe?	Me disa Shqiptarë.

DRILLS

UNIT 27

(49) STRUCTURE REPLACEMENT

Është hera e parë.	Është e para herë.
Ishte hera e dytë.	Ishte e dyta herë.
Është nxënësi i parë.	Është i pari nxënës.
Është mësuesi më i mirë.	Është më i miri mësues.
Është shkolla më e madhe.	Është më e madhja shkollë.
Është mësuesja më e bukur.	Është më e bukura mësuese.
Ishte punëtori më i keq që kishim.	Ishte më i keqi punëtor që kishim.
Janë vajzat më të mëdha.	Janë më të mëdhat vajza.
Ishin punëtorët më të mirë që kishim.	Ishin më të mirët punëtorë që kishim.

DRILLS

UNIT 27

ANALYSIS 4: PECULIAR NOUNS

(50) VARIATION

Kjo është njerka e tij.	Kjo është e njerka.
Ky është vëllai i tij.	Ky është i vëllai.
Këta janë vëllezërit të tij.	Këta janë të vëllezërit.
Këta janë nipërit e saj.	Këta janë të nipërit.
Ky është ati i saj.	Ky është i ati.
Kjo është bija e tij.	Kjo është e bija.
Këto janë motrat e saja.	Këto janë të motrat.
Këto janë kunatat e tija.	Këto janë të kunatat.

(51) VARIATION

E njeh motrën e tij?	E njeh të motrën?
E njeh vëllanë e tij?	E njeh të vëllanë?
I njeh vëllezërit e saj?	I njeh të vëllezërit?
E njeh vjehrin e saj?	E njeh të vjehrin?
I njeh bijat e tija?	I njeh të bijat?
E njeh bijën e saj?	E njeh të bijën?
I njeh motrat e saja?	I njeh të motrat?
I njeh nipërit e saj?	I njeh të nipërit?

DRILLS

UNIT 27

(52) RESPONSE

E do shumë t'anë.	Po, por jo aq shumë sa t'ëmën.
E do shumë të motrën.	Po, por jo aq shumë sa të vëllanë.
I do shumë të vëllezërit.	Po, por jo aq shumë sa të motrat.
E do shumë të bijën.	Po, por jo aq shumë sa të birin.
I do shumë të motrat.	Po, por jo aq shumë sa të vëllezërit.
E do shumë të gjyshin.	Po, por jo aq shumë sa të gjyshen.
I do shumë të kushërirat.	Po, por jo aq shumë sa të kushërinjtë.
I do shumë të bijtë.	Po, por jo aq shumë sa të bijat.

(53) VARIATION

Mos i beso vëllait të tij.	Mos i beso të vëllait.
Mos u beso vëllezërvet të tij.	Mos u beso të vëllezërvet.
Mos i beso motrës së tij.	Mos i beso së motrës.
Mos i beso bijës së saj.	Mos i beso së bijës.
Mos u beso motravet të saja.	Mos u beso së motravet.
Mos u beso bijavet të tija.	Mos u beso së bijavet.
Mos i beso birit të saj.	Mos i beso të birit.
Mos u beso bijvet të saj.	Mos u beso të bijvet.

DRILLS

UNIT 27

(54) RESPONSE

Shkoi edhe i ati?	Po, e mori edhe t'anë.
Shkoi edhe e motra?	Po, e mori edhe të motrën.
Shkuan edhe të vëllezërit?	Po, i mori edhe të vëllezërit.
Shkuan edhe të bijat?	Po, i mori edhe të bijat.
Shkoi edhe e shoqja?	Po, e mori edhe të shoqen.
Shkoi edhe i vjehri?	Po, e mori edhe të vjehrin.
Shkuan edhe të mbesat?	Po, i mori edhe të mbesat.
Shkoi edhe e ëma?	Po, e mori edhe t'ëmën.
Shkuan edhe të nipërit?	Po, i mori edhe të nipërit.

(55) RESPONSE

Kujt ja dhe, së motrës?	Jo, të vëllait.
Kujt ja dhe, së motravet?	Jo, të vëllezërvet.
Kujt ja dhe, të birit?	Jo, së bijës.
Kujt ja dhe, të nipërvet?	Jo, së mbesavet.
Kujt ja dhe, s'ëmës?	Jo, t'atit.
Kujt ja dhe, të gjyshit?	Jo, së gjyshes.
Kujt ja dhe, së vjehrës?	Jo, të vjehrit.
Kujt ja dhe të kushërinjvet?	Jo, së kushëriravet.
Kujt ja dhe, së kunatës?	Jo, të kunatit.

DRILLS

UNIT 27

(56) DIRECTED DIALOGUE

Thuajini X-i se e kërkonte i ati.

Pyeteni Z-in ku ndodhet babai juaj tani.

Thuajini X-it se e patë qëpari në kafene me babanë tuaj.

Thuajini Z-it se qenkan miq baballarët tuaj.

Thuajini X-it se me të vërtetë është çudi e madhe. Janë aq të ndryshëm.

Thuajini Z-it se janë tamam ndryshimet që i bëjnë që të interesohen për njeri tjetrin.

Thuajini X-it se ka të drejtë.

(57) DIRECTED DIALOGUE

Thuajini X-it se sot bën vapë.

Pyeteni Z-in a do që të shkoni për peshk.

Thuajini X-it se do të donit, por kini frikë se nos bjerë shi.

Pyeteni Z-in kush i tha se do të bjerë shi.

Thuajini X-it se e lexuat në gazetën e sotshme.

Thuajini Z-it të mos besojë sa shkruajnë gazetat.

Thuajini X-it se ka të drejtë. Le të shkoni në lumë.

DRILLS

UNIT 27

(58) DIRECTED DIALOGUE

Thuajini X-ës se kini një të re për t'i thënë.

Pyeteni Z-ën çfarë të re ka dëgjuar prapë.

Pyeteni X-ën a e di që Drita shkon me një të martuar.

Pyeteni Z-ën për cilën Dritë flet. Thuajini se këtu ka sa të dojë Drita.

Thuajini X-ës se e kini fjalën për Dritën e rrobaqepësit.

Thuajini Z-ës ç'janë këto që ju thotë: ajo a është a s'është gjashtëmbëdhjetë vjeç.

Thuajini X-ës se ashtu thotë e ëma, kurse në të vërtetë është nëntëmbëdhjetë vjeç.

Thuajini Z-ës se sido që të jetë nuk e besoni të ketë mik të martuar.

Thuajini X-ës se jo vetëm që e ka, por do edhe ta ndajë nga e shoqja.

Pyeteni Z-ën kush është ky burrë.

Thuajini X-ës se s'mund t'ja thoni emrin e tij, por mjafton t'i thoni se është këpucar.

Thuajini Z-ës se në fshatin tuaj ka vetëm dy këpucarë: burrin tuaj dhe vjehrin tuaj. Pyeteni mos është plaku.

Thuajini X-ës se ai është shumë plak për të bredhur pas grave.

Thuajini Z-ës se atëherë s'mbetet veçse burri juaj.

Thuajini X-ës se juve nuk ju pëlqen ta veni hundën në punët e huaja.

DRILLS

UNIT 27

(59) DIRECTED DIALOGUE

Pyeteni X-in a e di në ç'orë do të fillojë parakalimi.

Thuajini Z-it se nuk e dinit fare që do të kishte parakalim sot.

Pyeteni X-in a e harroi që sot është Dita e Flamurit.

Thuajini Z-it se nuk e kishit harruar, por se nuk jini në Shqipëri.

Thuajini X-it se në këtë qytet ka mijëra Shqiptarë, kështu që i mbajnë të gjitha festat shqiptare.

Thuajini Z-it atëherë të visheni, sepse parakalimet zakonisht fillojnë nga ora dhjetë dhjetë e gjysmë.

(60) DIRECTED DIALOGUE

Pyeteni X-in ku shkon aq heret e bija.

Thuajini Z-it se do të shkojë në fshatin e gjyshes, ku ka festë sot.

Pyeteni X-in me se do të shkojë: këmbë*?

Thuajini Z-it se do ta shpjerë me maqinë i kushëriri, Kozmai.

Pyeteni X-in a është i kënaqur i nipi me maqinën e tij.

Thuajini Z-it se ai mund të jetë sa të dojë i kënaqur, por se ju ju bezdisin të gjitha këto maqina që ju prishin gjumin.

Thuajini X-it: ç'të bëjë? Ndryshuan kohët.

END OF DRILLS FOR UNIT 27

* Also <u>me këmbë</u>.

DRILLS

UNIT 28

(1) SIMPLE CORRELATION

përktheva	E përktheva në gjuhën shqipe kërkesën* që bëra.
përktheu	E përktheu në gjuhën shqipe kërkesën që bëri.
përkthyem	E përkthyem në gjuhën shqipe kërkesën që bëmë.
përktheve	E përktheve në gjuhën shqipe kërkesën që bëre.
përktheva	E përktheva në gjuhën shqipe kërkesën që bëra.
përkthyet	E përkthyet në gjuhën shqipe kërkesën që bëtë.
përktheu	E përktheu në gjuhën shqipe kërkesën që bëri.
përkthyen	E përkthyen në gjuhën shqipe kërkesën që bënë.

(2) MULTIPLE CORRELATION

qytetet	Cilat janë qytetet kryesore të Shqipërisë?
skelet	Cilat janë skelet kryesore të Shqipërisë?
malet	Cilat janë malet kryesore të Shqipërisë?
lumenjtë	Cilët janë lumenjtë kryesorë të Shqipërisë?
fabrikat	Cilat janë fabrikat kryesore të Shqipërisë?
minierat	Cilat janë minierat kryesore të Shqipërisë?
industritë	Cilat janë industritë kryesore të Shqipërisë?
xhadetë	Cilat janë xhadetë kryesore të Shqipërisë?

* Also <u>lutjen</u>.

DRILLS

UNIT 28

(3) MULTIPLE CORRELATION

parakalimi	Për gjysmë ore fillon parakalimi ushtarak.
ushtrimet	Për gjysmë ore fillojnë ushtrimet ushtarake.
loja	Për gjysmë ore fillon loja ushtarake.
parada	Për gjysmë ore fillon parada ushtarake.
ushtrimet	Për gjysmë ore fillojnë ushtrimet ushtarake.
ndeshja	Për gjysmë ore fillon ndeshja ushtarake.
parakalimi	Për gjysmë ore fillon parakalimi ushtarak.
lojnat	Për gjysmë ore fillojnë lojnat ushtarake.

(4) SIMPLE CORRELATION

sot	Është ndonjë ditë e shënuar sot?
nesër	Është ndonjë ditë e shënuar nesër?
dje	Ishte ndonjë ditë e shënuar dje?
pardje	Ishte ndonjë ditë e shënuar pardje?
pasnesër	Është ndonjë ditë e shënuar pasnesër?
nesër	Është ndonjë ditë e shënuar nesër?
pardje	Ishte ndonjë ditë e shënuar pardje?
sot	Është ndonjë ditë e shënuar sot?

DRILLS

UNIT 28

(5) SIMPLE SUBSTITUTION

dyzet	Dyzet vjet të shkuar Aleatët na dorëzuan pavarësinë.
tridhjetë	Tridhjetë vjet të shkuar Aleatët na dorëzuan pavarësinë.
njëzet	Njëzet vjet të shkuar Aleatët na dorëzuan pavarësinë.
pesëmbëdhjetë	Pesëmbëdhjetë vjet të shkuar Aleatët na dorëzuan pavarësinë.
dhjetë	Dhjetë vjet të shkuar Aleatët na dorëzuan pavarësinë.
njëzet e pesë	Njëzet e pesë vjet të shkuar Aleatët na dorëzuan pavarësinë.
tridhjetë e pesë	Tridhjetë e pesë vjet të shkuar Aleatët na dorëzuan pavarësinë.
pesëdhjetë	Pesëdhjetë vjet të shkuar Aleatët na dorëzuan pavarësinë.

DRILLS

UNIT 28

(6) SIMPLE CORRELATION

më tha	Më tha se nuk do ta marrë parasysh lutjen e tyre.
më the	Më the se nuk do ta marrësh parasysh lutjen e tyre.
më thanë	Më thanë se nuk do ta marrin parasysh lutjen e tyre.
më thatë	Më thatë se nuk do ta mirrni parasysh lutjen e tyre.
më tha	Më tha se nuk do ta marrë parasysh lutjen e tyre.
u thashë	U thashë se nuk do ta marr parasysh lutjen e tyre.
u thamë	U thamë se nuk do ta marrim parasysh lutjen e tyre.
u thashë	U thashë se nuk do ta marr parasysh lutjen e tyre.

(7) SUBSTITUTION IN VARIABLE SLOT

Ky është delegati shqiptar.

këta janë	Këta janë delegatët shqiptarë.
amerikanë	Këta janë delegatët amerikanë.
ky është	Ky është delegati amerikan.
anglez	Ky është delegati anglez.
këta janë	Këta janë delegatët anglezë.
italianë	Këta janë delegatët italianë.
ky është	Ky është delegati italian.
gjerman	Ky është delegati gjerman.

DRILLS

UNIT 28

(8) SIMPLE CORRELATION

ti?	Ti di t'i biesh trumbetës?
unë	Unë di t'i bie trumbetës.
ai	Ai di t'i bjerë trumbetës.
ju?	Ju dini t'i bini trumbetës?
ata	Ata dinë t'i bien trumbetës.
ne	Ne dimë t'i biem trumbetës.
ti	Ti di t'i biesh trumbetës.
ju	Ju dini t'i bini trumbetës.

(9) SIMPLE SUBSTITUTION

gjenerali	Në krye të trupavet është gjenerali.
koloneli	Në krye të trupavet është koloneli.
togeri	Në krye të trupavet është togeri.
kapiteni	Në krye të trupavet është kapiteni.
majori	Në krye të trupavet është majori.
nëntogeri	Në krye të trupavet është nëntogeri.
gjenerali	Në krye të trupavet është gjenerali.
koloneli	Në krye të trupavet është koloneli.

DRILLS

UNIT 28

(10) SUBSTITUTION IN VARIABLE SLOT

Shqiponja rron në male.

shqiponjat	Shqiponjat rrojnë në male.
kanë sy të fortë	Shqiponjat kanë sy të fortë.
shqiponja	Shqiponja ka sy të fortë.
rron në malet e larta	Shqiponja rron në malet e larta.
shqiponjat	Shqiponjat rrojnë në malet e larta.
kanë trup të madh	Shqiponjat kanë trup të madh.
shqiponja	Shqiponja ka trup të madh.

(11) SIMPLE SUBSTITUTION

majori	Ai në mes është majori.
koloneli	Ai në mes është koloneli.
togeri	Ai në mes është togeri.
gjenerali	Ai në mes është gjenerali.
komandanti	Ai në mes është komandanti.
kapiteni	Ai në mes është kapiteni.
nëntogeri	Ai në mes është nëntogeri.
oficeri	Ai në mes është oficeri.

DRILLS

UNIT 28

(12) SIMPLE SUBSTITUTION

i dytë	Ky është regjimenti i dytë i artilerisë.
i tretë	Ky është regjimenti i tretë i artilerisë.
i pestë	Ky është regjimenti i pestë i artilerisë.
i dhjetë	Ky është regjimenti i dhjetë i artilerisë.
i katërt	Ky është regjimenti i katërt i artilerisë.
i parë	Ky është regjimenti i parë i artilerisë.
i tetë	Ky është regjimenti i tetë i artilerisë.
i gjashtë	Ky është regjimenti i gjashtë i artilerisë.

(13) SIMPLE SUBSTITUTION

regjimentin	Ai është në regjimentin e tretë.
brigadën	Ai është në brigadën e tretë.
batalionin	Ai është në batalionin e tretë.
kompaninë	Ai është në kompaninë e tretë.
brigadën	Ai është në brigadën e tretë.
regjimentin	Ai është në regjimentin e tretë.
kompaninë	Ai është në kompaninë e tretë.
batalionin	Ai është në batalionin e tretë.

DRILLS

UNIT 28

(14) SIMPLE SUBSTITUTION

njëqind	Numëro gjer në njëqind.
dhjetë	Numëro gjer në dhjetë.
pesëdhjetë	Numëro gjer në pesëdhjetë.
nëntëmbëdhjetë	Numëro gjer në nëntënmbëdhjetë.
dyzet	Numëro gjer në dyzet.
njëzet	Numëro gjer në njëzet.
tridhjetë	Numëro gjer në tridhjetë.
dymbëdhjetë	Numëro gjer në dymbëdhjetë.

(15) SIMPLE CORRELATION

kapiteni	Kapiteni është komandanti i kompanisë.
majori	Majori është komandanti i batalionit.
koloneli	Koloneli është komandanti i regjimentit.
gjenerali	Gjenerali është komandanti i brigadës.
majori	Majori është komandanti i batalionit.
kapiteni	Kapiteni është komandanti i kompanisë.
gjenerali	Gjenerali është komandanti i brigadës.
koloneli	Koloneli është komandanti i regjimentit.

DRILLS

UNIT 28

(16) SIMPLE CORRELATION

më	Më vjen keq që s'prura maqinën fotografike.
i	I vjen keq që s'pruri maqinën fotografike.
na	Na vjen keq që s'prumë maqinën fotografike.
u	U vjen keq që s'prunë maqinën fotografike.
të?	Të vjen keq që s'prure maqinën fotografike?
ju?	Ju vjen keq që s'prutë maqinën fotografike?
më	Më vjen keq që s'prura maqinën fotografike.
na	Na vjen keq që s'prumë maqinën fotografike.

(17) SIMPLE SUBSTITUTION

bleva	E bleva posaçërisht* për të nxjerrë fotografi nëpër festa.
bleu	E bleu posaçërisht për të nxjerrë fotografi nëpër festa.
blemë	E blemë posaçërisht për të nxjerrë fotografi nëpër festa.
bleve	E bleve posaçërisht për të nxjerrë fotografi nëpër festa.
bletë	E bletë posaçërisht për të nxjerrë fotografi nëpër festa.
blenë	E blenë posaçërisht për të nxjerrë fotografi nëpër festa.
bleva	E bleva posaçërisht për të nxjerrë fotografi nëpër festa.
blemë	E blemë posaçërisht për të nxjerrë fotografi nëpër festa.

* Also <u>apostafat</u>, <u>kastile</u>.

DRILLS

UNIT 28

(18) SIMPLE CORRELATION

vura	E vura përmbi trapezë* në odën** time.
vure	E vure përmbi trapezë në odën tënde.
vumë	E vumë përmbi trapezë në odën tonë.
vunë	E vunë përmbi trapezë në odën e tyre.
vutë	E vutë përmbi trapezë në odën tuaj.
vuri	E vuri përmbi trapezë në odën e tij.
vura	E vura përmbi trapezë në odën time.
vumë	E vumë përmbi trapezë në odën tonë.

(19) MULTIPLE CORRELATION

kam	Kam dalë kur isha paraushtarak.
kemi	Kemi dalë kur ishim paraushtarakë.
ke	Ke dalë kur ishe paraushtarak.
ka	Ka dalë kur ishte paraushtarak.
kanë	Kanë dalë kur ishin paraushtarakë.
kini	Kini dalë kur ishit paraushtarakë.
kam	Kam dalë kur isha paraushtarak.
ka	Ka dalë kur ishte paraushtarak.

* Also tryezë.

** Also dhomën.

DRILLS

UNIT 28

(20) SIMPLE SUBSTITUTION

ushtria	Ushtria bën ushtrime.
kompania	Kompania bën ushtrime.
regjimenti	Regjimenti bën ushtrime.
batalioni	Batalioni bën ushtrime.
brigada	Brigada bën ushtrime.
ushtria	Ushtria bën ushtrime.
batalioni	Batalioni bën ushtrime.
kompania	Kompania bën ushtrime.

(21) SIMPLE SUBSTITUTION

topat	Topat i sjellim nga Franca.
mitralozat	Mitralozat i sjellim nga Franca.
trumbetat	Trumbetat i sjellim nga Franca.
maqinat	Maqinat i sjellim nga Franca.
traktorët	Traktorët i sjellim nga Franca.
veglat	Veglat i sjellim nga Franca.
kuajt	Kuajt i sjellim nga Franca.
çakmakët	Çakmakët i sjellim nga Franca.

SPOKEN ALBANIAN

DRILLS

UNIT 28

(22) RESPONSE

E bleve?	Jo, bëra shkëmbim.
E bleu?	Jo, bëri shkëmbim.
E bletë?	Jo, bëmë shkëmbim.
E blenë?	Jo, bënë shkëmbim.
E bleve?	Jo, bëra shkëmbim.
E bletë?	Jo, bëmë shkëmbim.
E blenë?	Jo, bënë shkëmbim.
E bleu?	Jo, bëri shkëmbim.

(23) SIMPLE SUBSTITUTION

qymyrin	Qymyrin e importojnë nga jashtë.
gazin	Gazin e importojnë nga jashtë.
hekurin	Hekurin e importojnë nga jashtë.
bakrin	Bakrin e importojnë nga jashtë.
vajgurin	Vajgurin e importojnë nga jashtë.
qymyrin	Qymyrin e importojnë nga jashtë.
hekurin	Hekurin e importojnë nga jashtë.
bakrin	Bakrin e importojnë nga jashtë.

DRILLS

UNIT 28

(24) MULTIPLE CORRELATION

i vëllai	I vëllai është inxhenjer.
të vëllezërit	Të vëllezërit janë inxhenjerë*.
të nipërit	Të nipërit janë inxhenjerë.
i nipi	I nipi është inxhenjer.
i biri	I biri është inxhenjer.
të bijtë	Të bijtë janë inxhenjerë.
i ati	I ati është inxhenjer.
i shoqi	I shoqi është inxhenjer.

(25) SIMPLE SUBSTITUTION

jonë	Pak nga pak po përmirësohet ekonomia jonë.
e vendit	Pak nga pak po përmirësohet ekonomia e vendit.
e Shqipërisë	Pak nga pak po përmirësohet ekonomia e Sqhipërisë.
e atdheut tonë	Pak nga pak po përmirësohet ekonomia e atdheut tonë.
e vendit tonë	Pak nga pak po përmirësohet ekonomia e vendit tonë.
e Turqisë	Pak nga pak po përmirësohet ekonomia e Turqisë.
e tyre	Pak nga pak po përmirësohet ekonomia e tyre.

* Also <u>inxhenjera</u>.

DRILLS

UNIT 28

(26) SIMPLE CORRELATION

prodhojmë	Natyrisht, shpenzimet pakësohen kur prodhojmë vetë.
prodhoni	Natyrisht, shpenzimet pakësohen kur prodhoni vetë.
prodhonim	Natyrisht, shpenzimet pakësoheshin kur prodhonim vetë.
prodhojnë	Natyrisht, shpenzimet pakësohen kur prodhojnë vetë.
prodhonin	Natyrisht, shpenzimet pakësoheshin kur prodhonin vetë.
prodhonit	Natyrisht, shpenzimet pakësoheshin kur prodhonit vetë.
prodhojmë	Natyrisht, shpenzimet pakësohen kur prodhojmë vetë.
prodhonim	Natyrisht, shpenzimet pakësoheshin kur prodhonim vetë.

DRILLS

UNIT 28

(27) MULTIPLE CORRELATION

